

INTERVISTË ME FISNIK ISMAILIN

Prishtinë | Data: 30 tetor, 2018

Kohëzgjatja: 252 minuta

Të pranishëm:

- Fisnik Ismaili (I intervistuari)
- Kaltrina Krasniqi (Intervistuesja)
- Donjeta Berisha (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Kaltrina Krasniqi: Cilat janë kujtimet e tua t'para?

Fisnik Ismaili: Në Prishtinë është banesa te soliterat, te fontana. Është qaj' ambienti, jemi t'u folë dikun të '70-tat, mesi i të '70-tave, unë në të '73-tën kom lindë. Është fontana, soliterat, kati i gjashtë, një shkallë e thyme pak pa mrrri te kati i gjashtë, m'doket hala është. Qajo mahalla qaty në Ulpianë. Do prej fëmijëve që më kujtohen që jom shoqnu, Faiku, Anesa, motrat e mia zullumin kur ma shtrojshin, edhe drejt me të thanë nuk kom qaq kujtesa të mëdhaja prej fëmijënisë të hershme, edhe diku në vitin e...domethanë tre vjeç na kemi dalë kemi jetu tri vjet në Moskë edhe prej atyhit noshta ma shumë kom pak ma do kujtesa të jetës në Moskë edhe...

Kaltrina Krasniqi: Çka keni bo në Moskë?

Fisnik Ismaili: Në Moskë... baba pat' qenë drejtor i përfaqësisë të Jugobankës atje edhe e ka pasë një mandat katërvjeçar prej të cilit tri kemi nejtë. Domethanë mas tri vjetësh, ja kanë ofru edhe një mandat tjetër ose me u kthy mas tri vjetësh ose me nejtë edhe katër tjera, u bojke shumë shtatë vjet me nejtë, nuk dojshim na fëmitë. Motrat i kom, e madhja është gjashtë, e vogla katër vjet ma të vjetra se unë. Edhe ato ishin në moshë të shkollës, unë isha hala parashkollorë edhe për to ka qenë ma ndryshe krejt përvoja edhe tri vjet kanë mjaftu për me, për me kalu si përvojë edhe për to edhe për mu.

Unë faktikisht në qat' moshë jom rritë, në qat' moshë ja kom nisë me shkru, me lexu, edhe nana s'ka punu, kështu që kom kalu shumë kohë me to. Nji pjesë e çojsha edhe në çerdhe atje. Nuk kom fort kujtesa ekzakthe. Me të thanë më kujtohen fëmijët me të cilët kom lujtë, Abdu e ka pasë një djalë, zezak ka qenë, i vogël. Domethanë qysh tre-katër vjeç unë kom pasë interaksion me një racë tjetër e cila u kanë ma e pazakontë për neve, kem qenë shokë të mirë, ai s'po e di a i Somalisë a i një shtetit islam të Afrikës, sepse ku kemi jetu na ka qenë si një kuart, jemi t'u folë për Rusinë e vitit 1976 gjatë periudhës së Brezhnjevitet, Luftës së Ftohtë ku Rusia ka qenë ekstrem e izolume po ku në një kuart kanë jetu ndërkombëtarët, pak a shumë si sot këtu qysh jonë ma të veçum. Edhe pjesë e tyne kanë qenë njerëz të ndryshëm që kanë jetu [punu] nëpër ambasada ose konsulata të ndryshme.

Nuk më kujtohet kurgjo për familjen e Abdusë po kem qenë shokë të mirë aty u enshim nëpër mahallë. Më kujtohet edhe kanë qenë dy familje tjera jugosllave, do boshnjakë edhe do të Beogradit. Ana e

Marjana kanë qenë dy vajza. Qito jonë qato kujtesat e vetme, e di që mu më pëlqejke Ana, unë i pëlqejsha Marjanës e diqysh jem t'u folë për një periudhë, asi trekandësja të dashurisë në moshën katër-pesë vjeçare. Më kujtohet Moska si një qytet shumë i madh, një qytet sa ish i zymtë qaq edhe në do momente ish madhështor me do objekte të cilat ishin të para-komunizmit.

Jo që mujsha me bo najfarë dallimi atëherë, po sot kur e menoj më kujtohen ato furrat e bukës kur s'kish bukë, e u bojke rendi ka pesë-gjashtëdhjetë metra njerëzit t'u pritë bukë me hongër, masnej shkojshe te Bolshevik Teatër që ka qenë, është teatër hala, njeni prej teatrove ma të famshme në botë edhe madhështia e ndërtesës, ose Kremlini. Ka qenë edhe një qatë gëzimi ma i madh kur shkojshim Domi Grushki i thojshin një shpija e lojnavë i bjen, ka qenë një objekt ku kish lojna të ndryshme, qejfi jem me shku qatë me, m'u shetitë, me kqyrë naj lodër me ble.

Më kujtohen filmat e vizatum të Rosisë, ka qenë një me një ujë e një lepër që u njëkshin tan' kohën, s'po më kujtohet emri taman. Më kujtohet një tren ma pat' ble nana, tren të vogël kështu, faktikisht i vogël jo, sa qajo tavolinë ka qenë {tregon me gisht} kem pasë një tavolinë shumë të madhe, ma patën montu trenin aty edhe plot kështu objekte rreth e rreth. Edhe qishtë e pata nisë koleksionin e kerreve të vogla ksi të hekrit, e kom pasë një koleksion koxha, koxha t'madh.

Në Rusi ndërkombëtarët kanë qenë ma të privilegjum, t'u qenë se jetojshim në kuarte të ndame prej popullsisë atëherë, jemi t'u folë për atë periudhën e komunizmit të thellë në Rusi, edhe ka pasë edhe dyqane sikur që jonë këtë, qysh ju thojnë këtyne dyqaneve të *Bond Steel*-it qashtu, ka pasë dyqane ku veç njerëzit ma të privilegjum mujshin me shku me ble. Ishin si *free-shopat* që jonë sot në aeroporta, qashtu ke pasë gjithçka, ke pasë çokollada që s'mujshe me i gjetë në asnjë dyqan në Rusi. Ke pasë farmerka, s'ka pasë as farmerka njerëzit s'kanë pasë qatëherë. Më kujtohet babin e nalshin në rrugë me ja lypë farmerkat, dy-tri herë u kthy në shpi ai i ka deshë farmerkat e ja u ka jepë njerëzve se s'ka pasë. E aty mujshe me ble sene qishtë, a din, coca-cola, toblerone, qisi që në atë kohë nuk ke mujtë me i gjetë as në Jugosllavi bile plot prej këtyne gjanave tek ma vonë kanë ardhë.

Më kujtohet, më kujtohen do shokë të prindëve të mi të cilët ishin kryesisht studenta, tash pleqtë e mi ishin pak ma, ma... s'po thom në moshë, ata ishin diku fundi i të tridhjetave, fillimi i të katërdhetave po u shoqnojshin me do studenta që vishin me studiu në Rusi, kryesisht ishin studenta të artit, muzikë e aktrim. Një prej tyne ka qenë Faruk Begolli, i kom do fotografia në qafë të Farukit kur ka qenë Faruki student shumë i ri që vishin me nejtë te na e kalojshin kohë ata. Kështu që ka qenë njëfarë komuniteti i vogël i shqiptarëve kryesisht i artistave të cilët studiojshin atje, bile Faruku nëse s'gaboj ka qenë një relacion me një pianiste e cila...

Tash Rusia është enorme, edhe në Rusi ka raca të ndryshme e më kujtohet ajo ka pasë sy kështu pak ma orientale, po s'e disha e kahit o' kanë e Uzbekistanit a... nuk e di! Po ka qenë njona prej pianistëve ma të shqume në atë kohë po nuk e di a në krejt Rusinë, a veç në Moskë, a në shkollë të saj a, po e di që më pat' jepë mësim edhe qishtë pata nisë me i ra pianos edhe një kohë... nëse është njeni prej, unë munohna me jetu një jetë pa pishmane po një prej pak pishmanëve që i kom është që e kom nalë pianon kur s'o dashtë me nalë edhe hala vuj që s'e kom vazhdu, po kjo ma shumë kur jena kthy këtu

në Prishtinë ka qenë rezultat i... {merr frymë thellë} qysh me thanë, mosorganizimit të shkollës ku shkojsha edhe shkollës së muzikës.

Po ma vonë pak për kthimin në Prishtinë. Po kallxoj pak qysh, çfarë kujtesa kom pasë në Moskë edhe qysh jom rritë. Na kem qenë nashta a din, pak e thom si me siklet kaniherë t'u e ditë në çfarë situatë jena qitash e çfare kem qenë, kom qëllu me jetu në një familje ma të privilegjime prej faktit që babi ka pasë rastin me punu jashtë e me fitu ma mirë. Po kjo ka qenë rezultat po supozoj i punës së tij edhe të nanës të cilët i kanë çelë rrugë vetit edhe nëse ke punu mirë edhe je tregu i vyshëm në Jugosllavi nuk është që të kanë nalë.

Mami e babi prej historive që i njoh, që m'i kanë kallxu, babi ka jetu në një katun afër Ferizajit deri kah mosha gjashtëmbëdhjetë vjeçe, Sazli, prej atyhit e ka pa që qysh e thojke ai, "Qysh jom kanë t'u prashitë, m'ka bërthitë baba njiherë, 'A p'i jepë ma shumë zor a p'e len kit' punë". Tha, "Veç e kom lëshu shatin edhe e kom lëshu katunin".

Ka jetu në Ferizaj një kohë pak deri i ka fillu studimet e ekonomikut edhe ka ardhë në Prishtinë. Derisa nana është rritë në Mitrovicë edhe ka ardhë me studiu anglishten në Prishtinë. Këtu jonë taku, kanë ra në dashni edhe si plot çifte a din, kur e kqyrë, Prishtina faktikisht o' ndërto prej njerëzve, o' kriju prej njerëzve...Edhe e kom thanë në njëfarë statusi niherë, "Prishtinali s'lind, po bohesh". Pothuajse çdo kryeqytet, kryeqyteti ngrehë njerëz edhe i manë do prej tyne. Edhe prindtë e mi kanë qenë një çift të cilët kanë vendosë me u bo bashkë edhe me vazhdu të ardhmen këtu. Babi s'ka dashtë kurrë me u kthy në katun. Bile, bile shumë pak kom përjetime të katunit të babit, në krahasim me anej kah familja e nanës edhe pse nana është lindë e rritë në Mitrovicë, në fakt ka lindë në Prishtinë e o' rritë në Mitrovicë. Një pjesë të madhe të fëmijënisë e kom kalu edhe atje.

Ferizajin e Sazlinë e kit' pjesën e babit nuk e kom përjetu qaq shumë. Babi ka qenë shumë ma i mbyllun për këtë çashtjen e me njoftu me familjen...Nëse dikush e ka ba këtë punë, e ka ba nana, na ka njoftu me anëtarët e të dy palëve. Edhe ata kanë nisë në të '60-tat kanë nisë, kanë lindë dy motrat e mia. Kanë nisë me jetu në soliter, para asaj nuk e di ku kanë jetu, s'i kom pytë najherë. Qaty kom lindë unë, kemi kalu domethanë tri vjet '76-tën kemi jetu në Moskë për tri vjet, '79-tën.

Për Moskën kallxova pak a shumë...qaty jom mësu me shkrujtë, me lexu. Nana kish kohë me nejtë me mu.

Kaltrina Krasniqi: A keni mësu rusisht?

Fisnik Ismaili: Kom mësu, kom ditë rusisht, serbisht, shqip me shkrujtë me folë çirilicë, latinicë. Praktikisht kish kohë nana me kalu me mu. Shkojsha edhe në... ja nisa në çerdhe me shku edhe krejt qat' kohë u merrsha me qisi aktivitete, kom vizatu, kom munu me i ra pianos, më patën identifiku si koxha talent edhe diku në të '79-tën u kthym. Më kujtohet, një kujtesë shumë interesant e kom, në të '80-tën kish me u bo, kish me u majtë olimpiada në Moskë edhe e kanë pasë një arushë si maskotë edhe patën bo shumë materiale të ndryshme me qat' arushën maskotën t'u skiju, t'u u lëshu me... ka qenë, s'po më kujtohet a ka qenë, jo, jo... Olimpiadë verore m'doket ka qenë, jo dimërore. Po t'u u

marrë me sporte të ndryshme arusha. Veç e di që një arushë e kanë pasë edhe marojshin kësi znaçka, kështu sheja, kimika. Gjithçka patën prodhu mo... miliona sene!

Edhe më kujtohet qajo arusha shumë u kanë një shejë identifikuese të cilën këta kishin nisë një vjet ma herët me promovu për çashtjen e olimpiadës po na nuk e mrrimë qat' pjesë se u kthym në Prishtinë. Domethanë '73, kur ja kom nisë unë shkollën fillore... e kom nisë në të '79-tën, taman kur jena kthy, në shtator të '79-tës.

Kaltrina Krasniqi: Ku u kthytë?

Fisnik Ismaili: U kthym prapë në soliter qaty. Edhe...

Kaltrina Krasniqi: A kish ndryshu diçka?

Fisnik Ismaili: Po pak më kujtohet mas kthimit se nuk ka zgjatë shumë edhe kena dalë prej atyhit. Diqysh soliteri, 1-shi u kanë soliteri, bash i pari aty te fontana. Pak më kujtohet prej mahallës parashkollore, nashta kur ia ka nisë shkolla edhe kur jena bajtë prej atyhit në Dardani, mu më kujtohen ma shumë do sene qatje në Ulpianë se plot shokë kanë jetu qanej.

Kaltrina Krasniqi: Mandej në të '79-tën, u kthytë...

Fisnik Ismaili: '79-tën u kthym. Më kujtohet tash prej tregimeve të nanës se unë gjashtë vjeç kom qenë, s'dojshin me më pranu në shkollë se i vogël, pak mosha e hershme. Në anën tjetër unë kështu me trup shumë i madh edhe Faik Ispahiun e kom pasë shok të mirë, Faiku është tash në BIRN, sigurisht e njihni. Ai ka qenë një vjet para meje. Anesën, nanën e Dua Lipës e kom pasë kojshike edhe shoqen ma të mirë kështu në klasë të parë, edhe...bile edhe simpati e kom pasë! Shoqe të bankës.

Tani më kujtohet që ka shku... nana e pat' lutë mësusen me më marrë se ish katër vjet diferencë me motrën e mesme edhe dojke te e njëjta mësuse me m'çu edhe mas do shtytjeve, qatëherë pranun me më marrë. Kur hina në shkollë unë një kry ma i madh se tjerët.

Kaltrina Krasniqi: Ku shkoshje në shkollë?

Fisnik Ismaili: Në "Hasan Prishtinë" qaty meniherë. Një kry ma i madh se tjerët. Disha me shkrujtë, disha me lexu, që i kisha mësu krejt. Ja nisa me u bo problem për mësusen se ja nisa me i shku nerva.

Kaltrina Krasniqi: Kon' e ke pasë mësuse?

Fisnik Ismaili: Hylkije Qirezi. Hylkija ka qenë koxha në moshë po ka qenë njona prej mësuseve ma të mira në "Hasan Prishtinë". Kom kujtime shumë të mira me to. E patëm dashtë tepër, plus fakti që kish edhe motra jem tregime paraprakisht edhe dashni të cilën diqysh e kom trashëgu prej motrës, po edhe i shkoshja nerva se a din në fillim na i mësojshim shkronjat, unë e çojsha dorën edhe...deri dikur i tha nanës, "Qite në klasë të dytë pash Zotin!" Po tash në mes të Faikut edhe Anesës edhe shoqnisë që i

kisha kriju në klasën e parë e shoqeve, shoqe e bankës e...unë s'deshta, nashta më kish ndryshu komplet jeta t'kisha dalë qatëherë në klasë të dytë po unë kategorik kom qenë mos me dalë, edhe pse Faiku m'ka lutë shumë, se nime jena shoqnu shumë. Dytë jena kanë pak trashalluka, që na ka përcjellë edhe në pleqni, masnej dytë edhe jena dobësu në të njëjtën kohë.

Nuk ka shku gjatë, qaty në mahallë ku shumica e shokëve të klasës kanë jetu, nuk ka shku gjatë na u bajtëm në Dardani, s'po më kujtohet viti saktë, '81-82.

Kaltrina Krasniqi: Në cilën pjesë të Dardanisë?

Fisnik Ismaili: Tash që i thojnë "Banesat e Adelinës". Mas asaj është çerdhja, mas çerdhes jonë do banesa të vogla tre-katëshe, jonë shumë të lezetshme, masnej është krejt si fushë përpara edhe është shkolla e portokalltë, e qaty. Domethanë te qato banesat e vogla, ato kanë qenë fenomenale. Faktikisht babi sa kena nejtë në Rusi, edhe qatëherë ka pasë të ardhuna edhe me qato ai e nisi me ndërto një shpi në Dragodan, e cila shpi nuk m'kujtohet. M'pat' marrë nja dy herë me kqyrë kur vishim najherë prej Rusie këtu.

Absolutisht nuk më kujtohet kurgjo veni, sot me m'çu në Dragodan nuk di me gjetë. Veç e di që u ndërtojke edhe s'mujsha as me imagjinu qysh o' me jetu n'shpi. Kom metë unë kësi fëmijë i banesave. Po kur e murrëm qat' banesë në Dardani, ja dha shteti. Se babi kur u kthy u bo drejtor i Fabrikës së Amortizatorëve në Prishtinë edhe e murr me udhëheqë një fabrikë e cila kish probleme, e u munojke me u knellë. Edhe aso kohe me pasë banesë të shtetit edhe me pasë shpi private të kqyrshin shtremtë, domethanë i bike që po keqpërdorë detyrën zyrtare. Në krahasim me sot qysh vjedhin e i keqpërdorin e krejt këto pozitat zyrtare, atëherë hajgare u kanë, po në atë kohë u kanë shumë e madhe për kit' punë edhe babi e pat' shitë shpinë. Domethanë s'ka dashtë me majtë shpinë, s'ka dashtë kurrë kërkush...me i jepë kërkujt shkas me folë për çfarëdo keqpërdorimi që munet me bo, edhe pse njerëzit s'nalen. P'e di edhe unë prej përvojës tem, sado që munohesh me punu e me konë i ndershëm, njerëzit gjithmonë kanë me gjetë arsye me t'u kapë dikah.

Po babi u munu qashtu me majtë një jetë, pavarësisht që kemi qenë ma të privilegjum, pavarësisht që financiarisht s'kemi, s'kemi pasë probleme asnjherë. Deri ma ka ble një lodër a një diçka, krejt shokët e mi e bojshin, unë e bojsha i fundit edhe nëse ata vishin prej naj familje që nuk kish të ardhuna sa kishim na. E maj n'men kompjuterin e parë, dy vjet e kom lutë deri ma ka ble. Krejt shokët e mi u patën bo me kompjutera, mu s'ma blejke. Në Dardani kom kujtime shumë ma të mëdhaja, shumë ma shumë, se qaty praktikisht ja kom nisë me u rritë...

Kaltrina Krasniqi: Ti ke jetu te kjo pjesa e parë e Dardanisë që është ndërto ma vonë apo?

Fisnik Ismaili: Po, po. Domethanë prej ballkonit tem, prej dritares së dhomës tem, ballkonit, u shihke ku o' tash shkolla. Atëherë ka qenë krejt livadh, pos qe kanë qenë banesat e solidaritetit të ndërtume buzë, qaty afër. Krejt livadh o' kanë, rruga, Emshiri anena krejt livadh. Nashta naj shpi sporadike aty-këtu. Nuk po më kujtohet a ka qenë i krymë a t'u u përfundu Stacioni i Autobusave, i cili u shihke,

në vijë ajrore larg, po u shihke prej dritares tem. Edhe poshtë qaty ku është shkolla qitash, livadh, kullotshin loptë. Dilshim na me ngucë atë djaln që i rujke loptë, me na njekë me thupër. Qisi sene...

Nji...edhe e kanë komentu shpesh nji...se tash qaty ku jetojshim na, qajo banesë ka qenë, i ka pasë tri hymje ka gjashtë banesa ku kanë qenë drejtorat e organizatave të ndryshme. Ka qenë drejtori i KEK-ut, drejtori i “Fazitës” që është, ka qenë fabrika e tapetave, ka qenë, s’po më kujtohet...njerëz që kanë qenë në funksion. Tash i thojshin, “Banesa e funksionerave”, edhe menjherë përballë ishin banesat e solidaritetit të cilat ishin dikun nja pesëfish ma të mëdhaja me pesëfish ma shumë njerëz edhe në të cilat ishin kryesisht raste ma sociale. Edhe ish njifarë mërie ndaj neve fëmijëve që lujschim aty se na ishim fëmijë ma të privilegjum, edhe nji pjesë të konsiderushme të jetës tem në Dardani e kom kalu t’u hongër dajak prej fëmijëve të solidaritetit t’u na njekë me na rrehë. Deri dikur pak ja patëm nisë me i ndreqë punët ma vonë kur nisën me u prishë raportet mes shqiptarëve e serbëve, masnej na u dashke me nejtë ma bashkë.

Po e di që shpesh më kanë nalë, shpesh m’i kanë marrë paret, m’kanë rrehë. Na kanë bo zullum. Ose merrshim u gujshim me gurë ka dy orë qaty. Në ndërkohë që në qat’ mahallë nisa me pa diqysh edhe ndërtimin e Prishtinës pak edhe qat’ farë rritjen. E di që te soliterat, edhe pse s’më kujtohet qaq, po te soliterat përte’ konvikteve edhe Bregut të Diellit ka qenë njifarë livadhi në të ’60-tat, në të ’70-tat në fillim, po nuk më ka ra anej me u sillë. Në Dardani jom sillë nalt e poshtë. Vitet s’jonë t’u m’u kujtu saktë, ngrohtorja ka qenë gjithmonë. Ngrohtorja ka pasë si nji oborr qitash ku është “Termokissi” aty ka qenë si nji oborr krejt me therra, kena kalu shumë kohë qaty. Dikun verës kur u thajshin therrat e u bojshin shumë të nalta, na hishim edhe i prejshim therrat, bojshim si tunella e mrena në therra të thata çelshim si dhoma, rrishim mrena qaty, bojshim, imagjinojshim sene, lujschim me dërrasa, me...atëherë s’kena pasë najfarë loje, kompjuteri ka ardhë koxha ma vonë.

E di që qaty jom njoftu me shokët ma të mirë të cilët i kom pasë të jetës, me të cilët fatkeqësisht na ka hupë raporti koxha, po qaty jena rritë, të cilët pak a shumë kanë qenë njëjtë. Tash diqysh ka qenë njifarë diference klasore, e ajo detyrimisht ty të shtike edhe me krijë shoqni, s’mujshe, a din diqysh kaniherë s’na lidhshin do sene edhe me shokë të klasës. Kush ish pak i shtresës ma të mesme, na bike me nejtë ma ngat, kush ish i shtresës ma të ultë, s’na bike fort edhe me u shoqnu se shembull ke pasë, e kena pasë nji djalë, u kanë i lagjes së spitalit, që u kanë koxha njifarë barabe, shok të klasës, e s’o që mujshim me nejtë na se s’guxojshje ti me shku në lagje të spitalit se hajshe dajak.

Kështu që ti detyrimisht as shok s’mujshe me bo ato, se edhe ai hajke dajak që po rrin me ty, i bojshin zullum mahalla. Edhe ti hajshe dajak se s’ishe pjesë e mahallës. Në atë kohë praktikisht lagjet të cilat i kom frkeuentu ka qenë Ulpiana se qaty e kisha shkollën edhe Dardania se qaty u rritsha, edhe nuk është që më ka ra shumë me dalë me pa. E di në shkollë të muzikës ja pata nisë me shku, nana më punojke në Bibliotekë Kombëtare edhe e kom përjetu atë tranzicionin që... ku është sot Galeria, qaty ka qenë biblioteka e vjetër. Nuk më kujtohet viti po në fillim të ’80-tave u pat’ ndërtu kjo me kupola edhe u patën bajtë këta, patën dalë në objektin e ri. Unë kom qenë qaty edhe m’bike m’u sillë.

Babi punojke te Fabrika e Amortizatorëve që sot është “Klani” [Kosova], pak në periferi të Prishtinës. Atij i pat’ ecë shumë mirë se pat’ arritë me bo marrëveshje me “Peugeot”-në me ja shitë amortizatorët

e prodhum këtu, edhe e bonën një lidhje me “Peugeot”, ia nisën “Peugeot” me pru, bishin “Peugeot”-ja në Kosovë edhe i shitshin ma lirë. Pat’ qenë njëfarë suksesi të cilin ky e konsiderojke koxha sukses madhor. Edhe mu s’më bijke fort me dalë nëpër pjesë tjera të Prishtinës. Ma s’shumti që më kujtohet është shkolla e muzikës të “Elena Gjika” qaty. Aty shkojsha të mësusja Pasionare, e cila koxha zullum më pat’ bo kështu për me, a din, ka qenë mësuse shumë e mirë po shumë e rreptë. Edhe mu mirë m’ecke piano.

Nana ka qenë ashtu ma moderne, vozitke në atë kohë. Domethanë e kanë pasë një kerr, e kena pasë të ‘60-tave, ‘70-tave e kena pasë një “Volkswagen” bubë, breshkë. Mas asaj në Rusi e patën ble një “Lladë”, një “Lladë” të portokalltë e kena pasë të cilën e patëm pru këtu edhe më kujtohet besa rrugëve... e qikjo është interesant çka po më kujtohet shumë prej Rosisë, po kthena pak, nashta qeshtu duhet me kcy...

Kaltrina Krasniqi: Jo, jo. S’ka problem.

Fisnik Ismaili: Nana vozitke qatëherë, jemi t’u folë të ’70-tat, bile pat’ marrë pjesë në do *rally* [Në gjuhën angleze] kështu gara që u kanë e pazakontë për një gru shqiptare në atë kohë. Edhe na kujtohet, ato bulevardet në Moskë jonë koxha të mëdhaja edhe i ke pasë disa shirita, korsi, po njona ka qenë e rezervume për kerre diplomatike ose kerre zyrtare, domethanë aty kërkush s’guxojke me u futë në qat’ korsi, o’ konë veç për kerre zyrtare, praktikisht u kanë për Brezhnjevën kur kalon ai. E na më kujtohet i kena pasë do targa të zeza të cilat kallxojshin që jena të hujë, domethanë ishim ma të privilegjum po as na s’guxojshim në qat’ shirit me hi, edhe e di saherë e shihshim semaforin e gjelbërt ja nisshim na, “Jepi, jepi, jepi, jepi!” T’u i bo presion mamit, ajo t’u i njëkë semaforat e gjelbërt me i nxonë, edhe e di që shpesh u futke në qat’ shirit me i ra ma trup, edhe e nalke policia me i bërtitë, kjo u bojke kishe s’po din rorisht i thojke, “Kqyre unë targat, kom kujtu që për neve është”. Gjithë u nxerrke qishtu.

Domethanë mami ka qenë njeri që u kanë ma e gjinshme, ma e gjallë, ma, a din, ma organizative. Babi u kanë koxha strikt, shkojke në punë, u kthejke në shpi. E ka pasë një orar të vetin, në 15:00 vike, meniherë u deshke, flejke deri ka në 17:00-18:00, u çojke rrike pak, hajke diçka, kqyrke lajmet. E ka pasë nifarë orari qashtu, të tillë. Dilke masnej nëse kish me dalë.

Kaltrina Krasniqi: Me cilin prej prindve ke qenë ma i afërt?

Fisnik Ismaili: Me nanën. Me babën s’është që kom kalu shumë, shumë kohë. Nana prej, po thom, prej Rosisë që përditë ka nejtë me neve, ka qenë gjithë qishtu e përkushtume ndaj neve. Ashtu kaniherë u munojke si edhe shok u kanë, edhe ka qenë shok, po kaniherë edhe si e teprojke a din, se merrshim dojshim naj zhurkë me bo, me u mledhë shoqnia, ajo na i organizojke, “Lena bre a din, diqysh, lena na...” Masnej kish qef edhe me nejtë pak aty me kqyrë, e pak biber u bojke po jo, dike a din, kur o’ boll, edhe na lejke.

Po arsyeja pse e kom lanë faktikisht shkollën e muzikës ish se mami vike, tash unë metshta, i vogël, metshta të “Elena Gjika” te, s’po më kujtohet qysh e ka pasë emrin e vjetër shkolla...

Kaltrina Krasniqi: E ka pasë “Vuk Karadžić.

Fisnik Ismaili: “Vuk Karadžić”, po. Qaty meniherë përballë “Vuk Karadžić”-it ka qenë shkolla e muzikës. Më kujtohet niherë mami pat’ harru me ardhë me më marrë kur u kry me m’çu në shkollë. Se tash vike aty më çojke në “Hasan Prishtinë”, edhe pata metë unë, s’dishas kah me ja majtë, s’dishas as me u orientu, pak masi u patëm kthi prej Rusisë edhe t’u kajtë pata metë deri ju ka kujtu mas dy orëve (buzëqeshë) me ardhë me m’ marrë, m’ka gjetë qaty edhe kom thanë, “Ma s’shkoj në shkollë të muzikës”, s’kom shku. E kom lanë pianon, shumë pishman i bi, tepër pishman i bi. Saherë nij diçka me piano, më mushen sytë me lotë, po ndodhi çka ndodhi.

Pjesa e Dytë

Fisnik Ismajli: Edhe kurgjo, piano kena pasë në shpi, motra ia pat’ nisë me i ra, po edhe ato si e la diqysh. E kemi pasë një banesë shumë të madhe në Dardani, secili e ka pasë një dhomë tonën, që për atëherë koxha ka qenë njëfarë privilegji. Unë e kom pasë dhomën e kthyme përpara, domethonë ka Stacioni i Autobusave kah, ma vonë u bo shkolla. Rruga u konë qaty, qaty lujshim futboll, qaty lujshim ma vonë basket. Qaty praktikisht krejt jena sillë, qetash kur po e mendoj një pjesë të shkollës fillore, pjesën ma të madhe e paskna kalu në Dardani, pjesërisht në Ulpianë, nuk është që m’paska ra me shetit najkah tjetër.

Kaltrina Krasniqi: Domethonë jonë konë t’u u ndërto?

Fisnik Ismajli: Absolutisht. Koxha edhe dikun kanihere e shtyjsha deri në Lakrishte, se Luli shoku ma i mirë i klasës, edhe interesant qysh kom kriju raporte, gjithë raportin ma të mirë e kisha me ma të shkurtin e klasës, edhe në fillore edhe në të mesmen. Edhe gjithë qashtu me Lulin, ai jetojke në Lakrishte, e përcjellsha deri në Lakrishte. Nana e Lulit ka qenë mësuese e gjeneratës së njejtë në “Hasan Prishtinë”, kshtu që me to m’ka ra ma shumë se na bijke rruga e njejtë. Ndërkohë që u çelë, ia nisi m’u maru shkolla në Dardani, më kujtohet që aty zhdrypshim me vjedh drrasa, me ikë prej *strazharit*¹, na vjedhshim drrasa me maru ksi pushka me u gjujt, me lujt me... qe e kom shkru në status ai *counter strike* i jonë i ktyne herë ka qenë qai. Me lujtë kaubojë e indianë ose partizanë e gjermanë qeto dyja i kemi pasë. Jemi rritë me filma me gjermanë e partizanë e kaubojë. Kom lexu shumë stripa, ekstrem shumë stripa kom lexu edhe qaty unë faktikisht, pjesën ma të madhe të serbishtës e kom msu në stripa. “Zagori”, “Blek Stenën”, “Komandant Markun”, “Kapetan Mikin”. “Kapetan Mikin” e kom pasë kshtu *favourite* [Në gjuhën angleze].

Kaltrina Krasniqi: Ku i blejshit ato?

Fisnik Ismajli: N’trafika e ke pasë, po edhe kom pasë fatin me pasë kojshi Luanin, i cili ma vonë u bo edhe burri i motrës tem, i cili e ka pasë një koleksion të hatashëm të stripave, përmbi dy mijë stripa. Edhe praktikisht nuk ka publikim... kur jom ulë njijherë me mendu, se unë në 2003 jom kthi në Kosovë

¹ Serb.: *Straža*, roja, në këtë rast, *strazari* është rojtari.

për me bo stripa, dikun m'u kanë kujtu nja 24 [lloj] publikime serbisht edhe kroatisht në Jugosllavi që i kom lexu une, që të paktën një kopje të një stripi, i kom pasë do seria që i kom lexu komplet. Nuk ka, të rrallë janë ata tituj të stripave që janë botu në Jugosllavi që nuk i kom lexu. Edhe “Zabavniku” ka qenë “Politikin Zabavnik”, hala e konsideroj njana prej revistave ma argëtuese dhe edukative në rajon.

Kaltrina Krasniqi: A ka qenë kjo diçka që e kanë bo shumica e gjeneratës tande?

Fisnik Ismajli: Ah, jo bash, bash. Me “Zabavnik” jom njoftu, qetash të tregoj për atë pjesën që e kom kalu nji kohë të madhe në Mitrovicë. Se praktikisht unë shkollën, praktikisht, po s'po më kujtohet periudha ndoshta pa shku në shkollë, ndoshta për qeta nuk m'kujtohet shumë “Soliteri” se qët' pjesë, m'ikin. Prindtë punojshin, motrat në shkollë, unë vet në shpi. Nji pjesë të fëminisë e kom kalu në Mitrovicë te gjyshja, domethonë më çojshin të hanën më merrshin të premtën, kshtu që rrijsha tanë javën në Mitrovicë ose shpesh ka ndodh për pushime verore, dimrore me kalu shumë kohë te gjyshja.

Kaltrina Krasniqi: Ku ka jetu gjyshja në Mitrovicë?

Fisnik Ismajli: Ka jetu në Soliterin e kaltërt karshi Jugobankës menihere përballë sallës së sporteve edhe urës së Ibrit, për dritare mujsha me pa urën e Ibrit, sallën e sporteve, bash, bash qendër. Aty më kujtohen dy, më kujtohet ambëltoja që sot hala “Ballkani” edhe ngat asaj o konë “Egipati” “Egjipti” [shqip], “Egipat” në serbisht. Në “Egipat” unë i dojsa princes krofnet ma shumë se ato të “Ballkanit” qasi kujtese kom pasë të “Egipatit”, saqë njihere kur i kom bo njizetë e fiu vjet në Angli pata pa andërr që ia patën shitë kinezve edhe ata e kishin bo *Chinese Restaurant*² e kishin kthy ambëltojen, m'u pat' dhimtë shumë. Hallall i koftë “Ballkanit” që e ka majtë edhe e ka prezervu qat' çka ka bo edhe “Elida”, që u mundu me majtë njifarë trashigimije.

E “Egipati” nuk e di pse e ka shitë çka ka ndodh, por aty e kom kalu një kohë të konsiderueshme të fëmijënisë. Pilara ka qenë një dugoje³ ku gjyshi m'çojke, e ka pasë një erë shumë karakteristike edhe zakonisht dyqanet e *Vočarit*³ e kanë pasë qat' erë karakteristike, mujshe me e identifiku prej erës, era e Pilarës nuk muj me përshkru, kombinim i produkteve bashkë me pentë që kanë nejt bashkë, nuk e di me përshkru por meniherë m'kthen në qatë kohë, m'i blejke do çokollada të “Krašit”⁴ që o konë Braca edhe Seka që jonë konë motra edhe vllau jonë konë të kuqe edhe të kaltërta.

Edhe kujtesën tjetër që e kom kshtu ma të omël prej Mitrovicës osht' tash për me shku prej Soliterit të kaltërt duhesh me kalu ka korza, me dalë te Luxi [Hotel] që osht' ajo shpija e mallnave te “Jadrani” ku osht' KFC sot. “Jadrani” e ka pasë një furrë shumë të famshme në Mitrovicë, edhe pothujse çdo mëngjes unë shkojsa me ble pitalka edhe qefi jem vo të zime edhe do pitalka të nxeta me margarin, pak kryp edhe vo të zime, si sendviq me hongër. Kshtu, hala jargitna veç kur e menoj. Gjyshja e dijke, se mu me m'lonë veç vo ha; tri here në ditë edhe kurrë s'e kom problem. E dijke gjyshja edhe m'çojshin me ble pitalka shpesh, edhe qai tripi deri sa shkojshe atje, e merrshe pitalken e njetë e deri sa shkojshe ne shpi e hajshe gjysën tu e picku kapak nëpër qendër të Mitrovicës.

² Eng.: *Chinese restaurant*, restaurant kinez.

³ Srb.: *Vočara*, dyqan i pemëve dhe perimeve.

⁴ Cro.: Kraš, brend i qokolladave të Kroacisë.

Në Mitrovicë gjyshi im e ka pasë koleksion të “Zabavnikave”, jemi t’u fol duqa të mëdhej në ballkon {përshkruan me duar}, ku për shembull unë një gjysëvjetor nuk shkojsha hiç në Mitrovicë, kur shkojsha më pritshin, sa i bijke aty shkojshin nja 10-15 jave, varësisht sa javë shkojshin se ajo të premten dilke, plus kishe numra të kalum. Plus që i kishe edhe numrat e kalum. Unë qaty kom vazhdu me kultivu serbishten si gjuhë, se ti deshte s’deshte detyrimisht e mson t’u lexu çirilicën në “Zabavnik” edhe t’u lexu stripa, e me qeto dyja e kom majtë, e kom majtë. Ruishtën e kom harru meniherë në shkollë fillore, se m’shtike msusja me recitu në shkollë fillore, se kqyre e kemi ktu një nxansë që dinë rusisht, masnej e krejt shkolla m’thojke, “Qy rusi i prishtë!” Tani krejt shkolla bojshin hajgare edhe më *bulliratshin*⁵ mu. Deri sa ia nisa me refuzu me folë rusisht, sot nuk flas.

Kjo osht’ njona prej pishmoneve tjera, përpos pianos, unë menoj që sa gjuhë i din për qaq njerëz vlen. Me harru një gjuhë që e ke ditë osht’ inat i madh. Sot kur e menoj, në atë kohë m’u ka dokë ma e logjikshme se edhe rusët atëherë u konsiderojshin ma të prapametun edhe tek me kohën masi kom shku me jetu në Angli e kom kuptu sa superiorë ja kemi rreh vetit edhe hala ja rrehim na si shqiptarë, si shoqni shpesh menojna qe krejt univerzi sillet rreth neve edhe sa racista, sa ksenofoba kemi qenë edhe një pjesë e madhe jesin hala. Po, që atëherë është dokë normale me i sha rustë me i sha ata, me i përqesh bugartë, që me të vërtetë kanë qenë klasë krejt tjetër dallim prej neve, po mënyra se si i kemi kqyr ata.

E kur e menoj, qysh koxha të rondë kemi qenë, po edhe sot nuk osht’ që nuk ka asi njerëz qashtu, po atëhere ka qenë ma e pranushme. Kshtu që edhe sot kur bojmë qasi sene ti thu, kadal, ki edhe shumë ma shumë njerz që thojnë, “Kadal mos thuj qashtu për X nacionalitetin”. Atëherë na kemi qenë ma t’mirtë edhe s’ka pasë ma t’mirë se na. Po get, u konë ndikimi i propagandës jugosllave në përgjithësi {pi pijen}. Ku secili u shtyjke t’u e livdu vetën, sigurisht edhe vendet tjera kanë pasë propagandë nëpër media, e ka naltësu vetën.

Kaltrina Krasniqi: Kur ke fillu me shku në shkollë të mesme, në cilin vjet?

Fisnik Ismaili: Në shkollë t’mesme ia kom nisë s’po di qysh po i bjen qetash, në ‘91-tën e kom kry, që po i bjen ‘87-tën, ‘86 - ‘87, “Ivo Lllolla Ribar” që i bjen “Sami Frashëri”. E tash veç ia nisi me u zgjonu Prishtina për mu. Përndryshe, kur u çelë “Dardania” unë jom konë njoni prej tyne... se metën veç nja dy vjet a tri, s’po m’kujtohet, se plot shokë ishim që kanë jetu në Ulpianë dhe u shpërndanë në lagje të ndryshme. Shoku jem ma i ngushtë Valoni pat’ shku me jetu në Breg të Diellit. Edhe kur u çelë, pothujse në të njejtën kohë u çelë “Ismajl Qemajli”, qysh e ka pasë atëherë emrin, “Josip Broz Tito” edhe “Dardania” pothujse në të njejtën kohë jonë çelë. Ai dulë prej “Hasan Prishtinës” në “Josip Broz” unë nuk dola në “Dardani”...

Kaltrina Krasniqi: Qysh e ka pasë emrin “Dardania”?

Fisnik Ismaili: “Dardania” e ka pasë “Dardani”, jo “Vladimir Ilić Lenin” qe besa mirë ma kujtove që... u konë shkolla e portokalltë, unë i thojsha edhe nime bojshim hajgare, “Nëse nuk të del gjumi veç çeli

⁵ Eng. *Bully*, ka kuptimin e personit i cili përdorë superioritetin e tij/saj për të poshtëruar tjetrin. Folësi përdor termin bulliratë, folje që derivon nga *bully*, në këtë rast ai ka qenë i keqtrajtuar.

perdet...” se përnime si t’i çelshe perdet seni i parë e shihshe shkollën, “i çelë perdet edhe të çelën sytë”. E kur i bijke dilli në mëngjes përnime t’çorrojke...

Kaltrina Krasniqi: Ju aty e keni kry shkollën?

Fisnik Ismaili: Ja a. Une jo, por ka pasë plot që u patën bajtë prej Ulpianës në Dardani që patën shku. Une jo, se ishin dy-tri vjet në pytje, s’dojsha me prish qatë shoqinë. Diqysh e menojshta masi nuk shkova në klasë të dytë me prish, a din, me dalë prej klasës, s’po dal. Edhe faktikisht, s’po m’kujtohet krejt shoktë e klasës patëm metë, kërkush s’pat’ dalë në “Vladimir Ilić Lenin”.

Koincidentalisht sa kom qenë në Rusi, njo prej kujtesave që i kom, patëm hi në Kremlin, në Masoleum, edhe e kom pa Leninin e balsamum. Edhe pak kur po e menoj qetash sa i kom pasë, pesë vjet me shku me kqyr nji njeri të dekt... . Mënyra qysh e trajtojshin u konë shumë... qetash kur e menoj, atëherë m’u doke normal krejt, u doke thu se po flen. Po qetash kur e menon me prezervu nji njeri me u sill njerëzit rreth tina, me naltu dikon qaq shumë... {rrudh krahët} m’duket shumë jonormale. S’di a osht’ hala, a e majnë hala a e kanë hekë? [i drejtohet intervistueses] Veç po m’kujtohet ashtu e kqyrshë njerin e dekt t’balsamum, prej naltit ka qenë e ai poshtë e ti u sillshe si në rreth.

Edhe qaty në Dardani, ia nisi me u ndërtu Dardania, në ndërkohë kur ia nisa...

Kaltrina Krasniqi: Kur po thu ia nisi me u ndërtu Dardania, Banesat e Solidaritetit a kanë ekzistru?

Fisnik Ismaili: Po ia ka nisë shkolla...

Kaltrina Krasniqi: E Kurrizi?

Fisnik Ismaili: E Kurrizi pak ma vonë, po edhe ato të bardhat [banesat] që janë mas shkollës, krejt qanena... qanej e di që pata sharru në lloq, m’pat’ hup njona këpucë sa e pata ble. Natë, shkum na qeshtu t’u ngajtë me ngucë strazharin diçka, sa i pata ble kpucat e reja “Adidas” si gjysë patika-kpuca. E m’sharron koma mu, e kur e nxerri pa ksi. Ia nisi ai roja me na njek, me na rreh, e kur po m’sheh mu t’u kajt, “Çka u bo, çka u bo?” “Oh, kpuca jeme, jeta jeme”. Hala m’ngucin shoktë, “Kpuca jeme, jeta jeme”.

Edhe ia nisë edhe ai me bateri me lypë kpucën, tash nuk na kapi me na rreh, po t’u e lupë kpucën tem. Edhe nuk e gjeta. Shkova tinxa hina diqysh dathun, kpucat sa i pata ble. Hina dathun edhe t’u mos flejt tonë natën që me u çu herët n’mëngjes që me kqyr me lyp kpucën edhe e pata gjetë. Edhe veç pak maja ju shihke, edhe e gjeta kpucën. Edhe s’i kallxova mamit. Masnej nja tri orë deri sa ia pata fshi lloqin.

Qesi farë, bojshim qesi farë mangupllëqesh, po jo najsen, jo najsen. Ma shumë jonë konë diqysh si do lojë ma intelektuale. E kqyrshim qatherë “Gallaktika” ka qenë e famshme. Unë kshtu jom dashamirës i *science fiction* [fantashkencë], pi stripave edhe TV programeve të asaj kohe, posaqërisht *Star Track*-un e qitke Bosnja, nëse nuk gaboj boshnjaktë e kanë qitë *sitcom*-at [seriele] ma të mirë i qitke Zagrebi. Edhe e kisha qatë përparësinë që e disha gjuhën, e kuptojsha.

Kaltrina Krasniqi: A shkojshit në kinema?

Fisnik Ismaili: Në kinema, po qysh jo. Po, qysh jo në kinema s'kom lonë film të Bruce Lee-së pa e kqyr të cilin masnej e rishikojshe...

Kaltrina Krasniqi: Në cilën kinema?

Fisnik Ismaili: Qysh?

Kaltrina Krasniqi: Në cilën Kinema shkojshe?

Fisnik Ismaili: Varësisht ku vijke filmi, domethonë "Rinia 1-shi, 2-shi", "Vllaznimi" që osht' ABC-ja sot edhe JNA, "Armata", "Kino Armata" s'ja kena huq, varësisht prej filmave. Në JNA nëse nuk gaboj...

Kaltrina Krasniqi: Çka të kujtohet?

Fisnik Ismaili: Më kujtohen kryesisht filmat me Bruce Lee-në, ata jonë konë *our favourites* [kanë qenë të preferuarit]. Më kujtohet njihere, kur u rritëm pak patëm shku edhe porno me kqyr.

Kaltrina Krasniqi: Ku ka qenë kjo?

Fisnik Ismaili: Në "Kino Rini", ka pasë, po. Te "Kino Rinia 1-shi", 2-shi ka qenë ku është "De Rada" qetash. Patëm shku edhe porno me kqyr. Filma të dashnisë bijshin, zakonisht "Kino Armata", domethonë JNA bijke do filma ma të çuditshëm. E kta ma *mainstream* [të zakonshëm] "Kino Rinia" edhe "Vllaznimi". E maj në mend, vitin s'po m'kujtohet, *Platoon* pat' dalë, *Top Gun*, normal tash çfarëdo filmi që e sheh dojshe me bo profesionin e rolit kryesor. *Platoon* me Willem Defoe, ka qenë njeni prej filmave, Tom Berenger ka qenë njeni prej filmave me tematikë të Vietnamit që absolutisht pata dalë t'u kajt, mas çdo filmi të Bruce Lee-se jena dalë t'u rreh. Bilem, m'kujtohet një rast i një dosti t'u u rreh ua-au {onomatope} si u rrxu pak, "Aaa dora, dora", na, "Hajt, hajt mirë e ki" a din kur ia kthen dorën në vend dikujt {tregon me duar} "Hajde, hajde" ai, "Ua-haa" {onomatope}. Shkum deri në shpi, "O bre qekjo dorë diçka ua-ua". Kur të nesrit s'po vjen në shkollë, çka u bo, ai dorën e kish thy (qesh). Ai e ka thy dorën, e s'e ka ditë as vet. E na t'u u munu me ia ndreq (qesh).

E kom kqyr filma shumë. Kom lexu ekstrem shumë stripa. Po thom, Luani ka pasë i ka pasë shumë 700-800 stripa, nashta ma shumë. Edhe masnej m'i pat' falë mu, na edhe garazha kena pasë, i majsha n'garazhë. Edhe kur pat' ble mami parket, e ka dashtë me lonë n'garazhë, s'ka pasë ku me lonë m'i pat gjujtë mu stripat pa m'vetë n'bëllog. Nuk i pata folë nja gjashtë muj. Nuk, s'di me ta spjegu dashninë që e kom pasë ndaj stripave. Nuk i kom folë gjashtë muj, unë sot ia përmeni parketin, t'i kisha pasë ata stripa sot, ata jonë s'po di... është një thesar... që thjeshtë veç i ka marrë edhe qkllup {onomatope} m'i ka marrë edhe gjujtë në kantë të bërlllogit. "Hajt bre se i ke lexu krejt". "P'e di që i kom lexu, po une i kisha lexu ka katër here". Unë kujtohna kangët sot që i nij, kangë të Depeche Mode e do kangë që i ngojshin motrat e mija, një kasetë që i inçizojshim atëhere me kangtë ma të dashtuna. Unë i nij kangët edhe m'kujtohen kohnat kur lexojshim stripa t'u i ngu qato kangë. Edhe diqysh menihere tërqethna edhe menihere qajo, qajo pjesë m'kujtohet.

Kshtu që, stripa, filma, televizion, *shows* [seriale], domethonë *Only fools and horses*, *Star Trek - The Next Generation*. Krejt i di me emër, mbiemër, personazhet, historitë, *Alo-alo*, çka ka pasë tjetër që kqyrshim...? Pak a shumë... jonë edhe do tjera, po që nuk po m'kujtohen tash. *Alo-alo* edhe *Only fools and horses*, *Mucke* e ka pasë emrin në Kroaci, ato s'ia kom da, deri sa kom shku në Angli. Kur kom shku me jetu në Angli unë kom shku në Peckham, veç me kqyr mahallën të cilën ata e përshkrujshin në serial. Qasi ndikimi ka pasë në neve.

Tash kur e nisa shkollë e mesme, qatëhere ia nisi me m'u zgjonu edhe ai shtegtimi nëpër Prishtinë ma shumë, sepse ecsha zakonisht, [autobusin] 4-shin rrallë e merrsha, 4-shi *forever* [përgjithmonë] ka kalu qanejna ka shku në Gërmi. Ma rrallë me autobus, ma shpesh kom shku në komë prej Dardanisë në "Ivo Llollë" që po i thojnë "Sami Frashër". Edhe qatëhere m'bijke, që e kom përshku në status, qysh m'ka ra me kalu ka *Lepa Brena*, tash ndërtesa e KEK-ut, me pa kah marohet, me pa postën e re kah marohet, se qanej më bijke kah posta e re. Me vazhdu ka Radio Kosova, e cila veç është ma e vjetër, ku o Radio Kosova tash, dikur RTP-ja ka qenë. Shkojsha deri në Bibliotekë ia merrsha do pare nonës, vazhdojsha ka [Hotel] Grandi, korzës, atëherë rruga ka qenë e çelme, korzës dilsha te shpija e mallnave "Gërmia", e cila po përflitet kaq. Për mu, unë nuk kom pasë najfarë lidhje emocionale kurrë me to.

Ku osht' ndërtesa e qeverisë, ka qenë Banka Qendrore, babi u bartë prej amortizatorëve edhe u bo guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës, edhe u nalsha...

Kaltrina Krasniqi: Qajo që osht' Bankos, apo?

Fisnik Ismaili: Jo, Bankosi, ka qenë ku osht' "LC Waikiki" qetash.

Kaltrina Krasniqi: E Banka Qendrore a nuk ka qenë ku osht' Banka Qendrore aktualisht?

Fisnik Ismaili: Ja a.

Kaltrina Krasniqi: Çka ka qenë aty?

Fisnik Ismaili: Po m'doket naj sindikatë aty. A diçka qeshtu {pi pijen}. BQK-ja aty poshtë te NEWBORN-i a po? M'doket sindikatë a diçka, po s'u konë bankë. Banka Qendrore e Kosovës ka qenë në ndërtesën e qeverisë sot. Babi qaty e ka pasë zyrën në kat të tretë. Nëse nuk gaboj Kryeministri sot e ka zyrën e njejtë. Edhe unë masnej t'u shku u nalsha...

Kaltrina Krasniqi: Ajo pjesë ka qenë e hapun? Banka Qendrore, Posta...

Fisnik Ismaili: Posta, Kuvendi, komuna...

Kaltrina Krasniqi: A mundesh pak me ma përshku? Garant qashtu edhe ke shku në shkollë...

Fisnik Ismaili: Masnej une kom shku në...

Kaltrina Krasniqi: Se ajo pjesë nuk është e hapun qe 20 vjet.

Fisnik Ismaili: Mu m'doket normal, se tash kur hi në Kuvend mu m'bjën me kalu aty...

Kaltrina Krasniqi: Po de, ju po ajo nuk është e qasshme për neve tjerëve.

Fisnik Ismaili: Ki shumë drejtë, tash po m'shtin me menu. Si rrafsh u konë s'ka pasë rrugë m'duket.

Kaltrina Krasniqi: M'duket ka qenë pllato.

Fisnik Ismaili: Si pllato nëse s'gaboj, po m'doket që pllato o konë.

Kaltrina Krasniqi: Çka ka qenë aty, Enti Statistikor jo, po...

Fisnik Ismaili: I kontabilistave diçka...

Kaltrina Krasniqi: I shërbimeve sociale ndoshta?

Fisnik Ismaili: Edhe diçka edhe Shoqata e Kontabilistave ka qenë aty.

Kaltrina Krasniqi: Po, përballë Këshillit Ekzekutiv, çka osht' tash parlamenti.

Fisnik Ismaili: Op, edhe... po une i bijsha ma shumë knej ka rruga...

Kaltrina Krasniqi: Qysh ka qenë aty se edhe ajo ka ndryshu shumë? Domethonë prej Unionit e te...

Fisnik Ismaili: Interesant Unioni kurrë n'sy nuk m'ka ra, sa m'bike Bozhuri për shembull. Unioni gjithë u konë një ndërtesë që kurrë s'un i ke ra në fije çka ka në to, kurrë s'jom konë kurioz me hi në to. E ka pasë nifarë aure që të shtyjke, "Mos m'u afro!" S'di pse, s'di pse! Bash kisha pasë qef me ditë a ka mendu edhe najkush qashtu. A u konë hotel ai? [i drejtohet intervistuesës]

Kaltrina Krasniqi: Po, shumicën e kohës.

Fisnik Ismaili: Mu babi më merrke në Bozhur kur dilke me pi apo në Grand, po në Union kurrë.

Kaltrina Krasniqi: Qysh ka qenë brenda në Bozhur? Se Bozhuri ka ndryshu.

Fisnik Ismaili: Bozhuri e ka pasë një restoran zhmë {onomatope}, asi restorani si sallë e dasmave që u konë përdhesë, edhe u konë tipik asi, asi hoteli i kohës të Jugosllavisë a din, ka plot qasi që e kanë nifarë yrrneki të njejtë, një recepcion, ai restorani, terasa edhe një restoran ku rrishin tanë ditën edhe pijshin raki qaty, edhe Grandi e ka pasë... Grandi ka qenë pak a shumë më ekskluziv, u patën munu aty me do llajsne me do sene me ndreq po. Por ajo byfeja poshtë, ajo kafja si kafe e ka pasë nifarë... edhe erën e kishin të njejtë sikur kto ktu, sikur Narcisi në Brezovicë, sikur një hotel tjetër në Kopaonik që patëm shku edhe do hotele qesi të Jugosllavisë. Diqysh edhe erën e njejtë, Molika edhe drunin e njejtë edhe pamjen diqysh si me pasë maru prej një yrrneku. E nuk u konë najsen impozant, kshtu që babi shihke ma shumë shokë, dosta qaty se sa në Union. Hiç absolutisht nuk po m'kujtohet një herë e vetme që kom hy në Union une. E ka pasë nifarë, s'di, e ka pasë nifarë aure si me t'shty, diqysh si me t'thonë, "Mos u afro!" A m'ka tutë që osht' ma i vjetër, a ... nuk e di veç t'rrej.

Kaltrina Krasniqi: Qysh ka qenë qaty?

Fisnik Ismaili: Qanej pak m'kujtohet, ndoshta tash t'u kalu shumë e t'u e pa qat' farë zbraztinën ja kom nisë me menu që qashtu gjithë u konë, po edhe pse po mundohna me u kthy në atë kohën mas luftës kur jonë konë qato ka dy kat, bile u konë një dugojë që në katin e dytë e ka pasë tamon derën, u konë dera poshtë edhe në kat të dytë u konë dera, me çelë veç bijshe në rrugë (kesh). Bile e kom edhe në fotografi dikah me lypë. Po u konë qashtu, pa ka shumë si qajo pjesa ma poshtë që osht' si, si vençanica, fustana të nuserisë, e argjentarë. Qashtu, qashtu e kom nifarë kujtese për to. Edhe qaty si ia niske ajo pjesa e vjetër e qytetit. Ma heret ia niske, jo qaq vonë. Qetashti si o hupë pak.

Më kujtohet qeshmja ku pijsha ujë shpesh te xhamia edhe masnej nuk ke pasë najsen impresive, pos burektores që u nalshe me hongër deri te "Sami Frashëri" deri te "Ivo Llollla".

Kaltrina Krasniqi: A ka qenë aty naj burektore e njoftun aty, a qysh?

Fisnik Ismaili: U konë aty një burektore karshi, tash m'doket hala është ambëltoore, a s'di çka. Karshi Sahat Kullës qaty, kur del pak ma në t'majtë, jo ku osht' "Sulltani" tash, po ma në t'majtë. Qaty në pushim të gjatë u hajke bureku. Qebaptore s'di a ka pasë.

Kaltrina Krasniqi: Pse patët vendos me shku në gjimnaz?

Fisnik Ismaili: Pse? Pse kom vendos, a pse kom vendos në qat' gjimnaz? A n'përgjithësi në gjimnaz?

Kaltrina Krasniqi: Po de, pse në përgjithësi në gjimnaz?

Fisnik Ismaili: Jo, ti n'atë kohë s'ke mujtë me i pasë prindtë me fakultet edhe ti mos m'u shkollu. U konë presion i natyrshëm i shoqnisë që nuk vjen në shprehje fmija... tash ti mi se rrallë e ke gjetë që te dy prindtë jonë me fakulteta ss... u konë e papranueshme fmija m'u konë ma pak diçka. Pritjet tash ishin ma t'mdhaja. Unë faktikisht, presionin ma t'madh n'jetë e kom pasë prej babit për pritjet që i ka pasë për mu. Edhe...

Kaltrina Krasniqi: Çfarë pritje ka pasë?

Fisnik Ismaili: Edhe menoj që bash qajo ka ndiku se... qe motrat e mija, motrat e mija asnjona s'ka mrri me kry fakultetin, te dyjat kanë metë shtatëzanë, jonë martu herët, që nifarë mënyre babin e kanë dëshpru shumë. Edhe mu m'ka metë qajo barra masnena me bajtë edhe për mossuksesin e ktyne dyjave. Se për to ishte e paimagjinushme qysh a din, dy prindtë me fakultet, e ju s'pe kryni. Edhe nashta, une menoj, bile edhe e kena folë se babi ka dek para dy vjet e gjysë, kur kena folë me motrat bash kena thonë, pikërisht qeky presioni që na ka bo neve si fmi ka mujtë me ndiku në ato dyjat që ato m'u dorëzu diqysh, me thonë, "A din çka s..." Që në mu ka pasë efekt tjetër. Mu ma ka ngritë inatin edhe m'ka kallë krejt. Masnej une, për inati u mundojsha me bo diçka me ia dëshmu atina që muj me bo, por jo n'atë mënyrën qysh ka dashtë ai, e kjo m'ka rrebelu mu. Se ai ka dashtë une m'u bo financier. Une, mu m'pëlqejke krejt diçka tjetër. Por, për me bind ato që edhe t'u qenë diçka tjetër muj me bo ma s'miri. Se ai edhe standardet m'i ka qitë shumë nalt. Non-stop kom pasë konflikt me to,

se nuk... knej u rrebelojsha në sensin që s’dojsha me bo çka po don ai me bo. Për mu ish, “A po don me kry une fakultetin, po, ama kom me kry çka po du une”.

Kaltrina Krasniqi: Çka kishit qef ju me bo?

Fisnik Ismaili: Une, une vizatojsha shumë mirë edhe dajën e kom piktor. Jom rritë me nifarë ambienti ku dashmirë të artit, a din, një pjesë e familjes jemi arkitekta edhe ka pasë ndikim në mu, po edhe herët mu ma patën identifiku këtë farë aftësinë me ditë me vizatu. Sot s’di hiç përndryshe. Edhe, po daja është edhe kritik i madh i vizatimit. Ai ty ta thotë që e ki bo keq edhe din diqysh që deri në pikën që t’vijke marre me i kallxu çka ki bo. Edhe e para habit kur i kom thonë me gjysë goje, se u pata tutë shumë, që po du me apliku në dizajn grafik. Po kjo ma vonë, ndoshta isha kthy ma... edhe me çfarë entuziazmi ai e pat’ marrë. Domethonë në fletore gjithë e ke pasë kauboj të vizatum, ke pasë patika, shumë kom pasë qef me dizajnu patika. Kom pasë një periudhe... qeshtu periudha të ndryshme vizatojsha në fletore sene të ndryshme. Një pjesë, një kohë kom pasë fiksim kaubojcat, një kohë e kom pasë fiksim Spidermanin, masnej patikat. Më kujtohet që vizatojsha, dizajnojsha patika në fletore.

Pjesa e Tretë

Fisnik Ismaili: “Xhevdet Dodën” e harrova tash. Në qet’ periudhë une, kur ia nisëm m’u rritë në shkollë fillore, une ma i riu, krejt hinën në pubertet para meje. Vec qysh kesh djali ma i gatë n’klasë, përnihërë u bona i pesti n’rend në fiskullturë, se në fiskullturë kur na renisshin, na renisshin prej ma të gatit. Edhe u kompleksova une pak, {pi pijen} se përnihërë nuk kesh ma i gati në klasë edhe ia nisa me mendu që s’kom m’u rritë kurrë. Në ndërkohë dy motrat m’u martun edhe une përnihërë u rrita qeshtu shumë shpejt, tash u rrita edhe krejt mahalla, krejt dostat, krejt klasa lujshin basketboll, une ma i gati nuk dijsa me lujt basketboll.

Tek në shkollë të mesme, në vit t’parë jom msu me lujt edhe ato apet me inat, t’u mos ditë e t’u bo hajgare me mu shkoj e ngjes një kosh bash te, në ballkon temin, qaty në Dardani edhe tanë verën me top në dorë bam-bum bam-bum {onomatope} s’po thom që jom bo basketbollist i mirë najherë, po t’paktën kom msu boll me lujt që m’u pranu n’shoqni, me lu për ekipin e klasës e qe besa edhe për ekipin e shkollës nihere. Edhe u msova me lujt edhe e krijova një shoqni të njerzve... tash përpos grupeve klasore që na definojshin ma herët shoqininë, tash ia nisën m’u bo qeto grupet e interesit.

N’qatë kohë ia nisi me hi në modë, ma s’pari e ke pasë futbollin është periudha e “Prishtinës” të ‘80-tave, të “Klubit Futbollistik Prishtina”, ku une prapa kom qenë ma i privilegjum se babi u bo kryetar i Klubit kur ia nisi në ato vitet ma të mira të Fadil Vokrrit, ku une kisha qasje nëpër stadion edhe mujsha me iu sillë nëpër komë atyne, ku ata shkojshin me lujt në Beograd une veç hypsha në autobus edhe përfundojsha në Beograd me ta, në Zagreb, në Split, në Osijek, në Rijekë, *you name it* [veç përmende naj emër]. Jom rrasë me shku me i kqyrë ata, unë nuk i kqyrsha ku i kqyrke publiku, une i kqyrsha prej asaj bankës të atyne fmive që mledhin topa.

Jena konë nja dy-tre djem që jena konë ma t’privilegjum, o konë djali... Urim e ka pasë m’doket, qetash e mora vesh që nuk osht’ mo gjallë, ai o’ konë ma i vogël se unë, djali i Qazës ekonomit, me ekonomi u merrke me, i mledhke topat, fanellat krejt të djersita, iu rrike gati krejt lojtarve, u konë djali i fizioterapeutit, djali i trenerit të “Prishtinës”, Mirza Muzuroviq, djali i Fuad Muzuroviqit, trenerit.

Domethonë, unë me ta rrisha qaty edhe krejt atë përjetimin e asaj kohës “Prishtinës” ma shumë e kom pasë prej visë së stadionit se sa prej tribunave. Edhe t’u i njoftë in *first name basis* [t’u i thirrë në emër] t’u i njoftë krejt lojtartë me emën e mbiemën.

Njoni prej tyne Luani i cili m’i ka falë qato stripat, kojshi i joni që lujke për “Prishtinën” s’i bike qaq shpesh me lujt se ishte rezerva e Fadil Vokrit, edhe veç iu dashke Fadilit me e thy naj komë për me mujt ai me hi, por ai ish rezervë, rezervist i cili në fund u martu me motrën teme sa u konë babi kryetar i klubit. Tash aty kish nifarë konflikti pak, ah {bën me kokë} ajo puna, po e kalumë. Edhe Luanin e kemi dashtë shumë se si fmi ai u konë shumë i afërt me neve edhe u konë sportist, futbollist, dilke lujke basket, na çkoqke basket, na çkoqke futboll, na çkoqke ping pong. E ka pasë një tavolinë në garazhë të ping pongit, a din jonë do sportista që secili sport i shkon. Lukin e kena pasë si nifarë idolli.

Edhe krejt qaj’ përjetimi, masnena unë e kisha qat’ farë lirinë me përjetu “Prishtinën”, “Klubin e Prishtinës” ma ndryshe, ma afër a din. Kur pat’ ardhë qeky Blaževići i Kroacisë, u konë madhështore diçka. Ai Ćira vijke në darka te na, se plaki jem pat’ gjetë mënyra me pru ato. Ai e ka pru në klub. Edhe une dilsha pak t’u fry se krejt mahalla, ose vijke Fadil Vokri me nejt, krejt mahalla vijshin u mledhshin para hymjes me prit kur del Fadili prej hymjes, prej banesës Fisit, ka shku te Fisi me nejt. Edhe une dilsha aty t’u fry me Fadilin, kisha kqyre na çfarë dosta jena. Une pishpirik i bijsha deri te, deri nër sjetull {bën me dorë kah trupi}.

Edhe u konë përjetim i mirë, domethonë qato grupe të interesit na bojshin bashkë, tifozëria për “Prishtinën”, masnena t’u rritë ma shumë dashnija për basketin. Jena konë grup i njerëzve t’cilët kena lujt basketboll prej mahallave të ndryshme, që ia nisëm masnej m’u shoqnu në shkollë të mesme, ia nisëm m’u përzi shoqnitë. Ke pasë Mark Rodiqin, Arben Aganin, Arben Krasniqin, Arbeni, dy Arbenat kanë qenë në “Xhevdet Dodë”, Marku ka qenë në “Ivo Llollë” të cilët kanë lujt basket si ma profesionalisht edhe dilshim lujshim *street ball* [basket i rrugë] krejt kohën. Edhe ia nisëm me u zgjonu tash qekjo shoqniija jonë, me prek tash Marku ish në Dragodan, Arbeni ish në Dragodan, ky tjetri në pjesë të tjera të qytetit, po ia nisi aktiviteti me na bo bashkë edhe na bijke shumë ma shumë m’u në me tjetrin ma gjonë nëpër qytet.

Masnej e zbulum *heavy metallin*, ia nisëm me i rritë floktë...

Kaltrina Krasniqi: Ti i bjen që ke qenë në gjimnaz në fund të viteve të ‘80-ta edhe atmosfera politike në fillim të viteve të ‘80-ta ka ndryshu dramatisht....

Fisnik Ismaili: Po, shumë u pat’ tendosë...

Kaltrina Krasniqi: Qysh e ke përjetu ti n’atë moshë?

Fisnik Ismaili: Na jemi... në ‘91-shën, ‘91-shën o konë gjenerata e fundit që e kena kry në objekt të “Ivo Llollës” qatëhere, “Sami Frashërit”. Mas ‘91-shën i kanë përzonë. Domethonë na jena konë gjenerata e funksit që i kena kry katër vjet të gjimnazit qaty. U bo nifarë ndasie etnike aty, ku thjeshtë neve na dhanë një ndrrim, shqiptarve, edhe serbëve një ndrrim. Ata e kishim paradite katër-pesë klasë, na masdite. S’po m’kujtohet në cilin vit ka ndodh, ndoshta në vit të dytë, të tretë e katërt nashta. Veç e di që një kohë mo nuk shkojshim as bashkë, se ka pasë raste kur jena rreh, ka pasë raste kur...

Une e di edhe e kom pasë një kojshi serb me të cilt kena fol, sikur vec ia nisëm, gradualisht m’u shkëput edhe me injoru njoni-tjetrin edhe mos me fol, edhe u kriju njifarë tendosje, a din, nuk ish lehtë me pa

ato nëpër hymje t'u ecë edhe mos me përshëndet. Me kojshi ma lehtë u konë, po me ata të shkollës, posaqërisht kur ia nisë me hi në pubertet, ia nisë vetja me t'u dokë ma i fortë, ia nisë m'u puqrravë kapak e m'u bo nifarë zhville edhe veç kqyrë masnej me pasë konflikte. E di, ka pasë raste nja dy-tri herë që jena kap me serbë. E di që njiherë kanë pasë me m'qitë prej shkolle, se profesoresha e serbishtës në klasë, na jena konë në ato klasët si amfiteatër që jonë konë, jonë konë nja dy ose tri në krejt "Sami Frashërin", dy jonë m'doket, jonë shkallë.

Edhe na n'pushim u gjujshim me shkumsa, dikush prej naltit, dikush prej poshtit ba-pa-ba-pa {onomatope} u gjujshim me shkumsa. T'u u gjujt hini profesoresha e serbishtës, na u kthym nëpër banka krejt krejt vëërrr {onomatope}. Edhe taman u ula une në bankë teme, veç kur një shkums i kcej prej dikahit asaj edhe tuk {onomatope} e rroki ato pak në dorë qetu. Kurgjo najsen. Edhe veç na ka kqyrë nihere edhe o' dalë. Erdh drejtori, ajo shkoi prej atje {tregon me duar}, a une isha në këtë rreshtin afër derës, prej atij rreshtit anej e rroki. Edhe erdh drejtori, "Kush e ka bo?" Ia nisën me na marrë n'pytje, fort problem u pat' bo.

Eh tash, ai kryetari i klasës që osht' shok i jemi, hala edhe në Londër, kryetari i klasës u çu edhe prej tute me shfajësu ata dy rreshtat tjerë, tha "Dikush prej qatij rreshtit e ka gjujtë". E na metë neve tash katër banka, tetë veta. Dy bankat e para s'kanë mujtë, edhe çka me bo? U tendosë situata shumë, u çu një shok i klasës Dardha, tha "Une e kom gjujtë". Pa e gjujtë hiç, e disha që ai jo. T'u çova edhe une, thashë "Edhe une e kom gjujtë". T'u prit që po çohet krejt klasa, "Edhe une, edhe une..." S'u çu kërkush tjetër! (qeshë). E t'murrën masa diciplinore ndaj neve dyve, po s'na përzunën, pshtum!

Po qeshtu i kemi pasë disa situata, që bash për një fjalë goje mujshe, mujshin me t'qitë prej shkollës ose t'bojshin zullum. Ka pasë tepër, tepër presion. Përfundojshe t'u mos flejtë me gajle, t'u menu çka bona, ku gabova, çka thashë, pse e thashë?

Kaltrina Krasniqi: Prindërit e tu çka kanë... se ata kanë punu po supozoj?

Fisnik Ismaili: Po, kanë punu deri '89-tën, në '89-tën te dytë i kanë përjashtu...

Kaltrina Krasniqi: Se për ata ka qenë ndryshim ma radikal?

Fisnik Ismaili: Unë mas... masi që vdiq babi, para dy, dy vjet e gjysë, unë plot sene i msova për to çka ka bo ai për shembull në fabrikë të amortizatorëve, qysh ... për shembull m'i tregojshin do tregime që nuk i kisha ditë une. Qysh shqiptartë kanë qenë ma t'diskriminum e ky i ka bo do lëvizje qaq t'guximshme që jonë habit tonë nuk e ka hongër. Nji rast për shembull, për festa të serbëve punëtortë mujshin me marr të lirë, mujshin me... kishin do lehtësime, derisa kur kishte festa të shqiptarve kërkush, kërkush nuk ia futke shqiptarve hiç. Edhe i bjen një puntori m'u anku, edhe plaki thotë "OK..." S'di çka u konë ni festë, u konë ni festë që kta s'hajnë mish, po hajnë veç peshk, a qeshtu diçka... për serb ortodoks...

Kaltrina Krasniqi: Ndoshta për festa t'mdhaja e reduktojnë mishin, cilado qoftë ajo...

Fisnik Ismaili: Po osht' edhe diçka që nuk hajnë mish, veç peshk hajnë... nuk e di sakt! Edhe tashti ky i ka thonë, "OK". Edhe kur e marojshin kantinën... A hini dikush a m'u duk? [i drejtohet të pranishmëve].

Kaltrina Krasniqi: Jo veç une bona me shejë, m'fal.

Fisnik Ismaili: Kur e marrojshin knatinën, ushqimin ia bojshin, ushqimin ua kishin bo ma t'Veçantë serbëve edhe u pat' anku dikush prej shqiptarëve, OK ky ia pat' bo me kantinë ramazanin, iftarin me ia bo. Domethonë u konë, qysh m'hojke njoni, nuk ka pasë fabrikë tjetër që kantina ia ka respektu religjionet edhe iu ka përshtatë atyne edhe për ta ish konë shumë domethanëse. Ka bo do qesi lëvizje që m'kallxojshin, të cilat koxha e kanë rreziku. Bile, babin mas '89-tës... ti p'e din qetash sa ma sulmojnë mu plakun edhe mu...

Kaltrina Krasniqi: Për qëllim me dokumentu a mundesh me ia thonë emrin?

Fisnik Ismaili: Muharrem Ismaili. Ka qenë drejtor i Fabrikës së Amortizatorëve, guvernator i Bankës së Kosovës, drejtor i Bankosit, jemi t'u fol për vitet e '80-ta. Paraprakisht, para Moskës ka qenë drejtor i therrores, i furrës së bukës "Fushë Kosova". Domethonë, ka pasë nifare përvoje të udhëheqjes të organizatave ma të mdhaja edhe plus të '80-tat ka qenë kryetar në kohën ma të mirë të "Klubit të Prishtinës". O sulmu shumë mas '90-tave, mas '89-tës, posaqërisht prej serbëve të cilët... kur masat e dhushme i murën krejt kursimet prej bankës, Serbia e pat' bo një propagandë shumë t'madhe kundër babit. Edhe për ato paret e RTK-së, s'di a t'kujtohet një shumë, pare të RTK-së që u patën zhdukë diçka, që i ka marrë dikush i RTK-së, nuk jom i sigurtë kush njoni prej drejtorave, po ma s'shumti për kursimet e shqiptarve të cilat banka, kur i patën marrë masat e dhushme ato jonë ngri fondet edhe nuk ju kanë kthy kurrë shqiptarve.

Tashti jonë munu me fajsu babin për këtë punë. Ke pasë lajme, njeri rrike kqyrke televizor, thojke "Muharrem Ismaili ka ikë prej shtetit me qikaq milionë pare". Ai midis Prishtine t'u mos ditë... e ka pasë shumë t'rondë kto. Kshtu që, kjo periudhë qetash që m'kanë sulmu mu si kollaborator i serbëve, për plakun tem, une u nxejsa ma shumë se për to u konë hajgare. Thojke, "Çka m'kanë bo mu serbtë n'fund të '80-tave, '90-tave, kjo osht' hajgare a din, çka flet Berat Buzhala, a naj qesi portal kikiriki i sodit ose çka thotë për ty Hashim Thaçi në kuvend". E ka shfrytëzu foltoren e kuvendit për me sulmu plakun tem. Po une e di që kjo ka qenë teknikë që përdoret, po nejse.

Sot përdoret qekjo teknikë pikërisht për me shtyp edhe për mos me lonë qat' klasën intelektuale të para luftës për mos me çu kry. Sepse qeta komandantat e mas luftës që e kanë keqpërdorë UÇK-në edhe vlerat e luftës, qeta jonë pikërisht qata njerëz që për me ardhë n'pushtet, pa qenë hiç intelektualë. Njihërë janë dashtë me shtyp edhe me shukatë atë farë klase intelektuale, t'u i etiketu, t'u iu kërcënu, edhe kta si njerëz që s'kanë dashtë probleme, as fmitë e tyne t'u e ulë krytë. Po, unë kom qellu prej atyne të trentve që iu kom kundërvy, plus fakti që edhe une jom konë në UÇK s'kanë mujtë fort me m'etiketu, sado që munohen.

Kaltrina Krasniqi: Babin në të '89-tën e kanë pushu prej punës?

Fisnik Ismaili: Po, edhe mamin. Mami në fakt pat' dalë në pension invalidor pak ma herët ndoshta, po babi në '89-tën s'ka punu. Në qat' kohë unë i pata bo nja 16-17 vjet, sa i kom pasë '89? Nja 16. Rashë në dashni {ha çokollatë} me Laurën. M'fal se... e cila sot osht' nona e dy fëmijëve të mi, ish-gruja jem. Edhe une u rebelava, ajo në "Xhevdet Dodë" une në "Ivo Llollë" u çel Kurrizi, lulzoi Prishtina.

Kurrizi u konë nifare zone, nashta pak palidhje po, jom t'u i ndreq dhomtë e... Kurrizi u konë nifare zone ku e ke pasë nifare lirie p'i zullumit që mujshin me ta bo serbët, qoftë civilë, qoftë policia. Se polictë me hi sporadikisht në Kurriz u tutshin kur [ata] ishin pak, se aty kish shumë njerz, u mbledhshin shumë njerz. Në tunell me hi ata, mujshe kushedi çka me ju bo. Por, kish momente kur u

bojshin shumë edhe na hishin raci, na nxerrshin, na bojshin zullum, por jo qaq shpesh. Po, në të shumtën e kohës Kurrizin e shihshim si ni vend ku mujshim me folë ma shlrë, mujshim me u shprehë ma shlrë...

Kaltrina Krasniqi: Çka bojshit?

Fisnik Ismaili: Kurrizi ka pasë shumë kafiqa. Ma s'pari ti e ke pasë "Bosnën", po ia nisim prej naltit, "Bosnën" ku e hajshe ni burek t'mirë, e ke pasë ni piceri, qe ia kom harru emrin... "Amadeus" nashta, ia kom harru emrin, ja a, s'e ka "Amadeus". U konë edhe ajo e famshme. Masnej, si hijshe mrena, se kjo osht' ma si jashtë, si hijshe në tunell, kafiqi i parë në të majtë u konë "Marigona". Në "Marigonë" u ngojke metall. Qaty rrishim krejt shoqnija, u konë kafiq i vocërr, krejt na flokqat rrijsim qaty t'u qitë me kry {bon me kry}, t'u ngu rok [rock]. Ma poshtë ka pasë kafiqa ma t'rëndomtë që herë hijshe, herë s'hijshe, se m'kujtohet në mes u konë ambëltorja "Bazari", ka pasë krem-pitën ma t'mirë ever [najhere]. Meniherë në dalje u konë restoran "Dubrovniku", aty shkojshin ma të moshumë, hala o "Dubrovniku" aty, nëse s'gaboj babi shkojke me bo qef. Me shku aty s'u dashke me hi në Kurriz, pi jashtit kish qasje.

Ma poshtë u konë "MHz" njo, nuk e di. E ki pasë pak para daljes, tash anena prej tunellit, picerinë "Beni" i bojke sendviqat edhe picat tepër t'mira. Edhe menjihere në dalje në të djathtë u konë "Blues Alley" që rrijke ma s'gjati, e kish atë farë si oborr përpara ku u mledhshin ma s'shumti njerztë. "Blues Alley" u konë kafiqi ma i frekuentum, ku s'ke mujtë me gjetë ven m'u ulë kurrë pothujse. Gjithë rrishim jashtë qaty, edhe kur u bojke ai fajronti, kur ia nisshin njerzit me dalë uvuvuv {onomatope} u mledhshin, rrijsin edhe pak para "Bluesit". "Blues" u konë kafiqi i fundit që u mshelke para se me ecë te shpija.

Kaltrina Krasniqi: Në ora sa?

Fisnik Ismaili: Paj 12:00, 1:00, po. E ka pasë ni kangë që gjithë e ka lshu, "Tin Pan Alley" të Stevie Ray Vaughan, o konë kongra e fajrontit. Gjithë qat' kangë e ka lshu, na e dishim që duhet me ecë n'shpi.

Kaltrina Krasniqi: A ka pasë veç djem, apo ka pasë edhe çika?

Fisnik Ismaili: Jo, ka pasë, s'ka pasë natë që nuk kom dalë me Laurën, pothujse për natë dilshim. Për natë shkojshim kafiqave me shoqni, hijshim qaty qitshim me kry, u sillshim te "Bluesi", ndërkohë ikshim pak e merrshim ni sendviq te "Beni", shkojshim, kanihere hypshim nalt, u puthshim nalt ose hijshim n'tunell, u puthshim n'tunell nëpër qyshe. Po, pa u puthë nja gjysë ore nuk e kemi lonë, për natë. Qajo u konë rutina e jonë. Masnej, prapë zbritshim poshtë, u takojshim me shoqinë ose në "Marigonë" ose në "Blues Alley" ose dikah, vazhdojke hajgare aty edhe u shkepshim te shpija. Cdo herë, çdo natë.

Kaltrina Krasniqi: Edhe kur ndodhshin këto racitë e rrezikshme, çka ndodhke?

Fisnik Ismaili: Kurgjo veç ikshim.

Kaltrina Krasniqi: Çka ka qenë rutina?

Fisnik Ismaili: Ja, veç ikshim. S'o që m'kujtohen mu, se diqysh nuk qellojsha, dy herë a kom qellu a jo. Hala pa mrrri me i pa polictë na u shpërndajshim. Nuk o që ksi.... Zullum ma shumë na patën bo tipat

që dojshin me na i pre floktë, shqiptartë. Për ta ishim halë në sy. Si na shihshin neve flokqav dojshin lesh me na bo. Ni shokut...

Kaltrina Krasniqi: Ku ndodhke kjo?

Fisnik Ismaili: Po kqyre, me shku në Vranjevc apo në Mahallë të Muhaxherve, hiç s’e roke, hiç. Aty ma mirë hiç mos kalo se t’bijshin, t’bojshin zullum. Po, ata vijshin kanihere edhe në Kurriz e qaty. Po na rrijshim bashkallak 10-15 veta, që me rujtë njoni-tjetrin, po me bo me t’nxonë vet apo dy veta, m’u konë ata nja gjashtë a shtatë... U pat’ konë ni rast i njonit, me thikë ia patën pre floktë (qesh). Qeshtu, zullum t’bojshin. A din, edhe në mes të qytetarve të Prishtinës ke pasë asi diferencime klasore që i ki edhe sot, do qesi diferencime lokaliste, ku ke pasë katunarë e qytetarë. Edhe mahallat kanë qenë qashtu të identifikume. Dardania, Ulpiana ia kanë rreh vetit ma qytetarë, e kur dojshe ti dikon... edhe qendra normal Pejtoni edhe kto... Edhe kur dojshim me kallxu për dikon, si me fy, thojshim, “Ai i Vranjevcit ose i Mahallës Muhaxherve”, ata jonë konë pak ma t’qart, a din, edhe qashtu i ndajshim edhe faktikisht qashtu u bojke edhe lëvizja në mes të mahallave. Masnena pat’ ndryshu ni kohë se ka pasë plot njerëz që o dashtë me i kry ato shkollat nëpër shpija që u shkollojshin. Unë në qat’ periudhë s’jom konë, në ‘91-shin unë kom dalë pi Prishtinës”.

Kaltrina Krasniqi: Prej ‘81-tës deri sa e keni kry shkollën e mesme, mandej çka ndodhi?

Fisnik Ismaili: në ‘91-shën në shkurt, unë jom shku. Çka ndodhke n’atë kohë para se me [ndodh] procesi i rekrutimit, para se me shku ne ushtri të Jugosllavisë ti je dashtë me shku në Nish, ku ta bojshin ni *check-up* [kontrollë]. Të kqyrshin në çfarë gjendje je edhe masnej t’vijke thirrja për ushtri. Mu po m’kujtohet, nuk po m’kujtohet muji kur, po n’qat vit... edhe i merrshin si me turra banorët e mahallave, a të shkollave, s’e di qysh i dajshin me shkolla, a me mahalla, me qytete faktikisht. Po une s’pata, s’pata, s’pata qellu ktu, pata qellu në Lublanë te daja kur pat’ shku ajo turra, kur m’pat ardh mu ajo thirrja. E shkova me do të Obiliqit, ka qenë përvojë shumë e çuditshme se me njerzë që s’i njihsha aty, as s’dishe ku je, as çka po ndodh as... kshtu, sa u konë interesant, u konë edhe e çuditshme si përvojë edhe kurgjo...

Masnej, u kthym, normal e kryva shkollën, deri n’vit të fundit meta, deri n’vit të tretë të shkollës mesme me krejt notat ma t’mira, në vit të fundit meta n’provim, se u bona rrebel, i rrita floktë, rashë n’dashni, ia nisa me kalu, bona femën, me ni fletore n’xhep e kalova tanë vitin. Faktikisht, edhe qajo situata politike e hupi edhe ransinë e msimit mo, a din, nuk kish që u lodhke dikush me i jep shumë zor me msu n’qat kohë. Ishin halle tjera tash. Edhe qathere e mora guximin me i thonë dajës, “Po du m’u regjistru n’dizajn grafik”. Në dizajn grafik i ke pasë tri vene t’lira... tre studenta.

Kaltrina Krasniqi: Në vjet apo dy here në vjet?

Fisnik Ismaili: S’di a çdo dy... po e di që tri vene t’lira jonë konë, m’doket në vjet. Edhe e mora guximin me i thonë dajës, “Kqyre, po du m’u regjistru”. Edhe t’u prit që po ma bon bajat, qysh ma ka bo bajat plaki tanë jetën, babi. Daja u entuziazmu qaq shumë... e në ndërkohë ai ia pat’ nisë me punu, ai piktor, tanë kohën ka shku verës në Kroaci dikah, ka bo portrete edhe me qato pare jetojke tanë vitin. U konë ashtu, ma *free spirit* [shpirt i lirë] s’ke pasë. Po ia nisi me punu në “Rilindje”, me i bo kto ilustrimet e librave të leximit. Edhe muj me thonë që bash qajo periudha kur u patën votu qato libra, ilustrime ma t’mira nuk kanë pasë librat e leximit se sa n’qatë kohë. Po nuk zgjati shumë e qitën edhe ato prej pune.

Daja u entuziazmu shumë, edhe çdo ditë mas pune në “Rilindje” ka ardh te une me ushtru, me bo portrete, me bo... me m’pregaditë për provim pranues. Edhe jom habitë me dëshirën e tina që une me u avancu. Edhe i graha edhe une qeshtu, punojsha, bojshim portrete të shokve t’mi, i merrshim i ulshim qaty {bën sikur i pikturon}, ule Laurën, ule Valonin, ule Viganin, shoktë e ndryshëm, motrat e mia, kush na bike n’dorë e ulshim me vizatu. Edhe dikur u pranova, ka qenë ditë ekstrem e lumtun në gusht qathere, nëse s’gaboj, kur e pashë emrin n’gazetë që u pranova. Njo prej treve, n’fakt katër vetë i patën pranë qat’ vjet. E di që në provim pranues kemi qenë nja 40-të. Edhe unë ashtu t’u shpresu që, “Dajë, mos e ki najkon t’njofshëm”. Daja t’u ma bo, “Nuk ki shansa me t’njofshëm se...”

Daja sikur une sot, as ato nuk ishin që e dojshin shumë piktorët konkurenta, sikur mu qysh nuk m’dojnë në UP sot profesorat e dizajnit se kena konflikte, s’pajtohemi në metoda se qysh ata i msojnë studentat e mi pregadisnin mu me punu qetu. Nejse, faktikisht nëse diçka ai kish bo, e kish vështirësu regjistrimin tem, qaty ish konë fakti që jom nipi i tina. Po, nime, punova mirë tash t’thom, i shihshe çka po bojnë tjetër edhe kush kalojke ka une me m’pa... Se provimin pranues e kena majtë te Përmendorja e Dëshmorëve, nalt te vorri i Ibrahim Rugovës sot ku osht’, qaty se s’kena pasë objekt ku me majtë provimin pranues. Në natyrë e kena majtë. E tash kush kalojke aty ma shihke mu ni kopertinë të librit që jom konë tu e bo edhe tontë ma bojshin, “Aa ki m’u pranë, ki m’u pranë...” a din, edhe nime u pranova edhe u gzova shumë.

Edhe shtato u konë nëse nuk gaboj, në ‘91-shën dul lajmi që krejt kush ka lindë, kush ka lindë ‘73-tën m’u lajmu në kazermë në Prishtinë, qathere hala s’pat’ nisë lufta në Bosnje, po u dike që diçka ka me kërsetë. Si me thonë në mramje, te une ka qenë Arben Agani me nejtë, me bujtë, shumë dosta jena, ai jeton në Washington sot, shumë bre dosta jena konë. Edhe t’u nejt na, opp {onomatope} lajmi, bëm bëm bëm {onomatope}. Në atë kohë motra jeme u pat’ martu, dyjat u patën martu e vogla me qet’ Luanin, futbollistin, patën shku me jetu Itali. Luani e gjetë ni ekip atje e lujke futboll. Të nesërmen në mëngjes, o dalë Arbeni, jena çu, kanë hyp në kerr, o dalë Arbeni, jena përqafë, kena kajtë. S’kena ditë kur kena m’u pa mo, m’kanë hyp në kerr, m’kanë çu në Shkup, pi Shkupit kom fluturu në Itali te motra, mrena dite kom dalë. Mrena dite m’kanë nxerr. Edhe s’disha sa kom me nejtë, as qysh kom me nejtë, as ku kom përfundu...

Motra jeme, tash Luani, burri i motrës me babën e tina i cili edhe ai punojke në Itali e punojke jashtë. Ata ishin ardhë në Prishtinë. Vali, Valbona motra e mesme, jetojke me ni banesë relativisht të vogël në të cilën nuk kishte ven për ma shumë njerëz, po ni muj kish me nejt vet veç me djalin e madh. Edhe une shkova nejta ni muj te ajo, t’u prit me kqyrë çka po ndodh. Mas ni muji s’po qetësohet kurgjo, veç u përkesojke gjendja në Jugosllavi. Ia nis, m’doket në Slloveni në ndërkohë edhe Luani tash me babën e vet u kthejke në Itali n’shpi t’vet. Edhe une u dashke me dalë se s’kish ven për mu mo. Në ndërkohë që Laura, atëhere 16 vjeç, 17, une 18. 17 vjeç, u pat’ dashunu koxha shumë edhe ju thotë prindërve t’vetë, “Une po shkoj te Fisi”. Edhe e bon punën, insiston qaq shumë që vjen ajo 17 vjece, udhton me Luanin edhe babën e saj [tij], vijnë në Itali m’u taku me mu. Ka ia majmë prej atyhit s’e dishim.

Edhe faktikisht, ata zhdrypën në Millano, na shku, une shkova në Millano me i taku ata se nuk mujsha me nejtë te motra, ata shkojshin te motra. Edhe u takum me Laurën në Millano në stacion të trenit, u pashë me ata dytë, u përshendetëm, shkunë ata n’shpi t’vetë. Metëm une e Laura, 18 vjeç, 17 ajo, midis Millanos t’u menu. Une i kisha dikun nja gjashtë mijë marka, ah jo, katër mijë marka i kom pasë që m’i pat’ jep babi deri t’i bijna n’fije çka me bo. T’u u kqyrë na ka po shkojna. Mu m’kishin ikë do shokë në Norvegji, une dojsha në Norvegji me shku, Laura insistojke na me shku në Angli, “Jo se dijmë pak anglisht, e ma leht e kena”. I kisha do shokë të klasës atje, do asi shokë të klasës që s’më dojshin ata mu, s’i dojsha as une ata, se kalojsha me shoqën e tyne të klasës edhe une t’u kujtu që

Londra si Prishtina, i sheh përditë, a din, e t'u thonë, t'u pritu me shku, prt e mrt {onomatope}, ku po shkojmë e çka po bojme? Qaty për qaty u dashke me vendos ku kena me shku *next* [në vendin tjetër] s'dishim çka kemi me bo në Milano.

Laura e ka, e ka hala nji dajë në Bresha edhe e dike që ai daja vet ka me shku m'i marrë dy djemtë e vllaut tina, domethonë djemë tjerë të dajës të Laurës, në Gjermani dikah, ka me shku me kerr me i marrë në Gjermani me i çu në Angli. Se atëhere ke mujtë me shku në Angli pa viza, po pak i dyshimtë m'u konë ta jepshin vulën e zezë edhe t'përzejshin. Domethonë, ti u dashke me qenë shumë i kujdesshëm m'u konë për me mujtë me hi. Edhe thamë, "Hajt p'e thirim Skendën vec p'e kqyrim ka o mos o nisë". E dishim që ka pasë m'u nisë qato ditë. Ai Skenda për fat të mirë, fatkeqësi, fat i mirë në fatkeqësi, ai e kish bo ni ndeshje me kerr edhe e kish çu kerrin m'u ndreq, s'kish mujtë m'u nisë me kohë në Angli, se ka pasë dy ditë ma heret m'u nisë.

Praktiksiht, ai t'u prit me iu ndreq kerri. Tha, "Hajdeni në Breshë qetu nja dy ditë e po vendosim çka me bo, vini me mu në Londër". Thojsha, "Jo, s'ka shansa s'muj une me i ngushtu njerzit në kerr aty", a din mu m'vike keq. Edhe shkum na në Breshë. Ai insistoi, "Hajdeni, hajdeni, hajdeni gjithqysh me mu po iu çoj në Angli". Edhe hypëm në kerr, vazhdum për Gjermani, i morëm dy djemtë e dajës tjetër të Laurës edhe njona, e fejumja e njonit prej tyne. Gjashtë veta në kerr. E vazhdum qanena në Gjermani, dulëm në Luksemburg, Belgjikë, hypëm masnena në trajekt. Aty u dashtë m'u da, se me pa kerrin me gjashtë veta në Angli, na kthejshin tonve. Edhe u damë. Kshtu që, në dalje në Angli, ata ishin katër veta në kerr, na dy po dalim në komë. Edhe s'ke pasë as mobill as kurgjo edhe u shkëput kontakti, s'e dishim a kanë hi, ata s'e dishim a kena hi na se rrugë të ndryshme.

Hinëm na qeshtu, pshtum! S'na murrën shumë në pyetje, "Ku po shkoni?" "Kena ardhë turista, me shetitë, me pa Evropën". U dokshim si *backpackers*, si tinejxhera që e merr mas gjimnazit ni vjet pushim edhe don me pa venin. Na lanë me hi, vizën gjashtë mujë, ksi farë lejen e qendrimit gjashtë mujë të turistave. Edhe hinëm, mrrijtëm në *Victoria Station*, stacion i madh për ni... nejtse une kisha shku nja dy herë kisha dalë në Itali, kom shku te motra në ndërkohë, në Lublanë kisha shku nja dy-tri herë vet, pata udhtu me akropolis prej Fushë-Kosovës deri në Lublanë edhe masnej kom ndrru trena, e disha pak m'u gjindë. Veç apet kur përfundon në Londër 18 vjeç, për dore me ni 17 vjeçare. Edhe kqyrë nalt e sheh ni stacion qaq t'madh e s'din ka me ia majtë, osht'... e ki veç ni numër të telefonit, të motrës Luanit, të burrit motrës, t'cilin kur e sillëm s'boni. S'bojke numri. S'ke pasë mobilla, prej *pay phone* [telefonave publik me pagesë]. Edhe kurgjo, përfundum... vijshin aty, t'shijshin si turistë do qesi që kanë hostella, vijshin ta bojsin, "A po don me flejtë qetu..."

Shkum me ni ven, flejtëm nja dy netë, s'dijshim ku me i gjetë shqiptartë. E kishim veç ni emër "Trokadero" që jonë Pikadilly. Hajde ecim deri në Pikadilly. Kshtu si një dashmirës i hartave, e çela ni hartë edhe e gjeta rrugën me shku në Pikadilly. Në Pikadilly jemi sillë nja katër orë t'u e lypë kafiqin "Trokadero". E vetshim dikon për "Trokadero" s'merrke vesh çka po lypim. Deri pahiri e çoj krytë nalt edhe e shoh që ajo ndërtesa nalt e kish emrin "Trokadero". S'disha as me prononcu, "Trokadero" u shkrujke por "Trou-kha-deero" [shqiptohej]. Ajo ish *shopping mall* [qendër tregtare], nuk ish kafiq, na kqyr kafiqat {bën me duar}. *Shopping mall* ish sa të dihet. Edhe hinëm mrena na në *shopping mall*, edhe qysh osht' ajo hymja si ni restoran i madh italian me plot tavolina, ku tetë kamariera shipeca edhe krejt myshteritë shipeca midis Londre. Çfarë gzimi! Po shkon me ni ven ku s'je t'u ditë as ku je t'u shku, po t'thom vendimi o marr në Milano në stacion. As s'e dishe sa ki me nejtë. Edhe masnej qaty u lidhëm me shiptarë e gjetëm ni ven, ia nisëm me punu.

Edhe qysh t'thashë me Arben Aganin kur jom përshëndet qat' natë që m'kanë gjujtë prej Prishtine meniherë m'kanë çu në Shkup, tetë vjet ma vonë jom kthy në Prishtinë.

Kaltrina Krasniqi: Qysh ka qenë Londra?

Fisnik Ismaili: Falë Londrës unë jom qeky njeri që jom. Edhe i falenderona shumë, shumë faktit që prindtë e mi kanë vendosë me m'nxerr qashtu përnihere edhe Laurës që ka insistu me shku në Londër e krejt. Se kur e menoj, që fola ma herët mënyra qysh i kena kqyrë njerz të tjerë, qysh jena sillë me njerz të tjerë. Tu ia nisë prej dallimeve klasore, dallimeve racore, dallimeve gjinore, orientimit seksual diqysh jom shku si ni njeri me shumë paragjykime. A din asi që kur e ki pa naj zezak, nejse une Abdunë e kom pasë shok si i vocërr në Moskë, hindustë, kinezët pak i ke kqyrë... ose t'u pasë paragjykime ndaj... a din, homoseksualëve deri n'qatë masë sa që e kalojshe rrugën kur kalojshe kah naj *gay bar*, u dashke... a din... sene t'cilat kur i menoj sot des t'u keshë.

E jonë sene që kanë ndiku shumë në karakter temin edhe me t'vërtetë kur jeton me ni ven të madh si Londra edhe i sheh krejt qat' *variety* [llojllojshmëri], qysh me thonë shqip, qat' diversitet të njerzve, kulturave, ti veç e kupton sa pak jena në qendër të universit na qysh kena qef me menu. Edhe sa me vlerë janë kulturat tjera, gjuhët tjera, kombet tjera, të cilat na i përbuzim. E faktikisht kur e kqyr, secila prej tyne i ka do vecori t'veta, qofshin edhe majmuna në përgjithësi në raport me neve, apet e kanë naj ushqim, e kanë naj traditë, naj zakon që vlen me ia respektu, a po kupton?

Edhe ti qaty ia nisë me msu senin ma t'randsishëm që une e shoh që mos me paragjyku mo njerz. Përpos asaj mson masnej, me pa diqysh se çka ka krejt n'qetë botë. Edhe qatherë e kom kuptu thellësinë e *Star Trackut* që e kqyrsha une. *Star Track* osht' ni anije që eksploron bota të ndryshme të cilat përballen me kultura të ndryshme. Masnej, qaty e kom kuptu që ty s'të vyn ni anije kozmike me shku nëpër planete të ndryshme, qasi dallime ka, edhe qasi kultura të ndryshme ki n'qetë botë të cilat ni pjesë të madhe majshe me i taku në Angli, pa t'u dashtë ty me shetitë botën. Edhe qekjo osht' qajo pjesa ma e kandshme, ma falenderuse që e kom trashëgu diqysh prej Londrës. Osht' qytet madhështor, osht' qytet që t'i menaxhon 13 milion njerz që sillen përditë qanena. Edhe ti e kqyr e thu qysh mundet qeshtu me funksionu qaq mirë.

Osht' qytet që t'jep rast nëse don me punu, ka me t'jep rast, po edhe ka me ta ngul najhere. O ni qytet ku tri vjet ma vonë, ku prej presonit ma t'madh s'mujshim me studiu menihere se u dashke për me bo... Interesant o qekjo, për m'u bo resident në Angli u dashke me jetu tri vjet. Na, domethonë gjashtë mujë e kishim vizën edhe shpresojshim që pa u bo gjashtë mujë ndreqen puntë ktu edhe kthehem. Kur e pamë që s'po ndreqen puntë ktu, u dashtë me lypë azil politik '92-shin menihere. Si azilanta manej i morrëm do beneficione, e gjetëm ni banesë ma t'mirë, ia nisëm pak me jetu, punojshim në të zezën kapak. Edhe ia nisëm m'u konsolidu, por qëllimi primar i joni ish m'u regjistru në fakulltet.

Tash presioni që unë kisha prej plakit tem ish i hatashëm, i hatashëm. Dy motrat u martun asnjona s'e vazhdoi fakulltetin, une veç u dashke gjithqysh... une knej s'un e gjejshe vetën çka po du me studiu tash? Për me studiu dizajn, ty t'u dashke edhe dy vjet tjera me shku me nifarë shkollë para... për me mujt në *arts* [arte] edhe në medicinë e kishin qeto ekstra shtesë të cilat s'dishe ku as qysh, hala u msojshim m'u gjindë... E për me mujtë me marr bursë edhe me përballu kto... pagesën e shkollës, u dashke tri vjet me jetu në Angli për m'u bo resident i Anglisë, e qathere u numrojshe si student i vendit e jo si i huj, se si i huj kushtojke dhetë mijë eruo, marka viti, s'kise llogari. Kshtu që, na metëm tri vjet me prit, te dytë, për me mujtë me studiu edhe punojshim kshtut.

Kom punu moler, kom punu... kom la enë, kom shitë tesha në pazar, kom shitë kpuca, qesi punë që i bojshim te tontë. Po veç kamarier s'mujsha m'u bo, se për m'u bo kamarier... m'u patën tekë shqiptartë se krejt punojshin kamariera, "Prej floktë, se me flokë t'gata nuk t'marrin kamarier se t'bijnë kimet, t'bijnë në gjellë..." Unë thojsha, "Pse m'i pre floktë? Pse duhna domosdo kamarier me punu?" "Po, jo, po kqyre tonë po punojnë kamariera". Nime, kamarier ky, kamarier ai, e ia gjojshin njoni-tjetrit punën ma leht u punësojshe si kamarier se sa çkado tjetër. Po une apet qashtu, krytë e fortë edhe rebel, "Une kom me punu, po s'do me thonë që kom me punu kamarier. Po du me i rritë floktë". Edhe gjeta pahiri punë si moler edhe u msova me ly, hala di me ly. Masnej, lajsa enë e qesi sene.

Në ndërkohë që jetë Laura shtatëzane, mas dy vjet e gjysë. Vitin që dojmë na me studiu lindë Viganin në korrik. Praktikisht, ai ka lindë në korrik, na ja kena nisë fakultetin në tetor, te dytë. Me jetu në Angli, vec me rritë fmi osht' ekstrem shtrejt. Me rritë fmi, me studiu me fmi dy-mujsh osht' ekstrem shtrejt edhe vshtirë. Edhe çka bonën nonat tona, bonën vizat, e bonën punën edhe te dy nonat erdhën me na ndihmu. Edhe nejtën ka dy-tre mujë qeshtu kanë nejtë. Po në fund erdh ni moment që e shihshim që pa njonën s'un vazhdojna edhe kena me pasë zor. Edhe cila po jetë, cila po jetë vë vë vë {onomatope} vendosi nana e Laurës me nejt. Edhe ajo metë. E jemja u kthy. Metë ajo me na ndihmu.

Masnena gradualisht erdh burri, çikat, dikun mas nja pesë vjete nja 43 anëtar të familjes së saj kanë ardhë. Qeshtu, t'u e tërhekë njoni-tjetrin kanë ardhë. U gjindshin, hijshin në punë, vijke motra, vijke vllau, i ka pasë dy dajë, ni teze e qesht, plot ka pasë fmi të dajës, tezës, *you name it*, 43 anëtar iu bonë që erdhën... ose edhe që jonë konë azil në vene tjera vishin në Angli. Te une praktikisht vec motra jeme e madhe pat' ardhë, ajo me tri çika. Edhe qashtu neve na ndihmunë prindtë e saj. Prindtë e Laurës na kanë ndihmu shumë me Viganin, me djalin e madh, se përndryshe s'kishim mujtë me i kry fakultetat te dytë.

Pjesa e Katërt

Kaltrina Krasniqi: Çka studiu? Çka keni studiu?

Fisnik Ismaili: Unë, tash unë në ndërkohë e zbulova kompjuterin edhe më pëlqejke, rashë në dashni me *computer animation* [animacion kompjuterik] që u kanë shumë fushë e re atëherë, ekstrem fushë e re. Edhe në fakt u kanë veç një universitet në Angli i cili e ofrojke qat' drejtim edhe unë veç bojsha diçka në shpi, e bleva...bona do pare me ble një kompjuter, bojsha diçka në shpi. Edhe praktikisht i çova dokumentet veç në Portsmouth se isha i bindun që kom me u regjistru gjithqysh qaty. Nuk ka Zot që ma ndërron profesionin. Se ti mujshe, në Angli munesh në gjashtë vene me apliku, edhe njona prej tyne... une hiç, veç në njo shkrujta se veç njo ish, s'dojsha diçka të ngjashme as kurgjo.

Edhe bile bile e bona punën me shku me u taku me ta paraprakisht e ata kur m'i panë punët më thanë, "Definitivisht kena me të thirrë në intervju", që ke prej 350 vetave që aplikojshin, shtatëdhjetë i thirrshin në intervju, mu definitivisht më shtinën në qat' listën e shtatëdhjetëve prej të cilëve tridhjetë u zgjedhshin për me studiu. Në ndërkohë s'di çka u bo...se ato pajisjet kushtojshin ekstrem shtrejt, e shkolla e arteve e tyne vendosë që edhe drejtimet tjera si pikturë, skulpturë e sene me ja u jepë me i përdorë kompjuterat, që i bike që u dashke me u mshelë *computer animation* krejt edhe s'ekzistojke

mo qaj drejtim, përnjherë. A une pritsha me u pranu qaty, me ja nisë në tetor edhe e kom pasë një moment koxha të ranë, e morra shumë për zemre se një moment kur ja nisa me pa të ardhmen teme e ja nisa me pa veten t'u bo efekte speciale në Hollywood e me punu vetë në *star project movies* [filma për yje], m'u shujt.

Edhe masnej s'dojsha hiç me shku në fakultet, dojsha vetë, autodidakt me mësu me u bo *computer animator* vetë, a din. Po, provo bone qato me një njeri si Muharremi i cili çdo ditë thirrke në telefon t'u bo presion, "Aman regjistro çkado, veç regjistro diçka". Po për fatin tem të mirë, del një kurs, pak pa ja nisë, tash unë u dashke aty çka kanë metë do qisi vene të lira e ish një revistë ku tash krejt jonë regjistru po çka kish metë vene të lira që merrshin. Aty jonë konë do kurse ma palidhje do kësi, e shoh një *multimedia* edhe po i shoh 25 vene të lira, krejt i kishin dy vene, tri vene, "Pse 25 kërkush s'paska shku, pse s'e kom pa unë këto vitin e kalum kur kom apliku?"

Edhe marr vesh që u kanë një drejtim i posa akreditum i cili s'ka mujtë ma herët me u akreditu, diqysh si me ma servu qaty. Edhe dul që ish i ngjashëm me çka kom bo ma herët edhe hina qaty edhe m'ndryshoi krejt jeta. Hina në multimedia që ish njëfarë kombinimi mes dizajnit grafik edhe kompjuterave, që gjithë kom pasë qejf me bo.

Në ndërkohë që na punojshim shumë, po meno një posaqërisht gjatë universitetit, a kom punu *security* [sigurim] nëpër bare qishtu natën, vikendeve shitsha tesha, ditëve të lira, domethanë gjatë pushimeve shitsha këpuca me do dosta. Dikur masnej ja nisëm, pak pa i kry fakultetat ja nisëm me përkthi. Puna e përkthimit u pagujke shumë mirë. Si përkthyes na bike me udhëtu relativisht shumë po edhe u fitojke. Dytë ja nisim përkthejshim, punë e paqtë, s'lodhesh me kërkon, ki punë veç me shqiptarë.

Qatëherë ja nisi një fluks ma i madh i njerëzve, jemi t'u folë na në të '95-tën kena nisë me studiu, në të '98-tën, '98-tën i krytëm dytë. Faktikisht unë jom kanë ka e hupi vitin e fundit se qatëherë kur ndodhi në mars, Adem Jasharin që e vranë, unë nuk pata shku në shkollë, nuk pata shku deri verës hiç në ligjërrata. U munojsha me ardhë këtu me luftu.

Kaltrina Krasniqi: Qysh u mendojshe me ardhë?

Fisnik Ismaili: U mendojshe.

Kaltrina Krasniqi: Aha, u mendojshe.

Fisnik Ismaili: Po, se unë gjatë luftës në Bosnjë unë shumë jom kanë i mllëfosun që më qitën shkijet prej ktuhit, tepër jom kanë i mllëfost. Edhe kur i shihsha çka po ndodhë në Bosnje a din ashtu thojsha, "Me shku, me shku!" Ma bojke Laura, "Rri trus, a din, kur t'krisë në Kosovë shkon". A din, t'u shpresu që hajt se nashta s'krisë kurrë. "Po, po," a din, "P'e presim dej t'krisë në Kosovë". Kur ndodhi qajo në të '98-tën masnej edhe daja që u kanë në Lublanë, ai u konë ushtarak atje. Mas do muje që u zhduk, e dishim që ka shku në UÇK po kërkush s'e dike ku osht, çka osht', tek osht. Edhe mu më kapi njëfarë sikleti shumë i madh, dojsha me ditë ku o', dojsha me ju bashkangjitë. Edhe prej marsit nime e morra shumë tragjike. Po e kom pasë një mentor shumë t'mirë të temës t'diplomës i cili dikun kah maji kur shkova në fakultet tha, "Fis," tha, "Aman. Kqyre sa ngat e ki. Veç hiçe qafe, kryje. Kryje temën e

diplomës,” tha, “E këto provimet,” tha, “Po t’i shtyj,” tha, “Për verës,” tha, “Veç kryje temën e diplomës”.

E marr unë e kryj temën e diplomës për çka po di, njimdhjetë ditë u ula ju koqita, për njimdhjetë ditë e kryjta, e kalova. Masnej verës m’i shtyjti provimet jo në afat të qershorit po diku në gusht, i dhashë veç qato provime, e kryjta fakultetin. Edhe për neve ndryshoi jeta drastikisht se tashti Laura u bo farmakologe, unë u bona *multimedia specialist* [specialist i multimedias] edhe bojshim shumë, koxha shumë pare si përkthyes, tash me ja nisë prej zeros.... Ia niske praktikisht, karriera jonë ia niske si me thanë prej zeros, se si student i posa diplomum, prej rrogave që merrshin si përkthyes dike me kanë njiqind euro, njiqind funta ora, përfundum me asi rroga ka 800 funta muji (qeshë), veç për me shti kamën në profesione tona.

Edhe aty masnej vazhdum. Unë e di një agjencion, kom pasë shumë fat që m’kanë pranë, kom pasë shumë fat. U kanë një agjencion që merrke qisi studenta, jepke rroga katastrofë ama i ka pasë klientat ekstrem t’mirë, a din, *Apple Europe, British Airways*, edhe e panë... ata dojshin me marrë një punëtor, edhe i patën dy kandidatë të mirë, që s’dishin me zgjedhë kon me marrë, mu ose një çikë që ilustron mirë. Tash unë isha dizajner i mirë, po ata kishin dizajnera e ajo çika ilustruese e mirë. Tash kishin qef edhe atë ilustruesen edhe...kur e panë sa entuziazat unë me ja nisë e kësi, më murrën mu në punë edhe na murrën dyve në punë. Vendosën dy me i marrë. Okej! Edhe prej qaty masnej jom hi në profesion temin kështu i kom jepë, s’kom ditë me u nalë, ka 16 orë punojsha në ditë. E kom dashtë, edhe e du kit’ profesion ekstrem shumë. Edhe në Angli të jepin asi... kur don me punu. Dijnë edhe me të keqpërdorë, dijnë edhe me të mjelë, po, dijnë edhe me të vlerësu. Veç duhesh kaniherë me kcy prej pune në punë.

Kaltrina Krasniqi: Tani ti vazhdojshe me pasë një fëmijë...

Fisnik Ismaili: Po, deri.... A po, kadal se jo, kadal se hala, qitu qit’ punën që ja nisa, mas tre muje pasna shku në luftë (qeshë). Si me thanë, në dhjetor ja kom nisë me punu. Në dhjetor ja nisa me punu, në të ’98-tën, qatëherë jom kanë shumë aktiv edhe e pata bashkëthemelu shoqatën e studentave shqiptarë, sa studiojshim, u patëm bo nja 250 veta, shumë murrëm me studiu. Edhe koxha aktivë jena kanë, bojshim, organizojshim demonstrata pro sulmeve të NATO-s në Serbi edhe ka t’vishin ata u takojshin këta krerët e shteteve të ndryshme na qaty përpara t’u protestu. Qatëherë e pata bo ato *Nato Air Just Do It*, s’di a të kujtohet qaj’ sllogani, pat’ dalë në CNN.

Edhe po diqysh u kry në ato protestat, ja nisa me punu, ja nisi intervenoi NATO, një ditë qysh kesh t’u nejtë në punë e pashë një lajm për një fëmijë katër vjeç që e patën gjetë, një shpi e patën sulmu, një familje. Ishin dëshmitarë që një familje e kishin marrë, i kishin vra, e një fëmijë të vogël e kishin marrë me veti, po të nesrit, se e kanë pasë zakon qysh i qitshin trupat e shqiptarëve para shpisë, të nesërmin e shohin edhe fëmijën me trupa të tjerë. Kanë marrë me ekzaminu fëmijën, ai fëmija djegne me cigare në trup, këta e kanë marrë e kanë torturu fëmijën tan’ natë, masnej e kanë gjujtë me trupa të tjerë.

Edhe unë kur ja nisa me lexu për qat’ fëmijë edhe e disha që katër vjeç e kom Viganin në shpi, qaq, qaty m’kapi mu... ia nisa me kajtë, e enjte u kanë, ja nisa me kajtë me të madhe në zyre mo s’mujsha m’u përmbajtë, a din, t’u e ditë qysh, a din, “Pse djali jem e ka qat’ fat me konë qitu rehat, i parrezikum e një fëmijë tjetër i moshës t’njejtë që s’din kurgjo...” A din, veç e paramendojshe, çka ka ditë ai t’u

menu, “Çka ka qiky axha që po m’djegë me qit ciga...me qit’ sen në dorë”. Edhe veç u tmerrova, veç ju thashë këtyne, “Po shkoj në luftë!”

Kaltrina Krasniqi: Qysh e morre atë vendim? *How did you do it?*

Fisnik Ismaili: Kqyre, unë gjithë e kom pasë një *back on my mind* [Në mendjen time] që kom me shku. Po veç ju thashë atyne në zyre, po më shohin ata t’u kajtë, “Po du me shku n’luftë”. “Qysh more po don me shku?” “Ja veç kom me shku”. “Ec shko n’shpi,” ma bonën, “Rri në shpi, nesër e premtë, gjatë vikendit flladite krytë, qetësohu, mos bo budallakina. Munesh prej këtuhit me kontribu”, qet’ fore gjithë ma bojshin, “Hajt se ma shumë kontribon t’u çu pare se kësi,” t’u çu pare, unë 800 euro në muj i merrsha, 800 funta në muj. 800 funta ti menxi e përktheqoshim mujin na. I patëm kursy do t’u përkthy, a din, pak u kfillëm, po jo qaq. Edhe okej, më thanë, “Shko në shpi, shko menohu, flladitu”. “Okej!” Shkova në shpi i thashë Laurës, thashë, “Po eci!” Tha, “E kom ditë që ki me thanë”. Ma dike krytë, unë nime e kom krytë e fortë, kur e thom një sen ti duhesh me m’mytë për me ndërru. Kur e thom një sen që ka të bëjë me mu, se muj me ndërru mendimin, nashta parimet me i lëkundë najkah, po kur nime e thom një sen që kom me bo, e çoj deri në fund.

Tash ka pasë momente që edhe e kom rrehë gojën, shpulla gojës veten t’u thanë, “Çka fola”, a din, “Çka u nguta”. Se masnej ja nisa me menu, 25 vjet i kisha, “Ku po shkoj, ku p’e lo djalin, ku p’e lo Laurën. Çka nëse s’kthehna, qysh jetojnë këta, qysh gjallnojnë, çka kanë me bo?” Të nesërit i thirra ata të punës, thashë, “Unë”, thashë, “Veç po vi me u përshëndetë se po eci”. Shkova u përshëndeta me ta, ma blejtën një dhuratë. Mënyra qysh ata mas tre muje që kom punu me një agjenci, më përcjellën, premtun që më pret puna kur të kthehna edhe mënyra qysh më përcjellën edhe krejt mu m’boni me i dashtë nja dhjetëmijë herë ma shumë edhe me kuptu që, s’po di, qaq të kuptushëm jonë kanë, qaq cara, qaq mirë e përballun e qaq mirë ma bonën mu të përballushme shkumjen atje. Si m’thanë, “T’pret puna këtu”, mu gajlja ma e madhe m’u hek. Unë thojsha, “S’po shkoj me dekë. Unë po shkoj me fitu edhe me u kthy”. Edhe me qat’ menje u nisa. Si e dita që e kom punën e sigurtë kur t’kthehna unë u shlirova edhe pa pikë gajle.

Edhe kurgjo. E thirra faktikisht, e thirra dajën në Lublanë me kqyrë me folë me grunë e dajës me vetë ku është ai tipi se ai me mujë t’u mos e ditë kur është. Kur për fat ai qëllon në Lublanë qato ditë, se u dike që ka me plasë në Koshare, ka me plasë kufini. E ai u ardhë me u pa me familjen para se me u kthy në aksion. Unë, “Dajë”, thashë, “Ku je? Çka u bo, ç’ne”, thashë, “Ka pike në Lublanë?” Tha, “Veç erdha”, tha, “Do ditë me u pa me familjen. Kthehna në Tiranë apet”. Thashë, “Po du me ardhë!” “A je i sigurtë?” “Po!” “A je i sigurtë?” “Po!” As s’më tha, “Mos hajde!” As s’më tha, “S’ki çka lypë!” As kurgjo.

Kur e murrën vesh masnej familja ja nisën ato me thirrë m’ja bo, “Pse i the Fisit me ardhë, ti e din që është hasret, ti e din kështu...” “More”, ai thotë... a din dajtë tjerë t’u i bo presion e familja t’u ja bo, “Heej a je normal, thuj Fisit mos t’vjen”. “More djali po don me ardhë”, ky t’u ja u bo atyne, ai është shumë principiël, është asi ushtaraki, “Djali a po don me ardhë, ka vendosë me ardhë. Pse s’po vini edhe ju?” Ata, “Mmmhhmmm”. Edhe kurgjo! Shkum u takum apet te motra në Itali te Vali, ato si *meeting point* e kena Valen. Prej atyhit hypëm në tren për në Bari, Bari-Durrës.

Kaltrina Krasniqi: Po më doket shkak shumë interesant që e keni bo një qasi kthese dramatike në jetë për shkak se diqysh ke shku në një qytet tjetër, i ke kry studimet. E ke fillu qat' karrierë të cilën e ke andrru edhe mandej ke vendosë me shku në luftë. Shumë çuditshëm e motivume.

Fisnik Ismaili: U kanë njëfarë mllëfi, unë, unë jom inatgj i madh, e pranoj. Edhe po e pranoj edhe një sen që e menoj që e arsyetoj këta t'u thanë që, "Unë jom këmbëngulës ma shumë se kryefortë". Se ki inatgj që jonë kryefortë edhe nëse, nëse e ka edhe e din që e ka keq edhe kokëfortësia nuk e len me e pranu që e ka keq. Unë jom kambëngulës deri në pikën kur nëse e shoh që e kom keq diçka e pranoj, por kom me kambëngulë deri në fund me provu me e bo qat' temën. Edhe, s'po di, inati i madh i mënyrës se qysh unë o' dashtë me lëshu Kosovën, asnjherë unë s'kom mujtë me u *settle*, me u rahatu në Angli, asnjherë s'jom bo shpi në Angli. Tek ka '97-ta na dha shteti një banesë, e ndreqa pak dikun edhe i thojsha veti, "Rahatohu!" Po unë e disha që kom m'u kthy, diqysh ka me ardhë dita me u kthy edhe qikjo plot, plot bashkëatdhetarë që kanë shku atje në qat' kohë nuk i ka lonë m'u... ata jonë avancu me shkolla, me krejt, po nuk jonë *settle*, nuk jonë rahatu.

Edhe e folshim plot herë, njëherë kur t'i nxjerrë rrajtë dikah masnej s'un i shtin kërkah tjetër edhe diqysh jet' qasi njeri i botës, kudo që shkon shpi të bohet. Edhe unë njëfarë mënyre qashtu, se mu m'ka ra edhe me shetitë pak a din sa, kom qenë në Amerikë, kom qenë n'do vene edhe e shihsha që kudo me m'çu rahat isha konë, kisha mujtë me punu, kisha mujtë me jetu. Edhe e shihsha që asnjona s'u nijke taman, taman si shpi. As qitash, ka momente që s'nihna taman, taman si shpi as këtu diku. Nesër me shku dikah tjetër me u ni rehat. Po këtu rri apet prej kokëfortësisë, prej kambëngulësisë edhe prej inatit.

Ta kallxoj inatin qysh ka shku. Mu inati qa q i madh që m'ka nxerrë prej Kosove, mu m'ka kthy në luftë.

Kaltrina Krasniqi: Nuk ke pasë kurrfarë eksperience militare...

Fisnik Ismaili: Zero, hiç, kurrë!

Kaltrina Krasniqi: Çka mendojshe që ki me bo kur vjen?

Fisnik Ismaili: S'di. Edhe është interesant krejt tregimi jem qysh kom përfundu ku kom përfundu.

Kaltrina Krasniqi: Krejt shpjegona qat' momentin, garant as n'Shqipni s'ke qenë ma herët, a ke qenë?

Fisnik Ismaili: Jo, ja-a. Në Shqipni e paramendojshe, kur zhdrypi në Shqipni kom me puthë tokën, a din, aaaa, a din, ashtu...

Kaltrina Krasniqi: E pakupt (18:58).

Fisnik Ismaili: Po, në anije ma s'pari kem t'u i qitë zorrët se ajo një anije asi e shpejtë e lehtë edhe u çun do valë, edhe veç daja që s'e kapi me vjellë. Krejt anija u shtrem për toke, veç erdh na kqyrke qishtu, na t'u dekë. Dojshim bre krejt anija me dekë, ishim nja 150 veta, veç ai na kqyrke qishtu, keshke me neve. Me plasë! M'vike inati. Edhe ai ma boni terr e zi, ai unë kështu asi idealisti, "Kom me puthë tokën e", "O", tha, "Kur zhdrypim. Veç ule krytë edhe hajde mas meje!" Se në atë kohë unë s'disha fërkimet mes, mes maspari dy taboreve të UÇK-së, fërkimet mes, jo fërkimet po lëvizjet e

spionazhit serb aty që rrishin nëpër kufij me kqyrë kush po hin, se tash ti e merrshin vesh që ka ardhë dikush prej jashtit me luftu, e patën marrë vesh që kom ardhë unë masnej ja kanë nisë nëpër Prishtinë me i lypë prindtë e mi se ata këtu patën metë gjatë bombardimeve. Edhe patën shku meniherë në shpi me i vra, po ata patën ikë te halla. Domethanë, informatat dilshin prej dikahit.

Daja ish tepër, tepër i kujdesshëm për m'u rujtë prej qityne, po s'kishe shance aty m'u rujtë, s'kishe kurrfarë privatësie. Edhe zhdrypëm na në Durrës, veç tha, "Ule krytë, mos i fol kërkujna". Aty na u gjujtën do qisi lypësa, veç çka s'tu kapshin për kamsh a din. Hypëm me një kombi, shkumë në Tiranë. Në Tiranë më çoi në, as s'disha ku jom, as s'disha për fërkimet që jonë mrena, as s'disha për komandanta, kurgjo bre hiç, hiç, zero, ide...unë isha ardhë me luftu. Shkum në Laprahë, u kanë shtabi qatëherë i asaj Ministrisë të Mbrojtjes të asaj kohe, domethanë ish kjo e qeverisë së Bujar Bukoshit. As ide s'kom pasë që tash thojnë u kanë FARK-u a s'o konë. Kur kom shku unë as s'u përmendë kurrë as ide s'kom pasë. Unë shkova qaty, as s'disha qysh funksionon, as s'e kom ditë që është edhe një shtab tjetër, shtabi i përgjithshëm. S'e kom ditë që kanë fërkime, zero bre, hiç! Pak pa hi e di që veç më pat' thanë daja, "Prej qitij momenti, nuk je nipi jem, s'jom daja yt. Ma sigurtë edhe për ty, edhe për mu është mos me ditë që na jena familje!"

Kaltrina Krasniqi: Pse?

Fisnik Ismaili: Se mundet dikush, domethanë ky ish oficer në brigadën e Agim Ramadanit në Koshare për të cilën s'disha unë kurgjo hala, hiç, hiç s'më kallxojke, kurgjo. Edhe mujshin mu me më keqpërdorë për me mri te ai, a po kupton, me kushtëzu ato, me shantazhu najsen, edhe e kundërta, mujshin ato me keqpërdorë për me m'bo mu diçka. Veç tha, "Hiç mos u çel!" Kërkujt s'i besojke ai, absolutisht. Edhe unë tek ma vonë e kom kuptu që ka pasë shumë arsye mos me ju besu njerëzve sepse në krejt përvojën teme të Koshares unë kom pa qisi dredhina, padrejtësi që na kanë bo njerëzit që sot e udhëheqin qit' ven, për të cilat mu s'më takon me folë sepse unë nuk jom kanë në qat zingjirin komandues ku, nime i kom pa, unë i kom ni muhabetet, t'kallxoj pse i kom ni edhe qysh i kom ni plot sene po s'e kom *complete picture* [Fotografinë e plotë] me kallxu saktë kush çka ka bo, shpresoj që vjen dita najherë edhe çelen qato letra, po mu s'më takon se unë kom qenë veç ushtar i thjeshtë po me një detyrë shumë të ndishme.

Kaltrina Krasniqi: Çka ke bo?

Fisnik Ismaili: Veç ta shpjegoj qysh kena mbri. Tash ish njëfarë procedure, kur mbrijshe në shtab në Tiranë, shtabi t'çojke në njonin prej, jonë kanë tri katune ku ushtrojshin ka dy javë ditë, u kanë Babina, u kanë...i kom harru edhe dy katunet tjera. Edhe njo u kanë me B... i kom harru. Jonë kanë tri katune, kur më çunë mu në Babinë, e kishin marrë shkollën e katunit, e kishin shndërru në një mini kazermë. Domethanë objekti, qaty flejshin ushtarët, e kishin rrethu me tela mos me mujtë banorët me hi as këta me ikë. Edhe qaty edhe një objekt ish tjetër jashtë në të cilin ishin do kreveta, s'kish shumë hapësinë. Edhe vij unë, më caktun mu me një tog me prej pesë vetash me gjujtë me do asi minahedhësa 82 milimetra a din, që i qet' në tokë, ja shtin predhën edhe puup [shpjegon me duar], edhe gjun nja katër kilometra larg nëse s'gaboj, edhe ushtrum na nja dy ditë, kurrë unë pa prekë asi minahedhësi, as s'disha qysh...

Kaltrina Krasniqi: A keni njoftë naj lloj të armëve?

Fisnik Ismaili: Ja-a. Po, ka pasë babi revole të cilën e merrsha në dorë najherë lujsha, kurrë s'kom shkrepë. Qaty shkrepëm pushkë, ushtrojshim me pushkë. Më ra mu me ushtru dy ditë, dy javë ish kohëzgjatja ku togjet ushtrojshin bashkë edhe masnej i çojshin në front. Fronti sapo ish çelë, domethanë sapo pat' nisë Beteja e Koshares, s'po më kujtohen datat saktë po jem t'u folë dikun rreth 9 prillit. Domethanë unë e di që, okej, 8, 9 prill unë kom mbrri në Babinë. Dy ditë kom ushtru. Me qata 82-sha, i mësum ato pjesët e ndryshme, qysh me ja mësu, qysh me marrë, atë nishanin, krejt më mësojshin. Aty isha me katër djem të tjerë me të cilët u njoftum, kurrë s'isha pa në jetë me ta, që mësojshin, qishtu pa përvojë si unë. Edhe u munojshim tash me i ra në fije kush në cilën pozitë, për shembull qaj' që ish ma i kfillti u dashke qat' far nishanin, kur t'i jepke koordinatat ti u dashke xxxx {onomatope} për pesë sekonda me ja ndërru, me ja qitë ato për me ditë ku me...

Kaltrina Krasniqi: Kah me shku...

Fisnik Ismaili:... kah me ja terezitë atë minahedhësin. E për ato u dashke me kanë pak i kfillt. Po ai gypi edhe një pllakë që ishin, ishin shumë të rana, për ato vyjshin do njerëz të mëdhenj me bajtë ronë, tash mu më qitën me bajtë ronë, knena kur na ushtrojshin për me ksi, unë e bojsha ma s'shpejti. Ai ma bojke, "Po ku me ta jepë..." Ai që e majke nishanin e kish një çantë qikaq t'vocërr, (shpjegon me duar) "Ku ty me ta jepë çantën qikaq t'vocërr kur ti ish dashtë me kanë ai që e banë atë një sahon që osht' 25 killa n'shpinë". E qishtu, t'u mos i ra fije hala çfarë detyre kom me marrë. Edhe një mbramje, ama jem, krejt këto jonë do momente që thom ma kanë ndryshu jetën.

Një mbramje u kthym na prej ushtrimeve, shkum me hangër diçka, po dal prej shkollës, edhe unë flejsha në qit' objektin jashtë shkollës. T'u dashtë me hi në objekt, po thom tre hapa ma vonë, unë kisha hi në objekt dhe personin që ka dalë prej shkollës nuk e kisha pa nashta deri në fund të luftës. Ai ish Gania, një ish ushtarak i Armatës Jugosllave i cili ka jetu në Londër edhe i cili ka punu në Sllatinë këtu si ndërlihdhës, edhe ka ardhë në luftë. Tash ai kish ardhë në luftë qat' ditë edhe u taku me komandantin i ka thanë, "Unë jom oficer i ndërlihdhjes". Këta ja bojnë, "Ku-ku, s'ka ndërlihdhje në front".

Ja ka nisë lufta atje, u shpërthy kufini, jonë t'u pasë probleme me komunikim. Edhe i thojnë Ganisë, "Dil menihere, qe ku i ki ushtartët, zgedhi ushtarët për me kriju repartin e ndërlihdhjes". Edhe Gania del qaty në oborr edhe më sheh mu t'u hy në objekt, "Fis!" "Ganë!" "O ku je? Qishtu, qishtu", tha, "M'kanë urdhnu me bo repartin e ndërlihdhjes se jena..." Thashë, "Okej, hajde përhajr! A gjete ushtarë?" Tha, "Jo, po du ty me t'marrë". Thashë, "Unë jom me këta 82-shat", thashë, "Unë, s'muj unë me ardhë tek qashtu". Tha, "Po shkoj," tha, "P'e boj kërkesën te komandanti", se Musë Dragaj ish komandanti i qasaj shkolle, qasaj mini-kazerme. Shkoi te Musa, i tha, "Qishtu, e gjeta një ushtar. Po du qato me marrë". Ja bojsha, "Lidhje s'kom me ndërlihdhje. Çka di une me radiolihdhje". Po, jom kanë në do gara të radioamaterave, disha me i ndërru frekuencat, tha, "O ki ma shumë lidhje se qita qitu që po i shoh".

S'të kallxova, një nishan do djem e kishin problem, s'po du tash une me u fry a najsen, po kishin problem me, pa përvojë komplet. Tha, "Ti din bile me kompjutera me sene", unë me veti i kisha marrë prej Londre, skener, aparat dixhital, sa patën dalë aparatat dixhital, 600 funta e pata ble. Kom pasë qisi pajisje *mouse* e qisi sene, *laptop* s'pata pasë. Po pruna qisi sene që mujnë me ju vyjtë ktyne. Për

shembull, kur ja u kom çu skenerin ata a din, ekstrem shumë ju kish vyjtë skeneri, s'e kanë ditë që ju vynë edhe na pat' dalë shumë, na pat' kry punë. *Anyway* [Nejse], edhe ky Gania m'u tek mu veç me ardhë, thashë, "Çka të thotë komandanti". Unë ushtarë, isha hallakat, s'po di kurgjo. Edhe shkoi ai, i thotë Musës, "Qishtu, qishtu". Musa s'e dike kush jom, as idenë s'e kish. "E gjeta një ushtar!" Si e kanë marrë vesh n'front atje që... Babina o' një katun ngat Bajram Currit, domethanë osht' një copë rrugë deri atje. Si e kanë marrë vesh që u çelë reparti i ndërlidhjes, meniherë ka ardhë urdhni me shku na në front.

Domethanë pa i kry dy javë ditë ushtrim, pa kurgjo, se ndërlidhja nuk osht' që përballet me luftë frontale, ndërlidhja hin me një gropë qaty edhe komunikon. Po duhesh me gjetë mënyra qysh me komuniku. Tash çka kish ndodhë atje në Koshare, ish zgjonu fronti shumë. Tash kur zgjonohet fronti, ato radiolidhjet e vocrra që i ki ja nisin mos me ni njoni-tjetrin. Edhe shkum na me Ganinë nalt, m'kujtohet si sot, qat' natë u pat' vra Agim Ramadani. Unë as s'kom ditë kush o', as s'kom ditë, kurrë s'kisha ni për to, a po kupton, kur je komplet i shkëputun me një vend tjetër.

Hinëm na, shkum atje nalt mas një, se niherë u nisëm me njëfarë kerri po tash serbët gjujshin edhe mrena në territor të Shqipnisë ja nisën me granatu qat' rrugë, u dasht me zbritë prej kerrit me i ra malit përpjetë, aty e kom pasë një ecje, jom konë koxha i trashë edhe atëherë, që s'di as vetë qysh e kom përballu me katërdhetë kilogram ranac n'shpinë. Edhe mbrritëm diqysh na në Padesht, Padeshti është një katun, e ka pasë një shpi e cila ish baza... katun në Shqipni i cili është si me thanë, me sy qatje e shihshe kufinin me Kosovën, domethanë menihere qaty. Se tash kur u çel lufta, ajo u shpërnda edhe mrena në Shqipni. Edhe tash e kishim na edhe nja tre-katër kilometra mas shpine zonën ushtarake se hishin serbët knena, u munojshin me na shpjegu prej përmasit {shpjegon me duar}, e kjo ish si n'mes. E qaty ish si me thanë baza e krejt çka ndodhke.

Qaty flejshin Anton Quni, Rrustem Berisha që sot jonë deputetë, Sali Çeku që është hero, Agim Ramadani, Abaz Thaçi. Edhe hinëm na mrena, ata ishin bo vorr, ju kishin prishë ftyrat, na t'u mos e ditë as çka po ndodhë. Po na kqyrin, Gania mu m'bike dej qitu (shpjegon me duar) ma i vjetër se une, qel me mjekërr. Unë i gatë, i trashë. Po na kqyrë Rrusta, "Kush jeni ju?" Gania tha, "Unë jom", tha, "Ushtarak i ndërlidhjes. Udhëheqësi i ndërlidhjes". Domethanë ai epror meniherë, se si kishe përvojë ushtarake në ish-Jugosllavi u bojshe epror. Tha, "Unë jom epror i lëvizjes e ky është ushtari jem". Po m'kqyrë Rrusta, tha, "Ti dil jashtë!" M'nxurri jashtë. Unë meta qaty në korridor u mërdhiva deri folën ata, nja dy orë. U takova me një djalë qaty, m'kallxojke ai kapak, lidhje bre s'kisha, Seferi, Sefer Berisha m'kallxojke, a din, u munojke me m'kallxu qysh o', çka po ndodhë, me ma shpjegu situatën.

Sa ish thy kufini, s'u dike ka sa po shkon pasuli. Dul Gania me Rrustën edhe Rrusta e çeli, u kanë një shpi që i ka pasë qishtu dy kate, një dhomë të madhe nalt, dy dhoma ma të vogla, si një korridor. U kanë shpi, asi kullë e gurit, që dera qitu m'bike (shpjegon me duar) u dashke qishtu me hi (ulë kokën shpjegon si i është dashur të përkulet për të hyrë brenda). Edhe poshtë jonë kanë dy ambiente ma të mëdhaja, domethanë dy dhoma ma të mëdhaja. Këto nalt jonë kanë të ndame, dy dhoma të vogla.

Edhe nalt ish *headquarters* ku flejshin krejt komandantat, këto dy dhoma qashtu si u shfrytëzojshin si depoja, flejshin do ushtarë aty e do qisi komandanta tjerë. Edhe dy dhoma, njona ke e pashfrytëzume, të cilën na e dhanë neve, e vogël. Edhe na thanë, "Qitu lidhni këtë pajisjen se u dashke me lidhë..." A e

ke vërejtë taksitë kur folin, kaniherë taksi me taksin nuk nihen po baza gjithë nihat, domethanë ai folë baza me një taksi po përgjigjja e taksit nuk nihat. Domethanë çka u bomë na, na u bomë baza ku dy radiolidhje që s'mujshin me komunikim me njona-tjetrën, komunikojshin përmes neve.

E osht' domethanë ekstrem i randësishëm se tashti ai të thotë, "Sulmo prej qituhit ose ruju prej qatyhit", ti duhesh fjalë për fjalë me ditë me ja interpretu atina, edhe me ditë kon me e thirrë me i kallxu. Edhe kjo punë me të cilën u përballëm, unë u përballa për herë të parë, po as Gania nuk o' që në luftë najherë u marrë me radiolidhje, u marrë në Sllatinë në aeroport, po jo në gjendje lufte. Edhe hinëm na i gjetëm frekuencat, i montum ato centrallat i bonëm ato krejt. E ndreqëm.

Tash me lidhë kablla di edhe unë, i lidhëm kabllat e masnej ajo shpija s'pat' as rrymë, e gjetëm një agregat t'vogël, i lidhëm krejt kabllat, i lidhëm i qitëm do poça të vegjël e ndriqum edhe shpinë me një agregat, qaj agregat na vyjke me i mushë edhe bateritë e radiolidhjeve të atyne në front, ata kur vishin u dashke me i mushë dikah. Rrymë s'ke pasë atje. E bonëm nifarë sistemi, se një kuzhinë e kena pasë, ma vonë u maru kuzhina, kuzhina u kanë diku edhe ma larg prej frontit. Kuzhina shkojke e merrke, ja u çojke ushqimin atyne në front. Edhe t'u shku, u nalke te na i merrke bateriat e mushta, i çojke në front ja u shpërndajke ushqimin, bateriat atyne, i merrke bateriat e shprazta, u kthejshin na jepshin neve, na i shtijshim m'u mushë.

Edhe qashtu u sigurum që nëpërmes logjistikës na nonstop e kena këtë brigadën në komunikim, kun' pa asnjë problem sa i përket radiolidhjeve. Në ndërkohë vjen një djalë, Burimi... kur hini Rrusta mas tri dite në qat' dhomën e vocërr, kur e pa çka kena bo qaty na krejt Drita tha, "Çka kokët more ju kështu?" Na e bonëm krejt *high-tech*. Edhe erdh Burimi, një djalë i ri, edhe tha, ai u kanë bartës, bajke të plagosun qishtu, u kanë një detyrë. Qita ushtarë e kanë pasë detyrë me shku kur të plagoset dikush me ja jepë ndihmën e parë, me i bajtë deri te rruga ku vike kerri me i marrë me i shëru.

Bartësit jonë kanë shumë të fortë, si gjaja jonë kanë, edhe jonë kanë të shpejtë qishtu. Burimi u kanë llegendë, djalë shumë i kfilltë, student i elektros, tepër i kfilltë. Erdh një ditë, tha, "Kqyre", tha, "Nuk është punë e jemja po në Karautë të Koshares ku e patëm marrë na objektin ushtarak të Serbisë", tha, "Jonë do radiolidhje të serbëve që i kanë gjujtë qaty në podrum", tha, "Edhe po dojnë me i prishë," tha, "Unë", tha, "Jom, elektron e kom t'kryme, unë ndreqi qisi sene", tha, "Edhe gjynah është qato me i prishë, mujna me i shti në përdorim". "More", i thashë, "biri këtu meniherë. Se qato jonë centrallat e ushtrisë të Serbisë".

Domethanë e dhezë njo, munësh me i ngu krejt çka po folin ata. E murr ai e gjet' një magar, e ngarkoi, i pruni edhe i lidhi p'i lëshoj, p'ja nisi me i ni shkijet çka po flasin krejt. Burimi knena kur kish kohë të lirë vike na i ndreqke do qisi pajisje që ju prishshin najkujt radiolidhja, ja nisi me i ndreqë edhe Gania p'e qet' kërkesën tha, "Qito p'e dojna në ekip me pasë!" Edhe u bonëm na shumë veta për një dhomë të vocërr, na dhanë njonën prej dhomave poshtë, edhe hinëm na u bonëm *high-tech*, dhoma u kanë sa me thanë, sa qikjo hapësina qitu (shpjegon me duar), nashta ma e vogël, ma e vogël, jo koxha ma e vogël në fakt.

Edhe na hinëm e qitëm, edhe një qysh radiolidhja e Serbisë, një qysh radiolidhjes të Shqiptarëve. Edhe unë kryesisht masnej jom marrë me përgjim të krejt qajo njohunia e stripave që i kom lexu, filmave serbisht që i kom kqyrë e krejt mu m'dulë në rrugë qaty në një profesion të cilin as s'e kom ditë që kom

me bo, që faktikisht e nxerra. Unë ja nisa me i përgju ata, edhe me marrë vesh krejt ku, e qita hartën edhe e kqyrshim ku luftojnë tonët, për shembull tonët e kishin kah një nofkë, çka po di 327-shi u kanë Hysen Berisha, Mjekrra, ky, ai, ai.

Tashti ti e dishe që qitu po lufton 327-shi edhe ja nisshim me i ni ata ku po luftojnë serbët. Ku kish aktivitet. Edhe u kanë njoni Xhavo për shembull, Xhavo serbisht është dreqi, edhe Xhavo, kur sulmojke Xhavo unë i nijsha aty ushtarët e Hysenit t'u komuniku, edhe e dishe që Xhavo po lufton me ta. Edhe unë pak a shumë ja u morra edhe pozicionet ku jonë nofkat e ushtarëve serbë, e këtyne si me thonë, garnizonave serb. Edhe tash unë e disha secila nofkë me kon është përballë pak a shumë, m'u ka dashtë nja një javë ditë me i mësu. Edhe masnena në bazë të qatyne informatave, kur u paraqitke naj vëzhgus që dojke me na sulmu neve. Vëzhgustë jonë zakonisht një ose dy njeri që hijnë thellë në territor tonin, ata s'vrajnë njerëz, ata veç kqyrin edhe i kallxojnë artilerisë që, "Gjashtë-shtatë kilometra përmas gjuj qitu, gjuj qitu, gjuj qitu, vraje qito". Tash unë ja nisa me ja u mësu koordinatat, kur ai jepke koordinata, unë i thirrsha këta ju thojsha, "Ku ra qikjo predhë?" Ata kallxojshin, "Qitu!" Edhe pak a shumë na e dishim cili vëzhgus në cilin ven ka me ta sulmu, me cilin cak ka me ta sulmu njerëzit. Kështu që dikun mas nja dy jave unë shlirë e disha 99 përqind saktë kur u fole një vëzhgus ku ka me sulmu me artileri, unë e disha kon kanë me na e gjujtë.

Tash deri ia jepke ai koordinatat, deri e bojke ai nishanin, deri e shtike, deri e armatoske tytën e minahedhësit, deri e lëshojke, deri u shkrepke, deri fluturojke ajo ishin dikun nja 45 minuta, sekonda [gabon] kohë dej t'vijke predha ty me t'ra. Tash për qat' një minutë unë u dashke me gjetë kush, kon jonë t'u e gjujtë me ja u bo, "Hiçnu prej qatyhit!" Edhe ata u hekshin, edhe bike predha në të shprazët. Po tash ky vëzhgusi nashta e shihke t'u u hekë, nashta s'e shihke, po tash vëzhgusi me thanë, "Valla s'e myte kërkon!" Ata i kishin thanë, "Ani rri qaty jepna koordinatat deri t'e mytë dikon". E ai vëzhgusi nonstop thojke, "Aaaa, i çove në ajër shtatë veta". Unë knena i thirrsha, "A jeni mirë?" Ata, "Mirë jena! Super jena!" Ky, "Aaa i çove në ajër pesë veta". Ai atje t'u ja rritë veti numrin që, "Qyre, je t'u pasë suksese". Këta knena, "Jo more mirë, s'na huçi, na lajmërove me vakt edhe pshtum".

Kaltrina Krasniqi: A vdisshin njerëzit?

Fisnik Ismaili: Kush?

Kaltrina Krasniqi: Shqiptarët.

Fisnik Ismaili: Po, 114 kanë ra dëshmorë. Po kjo u kanë në raste, tash ti s'ke mujtë, ke pasë konfrontime plum me plum ku ti s'ke mujtë. Unë po flas për qito që kena mujtë me i parandalu, zakonisht komunikimet me artileri e qito ku u përfshijshin njerëzit me radiolidhje, ato pothuajse çdo herë i kena *intersept* edhe i kena pre edhe kena nxjerrë ma të mirën prej tyne. Ti ke pasë raste kur ke pasë front ushtarë me ushtarë ose ke pasë raste kur NATO na ka gjujtë niherë na i ka mytë pesëmdhetë veta, edhe njihërë tjetër, dy herë NATO na pat' gjujtë.

Ke pasë raste kur jonë vra plot edhe qato tri ditët, katër ditët e para pa ekzist...s'po thom që reparti i ndërlihdjes e ka pshtu brigadën, po e ka lujtë një rol kyç në dy sene, njo edhe seni ma kryesor u kanë me i rujtë tonët, me i rujtë tonët në sensin që me ditë na me ja u parapri punëve të tyne, që e kena bo na shumë mirë. Edhe tjetra o kur vike naj informatë sporadike që ata ju rrshitke goja a najsen, na qato

e shfrytëzojshim me ju ra atyne. Edhe ajo ka ndodhë koxha do raste ku ata kanë pasë humbje të mëdhaja prej një informate, një fjale goje që ai e rrshtike në radiolidhje. Edhe veç u dashke me nejtë gati, 24 orë unë veshin qaty. Edhe u dashke me i kuptu çka po flasin kur folshin me kod, me i mësu edhe do kode. Për fat të mirë na kishim oficer të ish Jugosllavisë që i dishin do kode, tash unë kur s'e merrsha vesh najno ja bojsha Anton Qunit, "Çka deshti me thanë me qito?" Ai ma shpjegojke, i shkrujsha, i majsha në men. Edhe s'mu desht mu një javë e gjysë për me ja u ditë, më fal në shprehje, krejt pordhat me ja u mësu.

Edhe masnej, tash njerëzit, njerëzit kujtojnë që lehtë o' konë, se nime ke nejtë me një birucë, ke ngu, edhe u dashtë tan' kohën shumë i vëmendshëm me konë për me nxjerrë informata të cilat na kanë hy në punë edhe me i pasu qato informata. Tash ti i ke pasë ton' ato regjimente të ndame edhe ti dikuj ja ke jepë dy informata në ditë, dikujt aty njo, dikujna... Na i shkepshim nashta, krejt brigadës ja shkepshim njizetë informata në ditë po për ta a din, dikujt i kanë ardhë dy, dikujt njo, a din, s'ju ka dokë që bojmë shumë a nime na kena bo ekstrem shumë se u dashtë me menaxhu komplet një brigadë e cila e ka nisë me 1500, me 150 veta e u bo 1500 veta e madhe. Edhe krejt komunikimin e krejt përgjimin që e kena organizu, na dul zani.

Masnej na me radiolidhje u lidhëm me Suharekë e me do vene. U lidhëm me këta të Ramushit në Glllogjan që s'kena pasë komunikim hiç me muj, s'dishim as çka po ndodhë, ata kajshin atje në radiolidhje prej gëzimit. Neve na dul diqysh si ndërlihdësat e Koshares, na dul zani kështu koxha. Unë muj me të thanë lirshëm që për tre muj betejën e Koshares, 114 veta jonë vra. Nëse s'gaboj në betejën e Pashtrikut e cila ka zgatë një dy javë, edhe aty o' thy kufini jonë diku mbi 250 të vramë. Tash nëse për dy javë në një vend tjetër vrahën 250, e këtu për tre mujë veç 114, kallxon diçka. T'u e marrë parasysh që beteja e Koshares njihet si beteja ma e shtirë najherë që o' bo në UÇK, se nime u kanë një konfrontim që na i kena pasë dikun forca serbe i kena pasë një dymdhetë mijë përpara edhe u kanë nime një konfrontim shumë i ashpër, edhe t'u e marrë parasysh krejt qat' fuqi që na ka ra neve me 114 veta të vramë për qaq kohë të gatë në krahasim me vendet tjera kallxon diçka.

Kaltrina Krasniqi: A u tutshit?

Fisnik Ismaili: Interesant është, kom pa raste kur ja të hike tuta në palcë, ja t'hupke tuta krejt. Unë jom kanë, unë jom kanë qaj që interesant është qikjo, bash qikjo ndjesia e luftës. Jom munu me analizu edhe ma vonë. Me t'u zhdukë tuta qashtu është edhe njëfarë ndjenje ekstrem e mirë, po edhe kur e menoj sot tutna pak, thom, se t'kallxoj qysh m'ka vazhdu kjo edhe mas lufte. Një pjesë ma e lezetshmja e luftës që o' konë emocionalisht o' konë fakti që ti zhdrypshe në atë nivelin ma bazik të jetës, *survival* [mbijetesë] me gjallnu. Aty ishe ose ki me dekë, domethanë *kill or be killed*, ose ki me vra ose kanë me t'vra. Nuk kishe aty me menu diqysh.

Masnena menja jote është qaq e shlrë se nuk ki me menu gajle për fatura të rrymës, s'ki me menu gajle qysh kom me shku nesër n'punë, a kom benzinë n'kerr, a kom pampersa për evladin, more a kom evlad *at all* [fare]. Kurrfarë gajle, krejt po t'u zhdukshin ato edhe ish diqysh qajo ndjenja ma, qaj far' instinkti kafshëror veç me *survive* [mbijetu], edhe diqysh a din çfarë lirie ajo mendore po të jepke, diqysh hiç bre s'kishe gajle tjera. Me hongër, me pi për me gjallnu edhe me luftu për me gjallnu, kurgjo

s'kish tjetër. Me fitu edhe me metë gjallë! Me përjetu fitoren. Se prej rasteve që i kom pa, kushdo që ka thanë, “Kom ardhë me dekë për Kosovë!” Ka dekë.

Kaltrina Krasniqi: A u mërzsitshe?

Fisnik Ismaili: Në fillim... edhe unë jom kështu i ndishëm jom ndaj gjakut e qityne pamjeve. Interesant qysh po t'u kputshin krejt, hiç s'po kishe ndjenja. Po kur po t'hike tuta masnena p'e kuptojshe që çdo humbje n'luftë është pjesë e qatij procesi, është *colateral damage* [dëm kolateral] edhe diqysh po harrojshe, a din, edhe, “Okej, shkoi. Po na tjerët duhet me metë gjallë”. S'kishe vakt me u mërzsitë, a din, t'dhimke, t'vike një dhimtë nihere edhe masnena s'kishe vakt me menu për atë punë.

E bile, bile, pak para lufte u plagos daja. Edhe kur murrën ata me m'kallxu, qatëherë e kanë marrë vesh që e kom dajë, veç dy-tre veta e kanë ditë, Gania e do, veç dy-tre ma t'afërt e kanë ditë. Edhe qatëherë kur e kanë marrë vesh masnej t'u thanë, “Qysh s'keni kallxu”, a din, “Dajë e nip, a jeni normal?” Masnej, “Jo bre”, thojshin, “E dini Bashkimi çfare o'. Po nime, Bashkimi o' qasi, shumë strikt, shumë ushtarak”. Po kur e pa që o' plagu a din, t'u e çu në spital ky ju ka thanë, “Kapni krejt teshat që i kom, krejt çka m'deshni, krejt *possessions*, krejt këto çka i posedoj t'miat, me i shti me një kuti me ja çu Fisit”. Këta, “E pse Fisit?” “Se o' nipi jem!” “Qysh nipi jot?” Edhe m'i prunën mu senet, masnej t'u ma bo, “Qysh s'keni kallxu?” “S'ka dashtë daja me kallxu”. Krejt në rregull. Daja pshtoi mirë, qitu e ka pasë një copë shatmedhe prej një predhe (shpjegon me duar), kurgjo serioze. Kanë mendu që o' serioze po ka pshtu mirë. Edhe, pse e ndërliidha unë këto me dalë se m'hupi pak...

Kaltrina Krasniqi: Me mërzinë...

Fisnik Ismaili: Po, te mërzia. Edhe e di që kur murrën me m'kallxu, se tash e murrën ton' vesh që u plagosë veç unë s'kisha ide. E po m'ulin qaty Gania me ata dostat ma të mirë, “Fis po dojna me folë me ty diçka”. Unë seni i parë që m'shkoi ndërmend thashë, “Po dojnë me m'qitë prej pune”. A din, se diqysh qajo ndjenja kur don menaxheri jot' me folë, masnej thashë, “Kadal more, n'luftë jom, s'un m'qet prej pune ky mu”, qaj moment po m'kujtohet (buzëqeshë), edhe n'fund, “Çka u bo?” Tha, “U plagosë Bashkimi”. Edhe pritsha me u trishtu, pritsha m'u pikëllu, meta, kjo ka fundi u kanë i luftës, meta, thashë, “A o' mirë, a o' gjallë?” “Po!” A din, diqysh e pranova që edhe nëse vdekja e tina m'vjen, është pjesë e qasaj se mo u mësuum me, a din, nashta qitash tingëlloj i pashpirt kur e thom qito, po unë po kallxoj qysh jom ni qatëherë, qatëherë s'kisha kurrfarë ndjenja mo, zero bre, s'kishe tutë, s'kishe brenga, s'kishe halle. S'di, njifarë lirie e papërshkrushme. Mas asaj mu m'vazhdoi qajo ndjenjë edhe në jetën kur i kthehesh jetës normale, shoqnisë.

Kaltrina Krasniqi: Ti ke qenë n'luftë deri kur?

Fisnik Ismaili: Deri u kry, 11-tin.... Po, po, me të 11-tin bile, në ndërkohë m'u pat' vra ditën e fundit edhe një, edhe një shok i mirë, jonë konë një ekip që marojshin bureka. Ata jonë kanë s'po di, llegendat e brigadës për mu. Ata i qitshin 250 bureka n'ditë, që i bike një herë në javë me hongër ka një burek dikush, dej ju vike reni. Po dita e burekit o' konë dita ma e lumtun e atij ushtari, jonë konë tre veta që marojshin bureka. Ditën e fundit, një ditë masi u nënshkru marrëveshja, me 12 qershor, serbët na kanë rrokë qat' shpi. Ajo shpi o' goditë, ajo shpi o' gjujtë, predha ka ra në oborr të asaj shpije gjatë tan'

luftës, gjatë tan' periudhës së Koshares se e dishin që qaty është ata me asi *triangulation* është ajo metoda ku e dishin që valët po dalin prej qatyhit, po është si luginë e s'e dishin saktë, veç bishin predhat në oborr tan' kohën. Po ditën e fundit ku na s'u lodhëm, u lëshum, ata kanë hypë një maje ma nalt, e kanë pa ku jena, na kanë lëshu dy predha.

Po unë kom qëllu në Tiranë qat' ditë se daja u kanë i plagost, e jom shku m'u taku me dajën edhe e kanë vra Azizin qat' ditë. Azizi u kanë njeni prej qatyne ushtarëve që i ka gëzu njerëzit njëherë në javë. Aty, a din, ka shku...po du me kallxu randësinë e logjistikës edhe asaj pjesës që s'.... Unë po t'thom, gjatë krejt luftës s'kom shkrepë asnji plum, kur kena ushtru veç, mu s'mu ka dashtë me shkrepë plum, puna jonë u kanë qajo. Puna e kuzhinës u kanë me maru kumpira. Puna e bartësve u kanë me bajtë të plagosun, edhe ai e ka ditë qat' detyrë, e ka bo qat' detyrë, pa to na kishim pasë humbje edhe ma të mëdhaja. Unë besoj që pa repartin e ndërlihdjes, ndryshe kish përfundu beteja e Koshares. S'po të thom që e kishim hupë betejën, po epilogu i saj nuk kish qenë qiky që është, kishim pasë nashta ma shumë dëshmorë, kishim pasë nashta vene ku jena kanë ma të ndishëm që kanë mujtë me na goditë, të cilat i kena zbulu me kohë. Secili e ka pasë qat' rolin e vet për me majtë qat' betejë qysh u kanë. Edhe kur u ktheva në Angli masnena.

Kaltrina Krasniqi: Po më interesojnë qato momentet e para kur e merr një lajm të madh, po supozoj që ka qenë shumë një lajm me randësi që është nënshkru marrëveshja.

Fisnik Ismaili: Tri ditët e fundit të luftës, daja diku nja dhetë ditë para, qashtu para përfundimit u plagos, nashta ma gjatë. Apet po lidhem, ndërkohë prindtë e mi diqysh kanë ikë prej Prishtine edhe kanë përfundu te motra në Itali (qeshë), po të thom une, Vali, motra në Itali është kështu.... Edhe unë kohë mas kohe çka bojsha, se vishin gazetarë që dojshin me na intervistu edhe unë jom kanë njeni prej pak njerëzve që disha me folë anglisht edhe unë i sharmiratsha gazetarët aty edhe ata u shkrishin që po din dikush me folë anglisht edhe kur ju kallxojsa që kom lexu në Londër e ju dhimsha, ata ma bojshin, "Përdore telefonin tem satelitor".

Shumica kishin telefona satelitorë, mu m'bike kohë mas kohe me i thirrë, me folë me Laurën në Londër, me djalin e me motrën në Itali. Edhe kurgjo, unë pata marrë vesh që ata jonë në Itali, kur u plagos daja, ju lajmërova, ju thashë, "Qishtu, qishtu, o' plagosë, në Tiranë". Edhe nana jeme çohet prej Italie niset në Tiranë te vëllau, unë marr vesh që po shkon edhe e lypa lejen me shku edhe unë në Tiranë dy ditë, tri. Se paraprakisht niherë më patën çu me detyrë mu në Tiranë me i marrë do pajisje, na e çun një lllaptop prej Anglie neve, enkas mu e Ganise dostat e Londrës i mledhën paret na e çun lllaptopin. Po të thom na u bonëm *high tech*, lllaptop, skener, aparat dixhital. Kur t'ja nisëm na aty me shumëzua harta me ju kallxu NATO-s pozicionet e Serbisë e sene, krejt qaty në qat' zyrën tonë u bojshin. Aty jonë bo shumë sene. Në fillim ke veç si ndërlihdje, si centrallë, mandej a u bo përgjim, a u bo fermë e mushjes së baterive, a u bo çka t'vyjke elektronike te na e kishe, a ja nisëm me aparat dixhital me i fotografu krejt me ja jepë vëzhgusve, ata e dishin, i fotoqrajshin, na i procesojshim informatat, ja çojshim NATO-s. Gjithçka u bojke qaty, nime shumë *high tech* u bo.

Pjesa e Pestë

Fisnik Ismaili:Edhe, qe apet dola, harrova pse. Po get zgati pak e po më ikin do mendime.

Kaltrina Krasniqi: Shkove në Tiranë...

Fisnik Ismaili: Eh po. Shkova në Tiranë niherë me marrë qat' llaptopin edhe tashti i thashë Antonit, thashë, "A po m'çon edhe niherë, t'shkoj t'takohna me nanën". Edhe po Gania ish shku anena në Sahon, në Pashtrik me ja u ndreqë atyne ndërlihdjen se ata veç ja nisën sulmit me thy kufinin, tash sa ish ai në Pashtrik unë meta n'komandë se unë isha ushtari ma i vjetër i Ganisë edhe Antoni m'tha, "Munësh me shku kur t'kthehet Gania". Gania u vonu met' do ditë, deri u kthy Gania gati, s'e dishim na që po kryhet lufta po ish dikun u bo 7-8 qershor qashtu, edhe qatëherë Antoni tha, "Okej", tha, "Munësh me shku qitash". Bile, bile atë fletëlëshimin kur ta jepë aty shkrun, "Ushtari, vijë", ta shkrun emrin Fisnik Ismaili edhe ky po e shkrun Fisnik Ismaili edhe aty te ushtari p'i mshon vijë *frrc* {onomatope} edhe po ma shkrun, "Eprori". E kom, eprori, edhe po ma bon, "Kqyre!" Thashë, "Çka?" Thashë, "Komandant m'bone, a?" Tha, "Kur t'kthehesh", tha, "E zyrtarizojmë këtë punë". Edhe unë shkova, thashë epror u bona, komandant. (Qeshë)

Edhe shkova unë në Tiranë, u takova me mamin, nejtëm dy ditë, ditën e tretë u kry lufta. Na midis Tirane uaaaaaaaaaaaaaaaa {onomatope}, t'u u çu peshë. E masi zhdrypën komandantat, erdhën prej Koshares, p'e shoh, thashë, "A të rri edhe nja dy ditë?" Tha, "Rri edhe nja dy ditë". Edhe nejta, s'pat' mo aty. Në ndërkohë u vra Azizi me të 12-tin edhe e morra shumë për zemre se e kom pasë dost. Edhe i kom pasë bile ato *dog ties* [zingjirin e qenit] ato zingjirin i kom pasë, ja pata marrë me i gravu në Tiranë qato ditë që kesh. Edhe më met' me emën të tina më met' në dorë e masnej ja gjeta familjen, edhe ata e kishin marrë vesh, ja gjeta familjen...

Nejta unë masnej nja tri-katër ditë mas luftime n'Tiranë, po ke shumë periudhë e pikëllushme. Atij i kish lindë gruja sa jena konë në luftë, domethanë ai s'e ka pa fëminë e vet. Grunë shtatëzane e ka pasë kur u ardhë në luftë edhe ka lindë ndërkohë, s'e ka pa. Babë i katër fëmive. Dost e kom pasë t'madh, edhe shumë, shumë, shumë, hala maj kontakt me familjen edhe shumë e pata marrë për zemre qat' humbje se diqysh n'fund bre ndodhi edhe krejt palidhje, krejt pa...po menoq palidhje, pa nevojë, pa...a din diqysh e man deri qatëherë edhe në fund për një s'po thom as s'u kanë pakujdesi e tina, u kanë, e kena ditë që kanë me na gjujtë, e kena ditë se thamë, "Kta s'dalin tash Serbia m'u tërhekë pa e shprazë krejt çka kanë n'neve".

Po edhe erdh urdhni, unë e di pa u nisë në Tiranë erdh urdhni, thanë, "Hiçnu prej shpisë, shkoni n'mal qaty në shatorra, rri nja tri ditë". Kanë pritu kta krejt shpija, jonë kanë aty pesëmdhetë-njizetë veta, kanë pritu me dalë dej n'mal edhe qe ndodhi. Bile u kanë oborri plot njerëz kur kanë ardhë qato raketa po veç njo na kanë...nji viktimë e kem pasë. Kurgjo, unë meta me mamën masnena, kur u ktheva u harru ajo puna e eprorit, s'ja kom përmenë Antonit deri para do dite ja përmena qitash, s'ka, u kry luftë, kujt p'i vynë mo komandant me u bo. Kom nejtë masnej nja dy-tri javë në Prishtinë se po kthehesh ti mas, ma shumë bile, me 2 korrik këtu jom kanë.... Po kthehesh mas tetë vjetve.

Kaltrina Krasniqi: Ti mrena tetë vjetve asnjherë nuk ke ardhë..

Fisnik Ismaili: Ja-a.

Kaltrina Krasniqi: Qysh ka qenë?

Fisnik Ismaili: Diqysh po kthehesh si çlirimtar, diqysh, s'di, osht' uau... s'di... hina në Prishtinë përplot energji, a knej coftë, a din, u tutshin njerëzit, hala rrishin mrena. Shkojsha te kojshitë, te dostat, o i thirrsha, u tutshin me dalë në derë, ju hypsha në ballkon, "Ooo une jom bre". Masnej dikur ja nisa i ngucsha, ju folsha serbisht me i tutë edhe ma shumë (qeshë), qisi budallakina. Gëzimi kur i shihsha ata njerëz, kujtesa që t'u kthejshin, krenaria u kanë e papërshkrushme. Masnena krejt ke... qajo u kanë kështu ndjenjë fenomenale u kanë qysh me 2 korrik domethanë që ish përvjetori i shpalljes së pavarësisë, qat' ditë spontanisht kush u kanë në Prishtinë u dalë në rrugë, kush u kanë në Prishtinë u dalë në rrugë edhe gurgullojke prej njerëzve. Ke pasë *jeep-a* të KFOR-it me ka shtatë-tetë njerëz. Kom fotografia që i kom bo. Me ka shtatë-tetë njerëz t'u u gëzu.

Ke pasë njerëz të ekzaltum përtej të imagjinushmes, qajo o' kanë dita kur i hinën Vuk Karagjiqin e hekën te Filologjiku, Nijegoshin e hekën prej atyhit. Bile edhe unë i nxitsha kështu me heke çirilicë kado që ka nëpër qytet. Krejt Prishtina met' pa çirilicë mrena ditës, "Obuça" që i ka pasë te "Nënë Tereza", "Obuça" çirilicë, krejt ja thynë qato, ja thynë te ton', PTK-ja, çka ka pasë mbishkrime serbisht jonë hekë mrena dite. Po mënyra qysh o' bo, qasi kaosi, qaq shumë njerëz jonë dalë e s'ke pasë ti as polici as kurgjo që e man' renin, edhe mos me shku...asnji incident s'u bo qaty.

Njoni ka gjujtë me pushkë diçka përpjetë, KFOR-i *British* [Britanik] e kanë vra një shqiptar. Po asnji incident me thonë e thynë një dyqan e i vjedhën krejt senet, bonën najsen, hiç, hiç. Unë u pata mahnitë me qato qysh njerëzit e kanë rujtë, e rujshin Prishtinën edhe u sigurojshin, "Bankos"-i që u kanë krejt çirilicë e kanë hekë krejt çirilicë, u sigurojshin vec çirilicën ja hekshin *ck, ck, ck* {onomatope} prej gjithkahit. 2 korrik, '99-tën, bile unë jom kanë kështu i nixtsha, "Kqyre, kqyre ku paska çirilicë", ata oooo {onomatope} i gjujshin, "Qy, qy, qy". Edhe krejt, krejt i patën hekë se plot prej tyne jonë kanë edhe të imponume, asi mbishkrime që t'i kanë imponu me zor veç me qitë, veç, kanë bo bre sene.... Nijegoshin a p'e din që u kanë me gisht te biblioteka, ato e kanë bo me qëllim jo me kallxu që o e jona, po me i bo këta nervoz, domethanë me na bo neve nervoz.

Më kujtohet mu ajo skena, se e rrëzuan ato edhe ai met' kështu me gisht teposhtë (shpjegon me duar), o veç skena deri ja kanë kputë qat' gishtin se ja rrehshin me njifarë stupci *dang, dang, dang, dang, dang, dang* {onomatope}, [shpjegon me duar si e kanë thyer gishtin e statujës], ose, "O s'po kputet", e çojshin apet, *uuuuuu* {onomatope}, me një kunxh *dang, dang, dang, dang, dang, dang*, s'u nalshin, *iiiiiiiiii, dang, dang, dang, dang*, dikur *tap* {onomatope} e lshoi.

Masnej ajo skena tjetër, i kom bre edhe në fotografia. Skena tjetër u kanë Vuk Karagjiqin, bustin e Vukit që u kanë i ulun para Filologjikut, e kishin lidhë me një traktor edhe bash korzës e ngrehshin zhag me çu në *otpad* atje n'bërlllog, në deponi. Edhe e ngrehshin zhag ajo *gzhhhh* {onomatope} e grrithke asfaltin edhe ish bo pothuajse i bardhë prej pështymës e këlbazit që e kishin pshty te tonë, e ish terë ajo (qeshë). Edhe e ki pasë njonin që shkojke përmas edhe e kish hekë njonën papuqe prej komës, veç me një papuqe edhe i mshojke asaj skulpturës së bronzit, *dang, dang, dang, dang* {onomatope} [ilustron me duar njeriun duke goditur skulpturën] s'u nalke, *dang, dang, dang*. Ai tjetri t'u folë, "Ama edhe papuqen tjetër". E t'e shtini hekë edhe papuqen tjetër, ai vazhdoi dathë. Këta *dang, dang, dang, dang* t'u e rrehë papuqe skulpturën. I kom edhe fotografiat (qeshë).

U kanë nuk di, në mbramje m'u qky t'u keshë, mbramje që m'ka mushë shpirtnisht ekstrem shumë edhe je qky t'u keshë kur i shihshe do sene, edhe je gëzu tepër, edhe je habitë qysh shqiptarët e kanë kontrollu veten mos me dalë jashtë kontrolli e me t'e fshi krejt qytetin qysh kanë mujtë qat' ditë. Edhe ti qaty e kupton që kadal bre, na kur dojna mujna shumë, shumë të qytetnum me kanë. Se ti e sheh në vene ku ki kontrollë policore për shembull, pak me dalë në Amerikë, në Los Angeles që patën dalë, që patën ndodhë bash qatëherë me zezakun që e vranë ata policët që u patën çu, pak anarki me u bo, krejt rrafsh me tokë ta bojnë qytetin. Këtu, po të thom bre, kurrfarë kontrolli s'ka pasë. KFOR-i i ka pasë do ushtarë që u sillshin ma shumë t'u u përqaftë me shqiptarë se t'u u munu me majtë renin. Na jena përkujdesë për qytetin. Edhe është interesant, kurrë s'kom me harru qat' ditë. S'u përsëritë mo, s'e di që najherë u bo qashtu.

Kaltrina Krasniqi: Mandej je kthy në Londër...

Fisnik Ismaili: Po jo, masnena m'u rrike mu hala (qeshë). Edhe unë këtu, "Hajt se kthehna edhe naj ditë, kthehna". Kur dikur po m'thirrë Laura tha, "Ej", tha, "A ki njet me u kthy", tha, "Se ata të zyrës thirrën, thanë, "U kry lufta. Kur ka m'u kthy Fisi n'zyre me punu?" Edhe ishin konë n'zor ata, ju vyjshin, a din, i kishin marrë do projekte. Edhe masnej i hypa aeroplanit, u ktheva. Po njikohësisht unë u pata dëshpëru shumë me shqiptarët. U pata dëshpëru se i kom kuptu shumë sene çka kanë ndodhë në UÇK mes shqiptarëve, u pata dëshpëru në shokët e mi, në prishtinali kryesisht në mënyrën qysh ata ju kanë qasë UÇK-së edhe çfarë raporti kanë pasë me UÇK-në. Tash knena u pata idhnu edhe me UÇK-në që keqpërdorke edhe uzurpojke në tona anët, diqysh ma flliqke krejt qat' farë kontributi që e bona.

S'erdha unë me luftu për me vjedhë banesa. Na patën kërstitë do, dojshin me hi edhe pleqtë e mi me i qitë prej banese se ata para lufte ja patën ble do serbëve banesën, një 31-sh në Ulpianë. Edhe para lufte, koxha do vjet para lufte edhe kanë jetu qaty. Tash dikush e ka marrë vesh që serbët jetojnë aty, t'u ju kërstitë, "Dilni jashtë!" Këta, "Kadal more banesa jonë është". "Jo. Këtu një serb jeton". "More ka jetu, e kena ble banesën". "Ja, e keni uzurpu banesën e serbit, jashtë ju! E jona". Dej jom dalë unë n'derë, "Kush jeni ju?" "Kush je ti? Ku je konë ti..." "UÇK jena". "Ku je konë në UÇK". Edhe ja therrën dikah. S'e morra vesh as kush jonë as çka. Po e di që unë u dëshpërova shumë me krejt qito fërkimet edhe mospajtimet mes shqiptarëve edhe mosmirënjohja mes njoni-tjetrit. Edhe prishtinalitë si prishtinali që kurrë s'ja kanë futë UÇK-së, edhe UÇK-ja që nifarë mënyre prej mllefrit që prishtinalitë e kanë injoru, ja u ka kthy qishtu, t'u e bo lesh qytetin.

Edhe mo s'po flas për ata n'Shqipni. Shqipnia në të '99-tën u kanë, u kanë perëndim i egër. Aty u doksini, ti me i pa në Bajram Curr, në Bajram Curr në kafe rrishin, kallashat qitu, edhe t'u bo muhabet kallashat në prehën thu ti pjesë e trupit osht'. Mas '97-tës aty në trazirat e '97-tës krejt jonë kanë të armatostë, posaqërisht në veri. Në veri ke pasë asi me maska që ta nalshin kamionin me armatim që vike n'Koshare edhe masnej ta plaçkitke kamionin edhe u munojke me t'i shitë armët, a din, qisi sene që mu m'dëshpërun shumë prej shqiptarëve. Kur shkova në Angli thashë, "Kurrë bre, kurrë me shqiptarë s'du me pasë punë. Kurrë bre hiç". Seriozisht! Se mu m'kish shku jeta edhe atje në Angli t'u u marrë me organizime, me tubime t'u u munu me bo bashkë komunitetin shqiptar, sa kohën e kom hupë në qisi sene, po kurqysh me u mushë n'men.

Edhe u ktheva thashë, “Veç kom m’i nejtë veti gati”, m’fal n’shpërehje, “Bothën tem kom m’e kqyrë”. Edhe nime, ja nisa me u marrë me vetveten edhe mu m’ka ecë masnej shumë mirë në karrierë. Jom avancu shumë, qatëherë ke ai një *.com boom*, ja nisën me dalë uebsajtat, Amazon-i, Google, krejt në qat’ kohë kanë dalë e jonë zhvillu. Edhe a din, m’ka ra mu me punu. *Web designer* punojsha qatëherë, m’ka ra me punu në qisi projekte. Po masnej ke edhe një krizë në 2001-shin ku qaj’ *boom*-i i *.com*-ave shpërthei edhe plot vene të punës u hupën e, edhe ke nifarë krize ekonomike n’Londër të cilën e përballova unë se pshtova pa hupë punë, po nuk o’ konë e lehtë.

11 shtatori, masnej e nisëm na një kompani me një anglez, një amerikan, një spanjoll e një grek. E nisëm një kompani ku dojshim qishtë me bo një *boom* në internet t’u marrë projekte në Angli e t’u i gjetë mandej do kompania ma të lira në Indi e do vene tjera, t’u i kompletu, t’u i mbikëqyrë edhe aty ish profiti, masha ish shumë e madhe. Edhe i kishim shumë ngat me i mbyllë dy projekte ka pesë milionë. Edhe nejse një kompani, qashtë ai amerikani kish pasë sukses ma herët e ai na udhëheqke. Edhe pak ditë mo e çelëm një zyre në Monako, patëm me ja nisë me shku në Francë me jetu në Nice. Dy veta veç u bajtën, ecke jeta, fitojsha. Shkova, diqysh met’ Laura shtatzanë me Petritin në 2000, 2000-shën, 2001-shën. Shkova në Amerikë m’u martojke një kushë, shkova tri javë ditë me nejtë te kusha, ajo ke shtatzanë, s’muji me ardhë, pata pare një kerr me ja ble. Diqysh financiarisht eci shumë mirë. Masnej ja nisëm gradualisht me zhvillu qet’ kompaninë tonë, u bonëm gati me u bajtë në Nice me jetu.

Petriti lindi me 3 shtator, 2001. Me 11 shtator, 2001 e kom çu në komunë me ja ngjitë emrin, domethanë në Angli, ditën, paradite, dej jom kthy n’shpi, dej kom hi n’shpi e kom dhezë televizorin, çka me pa, t’u u kallë kullat binjake, edhe qaq sulmi i kullave binjake në Amerikë e ndikoi ekonominë e Londrës qaq shumë saqë qato dy kontratat pesë milionëshe që kem t’u i nënshkru, u anulun. Ja nisën kompaniat me i qitë punëtorët prej punës, me bo *salary freeze* [ngrirje të rrogës] edhe *employment freeze* [ngrirje të punësimit] domethanë nuk marrim njerëz t’ri, nuk rrisim rroga, po çka t’hekim, ju tjerët keni me kompensu me punë. Domethanë, kush metke me punu ju bike me punu dy-tre fish ma shumë, kush dilke prej punës i bike keq se edhe ata e hupshin punën, knena na u detyrum me mshelë kompaninë se nuk ndodhën kontratat.

A din, prej një momenti kur ishim qikaq ngat me u bo milionera [shpjegon me duar] përfundum pa punë. Edhe unë qaty e pashë njëfarë pasigurie në sensin që çohet një arab t’i rrëzon dy ndërtesa në Amerikë, ta hupë ty punën në Londër. Edhe ekonomia globale qaq e ndërldhun, që thashë, veç në Prishtinë s’ja la shejë kërkujna. Edhe diqysh thashë, nashta o’ koha m’u kthy n’Prishtinë edhe aty je diqysh zot i punës tone, sa t’punojsh, qaq a din, diqysh krejt varet prej punës tone, nuk varet prej dikujt krejt atje me ta mshelë. Edhe pse jom kanë gabim, se këtu shumë varet biznesi yt prej a t’merr n’sy t’keq një politikan a jo, edhe me bo me dashtë me t’shkelë kanë me t’shkelë, edhe unë jom rast i gjallë, dëshmi e gjallë e cila, të cilën e kanë shkelë plot herë, e o’ çu n’kamë, se po të thom, inatin ma t’madh se temin s’di që e ka najkush.

Edhe ndodhi çka ndodhi, e pashë që qajo farë siguria në Angli, përvoja që e fitova ke shumë e mirë. Dëshira me u kthy këtu ja nisi diqysh me u ringjallë apet, edhe këtu Bresta një dost i jemi pat’ ble të drejtat prej Marvellit me botu Spiderman-in strip, shqip. Edhe thashë, “Çu po nisim diçka!” E nisëm “Rrotën”, me “Rrotën” patëm publiku, krejt çka pata kursime i shtina me publiku stripa në shqip. Ma

në fund, me sene që jom rritë, thashë p'i kthehna, p'e kthejmë qat' kulturën e stripave në shqip. Shtatë numra i botum, falimentum, masi u ktheva në 2003-tën.

Edhe (qeshë), po e kom bo edhe një tatu me llogo të *spiderman*-it një marimangë, si shejë që po kthehna n'Kosovë me bo diçka mirë, edhe tash ma përkujton dështimin që e kena pasë. Po qaj' kthimi jem ka nisë qashtu me një qëllim t'mirë me bo diçka mirë për qit' shoqni edhe me bo diçka që zemra mu gjithë ma ka dashtë. Dashnia për stripa qaq moti u kanë edhe dëshira me i bo shqip, me i pa të publikume në shqip ke qaq e madhe që e ndërborra krejt qit' ndryshim për me ardhë këtu me bo diçka, veç m'dështoi.

Kaltrina Krasniqi: A jeni kthyer me krejt familjen?

Fisnik Ismaili: Fillimisht erdha vetë, Laura me t' nja katër muaj deri këtu i rahatova senet. Masnej erdh ajo. Ajo në ndërkohë e pat' nisë një punë si analiste e ADN-së, domethanë punojke në asi laboratore të CSI, ti ja çon një kime ajo ta nxerrë ADN-në e kimes ose pështymës. Taman për policinë punojshin. Edhe këtu ja nisi me u zhvillu departamenti i Forensikës edhe dojshin me bo një qasi laborator. E murrën vesh ata që Laura mirret me qit' punë, erdh po ja nisi me punu në polici, paramendo në Forensikë, e cila nuk ndodhke, ai laborator s'e di, dy vjet as...u folke për to, po nuk erdh. Knej punojshim do punë tjera, në të cilat kjo i merrke 150 euro rrogë, që ish poshtnuse, se rroga e saj si civile ish ma e vogël se e një polici që e ka kry akademinë ushtarake, e kjo me fakultet në *University College London*, UCL është i treti ma i famshmi në Angli.

Knena unë, mu m'dështoi biznesi edhe nisa me u marrë me *web design* e me krejt me "Rrotën" masnej u damë e nisa "Karrotën" në 2005-tën edhe nuk ishim financiarisht kurqysh, ekstrem keq. Plus fakti që jeta n'Kosovë nuk ish qaq e lehtë në sensin që nëse don me bo vetë o' shumë vështirë e nëse punon për dikun, edhe ma vështirë se me 150 euro rrogë në muaj bash sen s'un bon. Knena unë i angazhum ton' kohën edhe për një arsye shumë banale, po Laura ma s'mujke, provoi dy-tri herë qitu dy vjet e diçka ka nejtë, s'mujke, s'ja dojke, a po kupton? Edhe i kish 43 anëtarë të familjes atje, unë një motër që m'met, me të cilën u shihsha një herë në shtatë muaj, a din. Po përveç qasaj, apet qajo kambëngulësia jeme, qaj inati jem që, "Kom ardhë qitu edhe përkundër vështirësive, nuk ka shqiptar që m'njekë prej qituhit apet". Diqysh m'pat' njekë në '91-shën dikush tjetër, po shqiptarit s'ja dho qat' kënaqësi. Se masnej këto edhe mbas angazhimit tem politik edhe tentimeve me m'goditë në çdo mënyrë, ajo u kanë dëshira ma e madhe, me m'njekë prej qituhit. Unë qat' kënaqësi s'ja dho kërkujna edhe krytë e kom ekstrem t'fortë për qit' çashtje.

Deri në pikën që a din, ajo tha, "Po shkoj!" Unë thashë, "S'po vi!" Edhe qe, qe pesëmdhetë vjet s'jena bashkë mo. Domethanë kaniherë qikjo kambëngulësia jeme nashta edhe dej n'ekstrem shkon, edhe m'ka kushtu. M'ka kushtu me familje kësaj here. Po në anën tjetër e menoj t'isha konë në Angli, çka? Nashta e kisha pasë një punë t'mirë, punë t'mirë në Angli gjithë muaj me pasë, ato e di. Po a kisha mujtë me i bo do sene që i kom bo n'Kosovë? Dyshoj! A kisha mujtë me bo një monument t'pavarësisë e me përjetu pavarësinë e me qenë pjesë e qasaj? Dyshoj! E diqysh ton', po t'thom vazhdoj me jetu qat' jetën pa pishmane. Veç piano edhe gjuha që e kom harru, se për tjerat jom kanë boll, jom kanë n'moshë që me ditë çka po boj. Se pianon edhe gjuhën i kom lanë kur jom kanë shumë i vovërr e s'kom ditë çka po boj. Tash i kom bo krejt senet me vetëdije, qoftë edhe n'kosto temen.

Kaltrina Krasniqi: Monumenti i pavarësisë...

Fisnik Ismaili: Ndërkohë para monumentit t'pavarësisë, domethanë qajo ndamja jeme që s'u kanë e lehtë në 2005-tën, njikohësisht qatëherë e kom nisë edhe "Karrotën", jom kanë shumë keq financiarisht, njikohësisht e nisa edhe zyrën në Tiranë. Ashtu gjetëm investime, hinëm n'do borxhe, dojshim me nisë ma t'madhe, dojshim me bo punë edhe nuk u konë e lehtë hiç. Domethanë përveç asaj gjendjes emocionale që e kom pasë, u dashtë nonstop me punu, nonstop me udhëtu kah Maqedonia ka 380 kilometra, dy herë në javë.

Edhe deri në 2010-tën e kom pasë kompaninë, pak pa u çelë autostrada e kom shitë. Qishtu e shti veten n'zor une, mandej kur letohet masnej s'më doket interesant. Edhe ja nisën me ecë puntë, i kena marrë do projekte të lezetshme, i kena bo do punë, e kena ndërru imazhin e "Valës" për shembull, e kena përgatitë "Valën" që kur t'hin "Ipko" mos me rrëzu në dy gujtë. Se qysh jonë kanë shërbimet e "Valës" nëse t'kujtohet në 2005-tën, jonë kanë qaq të tmerrshme saqë 80 përqind e njerëzve u patën deklarë që si t'hin operatori tjetër kanë me dalë anej. Po në fund na e bamë një fushatë qaq t'mirë edhe ja ndërrim imazhin krejt, e bonëm qat' flutrën e ato që e rujtëm, e rujtëm njëfarë mënyre qat' integritetin e kompanisë që patën me hupë.

Edhe na ja nisëm me bo emën në qit' fushë, posaqërisht në telekom, në Shqipni ja nisëm me bo reklamat e AMC-së, jo Raiffeisen, jo Credins Banka, Lufthansa, British Airways, ja nisëm me punu. Edhe qat' përvojën që e kishim prej Anglie, ja nisa apert me e nxjerrë edhe kulmoi dikun, qajo punë ka 16 orë, 20 orë në ditë kulmoi me NEWBORN-in, u kanë një ide e cila na u ka kujtu dikun nimdhetë ditë para shpalljes së pavarësisë. Prej s'kfillti, hinëm një mbledhje. Insistojke Jetoni, u kanë një drejtor artistik, insistojke Jetoni, "Hajde hina një mbledhje me folë për një projekt", se ish Kupa Botnore qat' ditë, dojshim me bo njëfarë loje me futboll diçka, e patëm bo ma vonë, me do penalla me shutu, lojë që lun në eebsite.

Tuj folë, "Hajde po hina". Dojshim me bo lojën e me ja shitë naj klienti, me thanë, "Qy çka kena ba për kupë botnore, a p'e merrni?" Edhe t'u bo muhabet, thashë, "Kadal bre se ka najsen që mujna ma herët me shitë se me pritë deri në qershor diqysh..." Çka ka, çka ka? Shën valentini, i 14-ti shumë herët. Çka? "Me 17-tin po thuhet që po shpallet pavarësia..." "Po thuhet!" "Po bre, në lajme ke që i kanë nda 1 milionë euro për me financu krejt atë farë pune..." "Okej, hajde", thamë, "Po menojmë diçka, se 1 milionë euro, shancë s'ka kërkush për dhetë ditë me i shpenzu 1 milionë euro".

Na e dishim edhe kush ka me marrë projektin me i shpenzu 1 milionë euro, u kanë edhe n'gazeta e krejt. Edhe thashë, "S'ka shanca dikush me i marrë me i shpenzu 1 milionë euro në qit' sen. Kena organizu na evenimente të mëdhaja edhe e dina sa shkojnë, sa shpejt munesh diçka me organizu, sa pare shkojnë. Nëse na e kena naj ide të mirë, e prezentojna, paska buxhet. Hajde po menojmë diçka të madhe, hajde vum, bam, vum bam {onomatope}". M'u kujtu mu fjala NEWBORN edhe më mbet' në kry diqysh, NEWBORN, NEWBORN, "Çka me bo me NEWBORN?" "A bojna maica?"

Menojshim me bo njerëz t'u dalë me cuçlla, me cuçlla në gojë, tylifar sene na u kujtojshin qishtu, jo maica, jo p'e shkrujmë një muri, jo kësi... dikur thashë, "Jo bre", thashë, "Diçka që rrin, diçka që s'heket kurrë". "Çka bre?" Thashë, "Skulpturë tipografike as s'dina qysh bohet as..." "P'e bojmë një t'madhe!" "Sa t'madhe?" "Dy metra e gjysë?" "Sa dy metra e gjysë?" P'e çoj dorën, edhe unë dy e...Ja,

thashë, “P’ja preksha funin, p’e bojmë tre metra!” Qisi vendimesh. Edhe e llogaritëm, tre metra u bojke 25 metra, hajde ku me ja gjetë një ven’, t’e bojmë njëherë si projekt-ide, a din. Thashë, “Veç te Boro-Ramizi! Qaty e zen 25 metra, ka boll ven’ me u fotografu, krejt gazetarët e huj prej ‘Grand’-it kanë me pa, ka vend për turma”.

U lidhke veni qaty ma s’mirti. Thamë niherë a din përkohësisht qaty t’ja gjojna, masnena t’e kqyrim. U lidhke veni, s’kishe ti një objekt me qasi dimensionin kërkaq tjetër me qitë n’Prishtinë. Edhe masnej Nita, Nita e pat’ qitë pikën. Na te shkalltë e patëm bo njëfarë neje, edhe n’skallë e patëm qitë një letër t’madhe qishtu, edhe i patëm shti njerëzit me i shkrujtë përshtypjet e tyne për neve edhe saherë u ngjitshim shkallëve përpjetë e kishim atë letrën aty lexojshim qisi plot shkrime ka pasë çka kanë...musafirtë që kanë shkrujtë për neve. Edhe po hin Nita tha, “I shtina njerëzit”, tha, “Me nënshkru në NEWBORN”. “Oooo”, thashë, “Perfekt ideja!” Se na dojshim veç me lonë qashtu. Edhe mo qajo ja qiti pikën, Nita Salihu, m’fal, Nita Salihu është... ka punu dizajnere këtu. Në ndërkohë që unë jom njoftu në 2007-tën me Nitën me të cilën tash bashkëjetoj.

Kaltrina Krasniqi: Nitën partnerën.

Fisnik Ismaili: Po. Jom njoftu me 2007-tën. Nita jeme, Nita Qena ka qenë njeni prej njerëzve ma kyçë që m’ka shty, a din, për me bo NEWBORN-in, a din, pa to s’e kisha bo. Se qato njëmbëdhjetë ditë as s’kom flejtë, qato njëmbëdhjetë ditë unë u çojsha i harrojsha çelësat, e harrojsha jaknen, harrojsha me i mathë patikat edhe Nitën e kisha qitu që ma kujtojke çka kom me bo. Ma kujtojke që ka me u bo qikjo, momente kur as stafi jem as ish-ortaku jem s’kanë besu që ka me u bo, ajo ma bojke, “Çu, çu qitash hajde po i grahim”. Edhe m’ka përkrahë ekstrem shumë. Nita Salihu ja qiti pikën me idenë për nënshkrime, edhe dul fenomenale kështu si ide veç që s’na çojke kërkaq telefonin me e kqyrë idenë tonë, s’na futke kërkaq. Shkova masnej te Faik Ispahiu edhe te Jeta Xharra edhe po ju kallxoj çka po du me bo ata u tranun krejt, “Aaa çfarë ideje e mirë”. U paraqitën një kompani tjetër që dojke me financu kështu me thanë, me thanë, a din, nëse s’ta jep qeveria unë po ta paguj veç le qaty.

Kaltrina Krasniqi: Privatisht.

Fisnik Ismaili: Po. Me Jeta Xharrën masnena, çka me bo hajde qysh me i shti njerëzit, me i qitë para aktit të krym me hi me ta jepë lejen. Se unë tash më vyjke leja prej komunës, njëfarë leje a din me thanë që, “Po, në rregull osht”. Edhe m’u zyrtarizu prej qeverisë që me ardhë me nënshkru krerët e masnej me ja nisë populli, qata njerëz që e nënshkrujnë në Kuvend me ardhë me nënshkru NEWBORN-in e masnej krejt njerëzit me vazhdu me nënshkru. Qashtu u konë ideja me u zyrtarizu NEWBORN-i si objekt, përndryshe nëse s’u zyrtarizojke unë veç kisha me lëshu, qkllup {onomatope} me lëshu qaty një natë ma përpara edhe me lonë qaty edhe kurgjo, me ecë. Qashtu e kom pasë njet me bo!

Kur i kom hy kësaj pune, kur shkova te ata tipat që punojnë me hekër, “Sa kushton?” “18 mijë euro”, tha, “Kushton me ta maru NEWBORN-in”. Thashë, “20 i ki, veç nisja”. Tha, “Ani pra”, tha, “2000 kapare”. Unë centin n’xhep [s’e kisha]. Thashë, “Qe”, thashë, “Çelësin e shpisë. Qe çelësin e banesës”, thashë, “Veç nise!” Tha “Jo”, tha, “Çfarë kerri e ki?” E kisha një Pasat. Tha, “Kqyrmi”, tha, “kerret mu, çfare i kom”. Ai i ka do Mercedesat. Thashë, “Po ti kqyre çfarë kerre paske e je metë në zor për 2000 euro t’miat a?” “Jo”, tha, “kapare!” O s’un e gjejsa një njeri të përbashkët me to i cili diqysh kish me

garantu që me i thanë, “Nisja punës!” Se kisha pare. Edhe u dashke me nisë punën qat’ natë, qat’ natë u dashke me nisë punën për me mujtë me kry NEWBORN-in me kohë, përndryshe me u pas’ nisë pak ma vonë s’kish me u kry.

Edhe unë, “Nisja ti punës se vjen ni garantusë...” edhe s’ mujsha me gjetë kurqysh. P’i kallzoi nanës tem thashë, “Aii le se jom t’u u baravat qitu” nana jem u shku në kojshillak te Drita e kojshive qaty t’u bo muhabet me to, “Qishtu tha bre Fisi në Fushë Kosovë u shku te njani e ka gjetë, po ai so ka ia nisë punës o t’u mundu...” o e vetsha a e njeh kta, a e njeh ata, njerëz që, a e din, garantojnë për mu. As s’më njifke as s’e dike kush jom.

Ajo nana jem t’u folë me Dritën ajo Drita, “Po more...” tha, “djalin e tina vllau jem shokun ma t’ngushtë e ka” veç po m’thirrë nana jem, “Ta gjeta, qitasht ia nisni punës”. Ai e ka thirrë ai dosti ia ka bo, “Nisja, a e din kush osht’ ai?” edhe qashtu e nisën ata punën. Masnej me ta e kom pasë ni problem se kur e panë madhështinë e objektit masanena, si dojshin ma paret i dojshin meritat. Kur ia çova CNN-nin, BBC-në i shkun në punëtori, ia xhirunë punëtorinë, kur e çova ata... në anën tjetër knej une i lypsha paret prej qeverisë qeveria as s’ma rraske, as s’mu lajmërojke në telefon as kurgjo.

Tek nëpërmes ni kanali që iu ka shku amerikave diqysh kur e kanë pa ata kanë thanë, “Ejj kqyrë çfarë ideje e mirë, merre, yes” a din, e kanë pranë. U kanë dikund total shpenzimi 66 mijë euro, 20 mijë ndërtimi, aii veç për ballona, dy mijë ballona ka dy, tre euro na kanë shitë me helium, ballona që zakonisht kushtojnë kah 50 cent kur e merrshin vesh që osht’ për, për manifestim të pavarësisë, e dijshin që janë nda 1 milion atyne nuk iu interesojke t’a futke dy-tre fish çmimin edhe krejt na kushtun ma shtrenjtë senet.

Edhe n’fund e pranun qashtu, masnena me kta që e kanë maru e kom pasë pak problem se kta s’dojshin me lshu në natën e fundit thojke, “Pa i qit llogot e mia s’ta lshoj” o ia bojsha, “Ti ke ardhë ktu me ni copë letre, ke ardhë me ni copë letre na e kena maru. A kena kontratë? Ti je gati që e realizon idenë teme”. “Po...” “Po ti veç ni copë letre e ke pasë...”, a din, “na e kan bo hekrin”, “Po edhe ma ke qitë çmimin për hekër edhe ma ke qitë çmimin për çfajc”. Po kur e kanë sa u bo, se kuptojke n’fillim kërkush se kuptojke, as stafi jem se kuptojke, “O ça je t’u bo...” ma bojshin, “s’ka me t’dhezë” stafi jem.

Ni natë para se me u bo krejt u katrrithshin nëpër mure. Ke pasë do që kanë besu po ke pasë do... ish oratku jem ma pat’ bo, “S’e ki përkrahjen teme s’ka me t’dhezë” po po t’thom inatin që e kom une, këmbngulsinë që e kom une... e qatëherë bile u njoftojsha, u njoftova me prindtë e Nitës bash qat’ kohë. Se diqysh kur e kom nisë me Nitën me kalu tontë thojshin, “Ky i ndamë prej grusë” atëherë u kanë goxha, a din diqysh i ndamë prej grusë p’e kqyrë dikon që osht’ nëntë vjet ma e re se ky.

Edhe, edhe kish presion edhe Nita p’i familjes, domethanë qysh po rrin me to edhe t’u e maru NEWBORN-in mu m’ra rasti me u njoftu edhe me ta edhe tash... NEWBORN-i qaq me dashni u bo e qasi ndjesie ka jep n’krejt njerëzit që diqysh m’u harrun krejt qato mëkatet, p’i kuj une mëkate, ndamja e a din prishja m’u harrun ato edhe bile... edhe m’kujtohet kur m’ka taku nana e Nitës ia kish bo Nitës, se ka pa une qysh s’po nalna dojsha gjithqysh me e bo NEWBORN-in, “Fisi e kish krytë e fortë, shumë”

une t'u ia bo, "Thuj asaj osht' kambnguls nuk osht' kryfortë kambnguls o s'nalet deri t'provon deri n'fund" (qeshë).

Edhe kurgjo, mas asaj kur u pranu krejt m'shtinën me ia ndrru ngjyrat se ideja u konë t'kuq me e bo, simbol kombëtar i kuq me fllamastera t'zi qajo kish kuptim. As se kom ditë qysh kish me u dokë flamuri, as se kom ditë çfarë ngjyra ka me pasë flamuri zero...

Pjesa e Gjashtë

Fisnik Ismaili: Kur më thirrën, kur më thirrën ata t'qeverisë me m'thanë që u pranu projekti m'thanë, "Veç ni kërkesë e kena me ndrru me e bo të verdhë ose të kaltërt", thashë, "Verdhë ose kaltërt ngjyrat e EU-së, EU-ja e ka shty kit' sen, *fine* [mirë], osht' nifarë kompromisi që s'koka najsen", edhe thashë, "Okej, p'e boj t'verdhë" diqysh ma mirë rrike se e kaltërta, kur e kam pa flamurin. Pika m'pat' ra. A din qysh u kanë ajo e ngulme klasike, e ngulme klasike pika m'pat' ra, shumë m'pat' ardhë inati ka mujt bile me m'kallxu.

Ma e keqja është se une, se tri katër ditë para shpalljes së pavarësisë që u pat' dalë konkursi për flamur u patën nda tre finalista s'di a e din, njona prej tyne u kanë e dajes tem qatij piktorit, edhe e ka thirrë dajën i kanë thanë, "Je ndër tre të përzgjedhurit, t'lajmrojna a ka fitu e jotja a jo". N'fund kur u dalë flamuri asnjona prej ktyne trijave s'u kanë. Kta kanë pasë me i marr ka ni shumë t'pareve tri vendet e para asnjoni mo kurrë se kanë thirrë për kurgjo, janë harru ato edhe krejt prej kornerit u bo kjo punë.

Qysh e tek nuk i di detajet veç e di që mas asaj, masnena e kom pasë ni përvojë t'keqe se nashta u kanë pjesa ma e lirë e krejt manifestimit të pavarësisë u kanë qajo 66 mijë të NEWBORN-it, të cilat ia nisën me m'qit kajde për to edhe ja nisën njerëzit me m'thirrë me m'i lyp paret, a po kupton, edhe unë si kisha 66 mijë euro janë shumë. Sot që ma bojnë, ke pasë tender me Hashim t'ka jep tender Hashimi, për qita e kanë. NEWBORN-i ka kushtu ma lirë se ky mbikalimi te spitali që osht' 120 mijë euro ka kushtu, tash llogarite që sot s'ka çmim, edhe qato edhe s'ka dashtë me m'i jep.

E kom pasë masnej ni takim me Hashim Thaçin kur i kërcënova që iu qes në gazetë, m'thirri me m'kërcënu me m'i mbledh betë kisha, "Ti s'un m..." qysh m'tha, "Ti edhe me dashtë..." tha, "s'un e bon t'madhe kit punë". Une veç dojsha me e ditë a po m'pagun a jo bile nëse s'më pagun t'i grahi t'i gjoj paret t'i paguj njerëzit vet, a din? Edhe e kom pasë nifar përvoje t'keqe me to se qat' ditë m'pat' akuzu që kom fry çmime.

Unë t'kallxova ni ballon i heliumit ka kushtu 3 e ma shtrejt, çdo sen ta kanë shit ma shtrejt edhe seni i fundit n'jetë që e kisha bo osht' me vjedh n'monument t'pavarësisë. Në momentin që m'tha qashtu unë e kom shly Hashim Thaçin, unë di edhe për t'bamat e tij prej '99-tës e tutje po n'qat' moment kur e përjetova vet edhe e pash takimin e parë që e pata me to unë e kom lshy Hashim Thaçin si njeri që ekziston n'jetën tem mo ose që e konsideroj si njeri. Edhe nashta qajo ka rujt rol me qat' inatin edhe kambngulsinë teme me hi në politikë dy vjet ma vonë, në 2010 kom hi n'politikë.

Kaltrina Krasniqi: Para se me mri aty, a të kujtohet kur është lansu NEWBORN?

Fisnik Ismaili: Qysh jo.

Kaltrina Krasniqi: Qysh ka qenë për ty qajo?

Fisnik Ismaili: Na jena kanë shumë nxan me koreografinë e krejt qati momenti. Ma s'pari mu m'ka thanë në 6 e gjysë, dy ditë ma herët thanë, në 6 e gjysë, kanë me ardhë qaty edhe bonuni gati. U vonun ata s'janë ardhë n'6 e gjysë. Na e bonum nifar koreografike qysh kem me e çu, ma s'pari që e mlum me çarçaf, çarçafi ishte shumë i ran plus e pat' do borë, pat' ra do borë e ranoj hala ma shumë çarçafin edhe me pasë dashtë s'kishim mujt kurrë, as nuk patëm provu me e çel as s'dishim qysh kena me ia bo me e çel. Po masnej t'u e mush me ballona t'heliomit qat' ditë, ni moment, fryjti pak ni erë e na u çu çarçafi edhe u çu qaq lehtë prej ballonave që tham, "Okej ballonat paskan me e letu kit' punë" edhe e ndreqëm na qashtu e mushëm me ballona, i lidhëm mirë që kur t'vjen momenti me e çel me shku krejt.

Në anën tjetër secili i patë detyrat e veta, kanga e cila s'njihet po kanga "I feel good" e Nina Simonit osht' edhe me ritëm e kena tan tërëm tërëm {onomotope}, edhe dritat me u dhezë secila shkronjë tam, tërëm {onomotope}, {shpjegon me duar}, se vren ata se qaq, qaq m'fal n'shpëhje, po guxhë u bo aty (qeshë) që s'i vren ato detaje po na edhe qato i kena menu. Tashti Nita u munojke me e ngu kangën edhe me i dhez dritat, tam tërëm, po ku, na e morëm zërimin ma t'naltë që ke po s'na murr mendja që bohën ton ata njerëz që ta shukat in edhe muzikën. E ka pasë qisi lshime t'vogla të cilat si kena llogaritë a po kupton se se pritëm ton atë turmë.

Për mu u kanë s'di, a din, shpesh njeri e menon thotë kur nalet edhe menon çka është qëllimi jem n'jetë, a din, diçka që kur e arrin n'to n'fund dek se e ke kry qëllimin ton edhe thojsha a qikjo garant u kanë diqysh po përmbillet kapitulli jem i kontributit qitu. Kesh luftova tash edhe për pavarësi e bona qita thashë nesër veç kur e shoh s'jom çu ma, a din, qita e menojsja m'u doke kanihere ma i madh se jeta s'di me ta përshkru çfarë ndjenje u kanë qishtu m'u doke.

Edhe kur u lshun ata ballona kur u çelë ajo është ni moment ku kacavjerret ni cep i carades në njanën prej shkronjave, t'u u çel ajo... po po thom une p'i nanes tem, me Dritën, e me vllaun e atina e krejt jon... që me Nitën shpesh e thojna *invisible hand*, osht' qajo dora e padukshme që m'i çel mu dyrtë, nuk e di qysh. U kap ni cep, ai cep ka mujt me u kap në secilën shkronjë qata 25 metra të cilën kërkush s'kish mujt me mrrri me hek. Ai cep kapet te kryt e tem veç e kom çu dorën tak, ka mujt me u kap atje dej kisha ngajt unë atje ishin çelë ballonat krejt shtremt edhe [prishet audio] ai cep kapet m'i kry temin, po thom, mu m'nodhin senet që vet m'çelen... me Nitën shpesh e thojmë *visible hand* veç m'i çel dyrtë veç kur e shohim ndodhi. Qajo u kanë e momentit edhe bash m'i kry tem edhe veç cëk e kom hek s'u vrejti ajo, s'vrehet kur i kqyr xhirimet s'vrehet, m'sheh mu t'u kcy pak që ka mujt kudo tjetër me ndodhë, kurrë pa e provu asniherë doli përfekt.

Kurgjo s'osht' ajo masnej çmimet kur ja nisëm me i fitu, kuku. I pari çmim u kanë Silver Clio Award në Miami e fitum aty... se ti aplikon tash për çmime n'festivale t'ndryshme edhe ata masnej i vlerësojnë shumë është vështirë me fitu ekstrem, ekstrem vështirë edhe nime veç punimet ma t'mira n'botë që shpërblehen. Edhe unë thashë diqysh e kisha ni ndjenjë që kem shanca. Unë zakonisht qohna vonë shkroj n'punë gjithë i funit. Qashtu dej t'çohna, dej t'shkoj n'banjo...

N'shole t'novojtores ulë jom kanë kur ia nisën me m'ardhë do SMS, p'i punës do SMS p'e ni unë telefonin n'tavolinë atje, *pit, pit, pit, pit* {onomotope}. Dola prej banjos e marr telefonin 15 SMS p'i çeli krejt stafit, "Urime, urime babo, urime, urime, urime", thashë "Çfarë urime..." po thirri, "Çka u bo?" Thanë, "Kena fitu Clio" "Ku more kena fitu Clio?" "Na ka ardhë letra" "Çfarë letre more ka ardhë?" Ata s'kallzojnë, a din, nuk osht' që si Oskari mos me e ditë deri në moment t'fundit po diku ni ditë ma herët t'kallxojnë, por jo ni muj e gjysë.

Festivali s'u majke edhe dy muj. Po kta e kishin çu letrën t'u e ditë që në Amerikë e t'u ditë që na vyn viza na kanë çu letrën ma herët edhe na kanë thanë, "Mos folni po keni fitu edhe kush don me ardhë vizat i keni qita si garancion, si arsyetim që po vini për viza". Edhe ata "Kena fitu kqyre letrën". "Çfarë letre more..." thashë, "Jepja letrën Besit..." e disha që Besi s'din anglisht, thashë, "Jepja letrën Besit le te lexon Besi", s'iu besojsha ktyne se na qishtu ia ngulim njoni-tjetrit, bojmë hajgare, po ma lshojnë fore.

Ia nisi Besi, "Congratulations..." [Urime] ai t'u e lexu unë t'u kajt, n'shole t'nevojtores i ulun. Po hin Nita, "Çka u bo, çka u bo?" Kur po m'sheh mu t'u kajt, "Çka u bo. Çka u bo?" Dej e murr vesh ajo ia nisi me kajt prej tutes. Dej dola prej banjos me ia spjegu ia nisi me kajtë prej gzimit. N'to po hin... baba jem jetojke n'kojshillak ai e dike që kanihere une s'çohna me vakt e po hin me kqyr a jom çu prej gjumit me m'çu me shku n'punë. Se une gjithë në 9 e gjysë hanez çohna deri t'bohna gati në 10 e gjys bohet dej t'dal n'zyre, qashtu.

Edhe ai po hin edhe po na sheh neve dyve t'u kajt edhe, "M'falni!" t'u kujtu ai që po përlahem diçka edhe, "M'falni", edhe dulë p'i shpisë, a din, i erdh keq që na ndërprejti midis... pse po kajna unë t'u u kthy t'u e njëkë shkallve te poshtë, "Alalal blaaa" {onomatope} dej ia shpjegova çka... po, po thom babi edhe n'qat' pleqni edhe kur e kom fitu Luanin e Artë ai apet s'ka mujt me kuptu profesionin tem të cilin ton' jetën e tina ma ka kundërshtu pse s'jom bo financier, pse s'jom bo financier, a din. Edhe diqysh qatëherë e pa o ia bojsha, "Ti ke dashtë unë me arrit diçka, po se bona n'fushën që ti ke dashtë e bona n'fushën që unë p'e du po qe ma nalt se qikjo s'shkon kërkah", "A ka pare n'to", (qeshë) qisi, a din, gjithë ta gjojke ka ni arsye që me ta, me ta kungjav pak.

Faktikisht ma vonë e kom kuptu që mu ma ka bo qashtu se masnej m'kallzojke motra qysh ka reagu. Se fjalimin e parë n'Kuvend kur ma ka kqyr, a din, po kthehna une po hi n'shpi i thash, "Qysh t'u dok?" tha, "Ke mujt edhe ma mirë", fjalimi jem në Kuvend, "Livdom be nihere n'jetë tane", përfundum t'u u përta një orë e gjysë edhe dikur i thash, "Hajt tung", kur po m'thirr motra, "O budall..." tha, "ti a s'pe njeh çfarë osht' a kurrë s'ka me ta pranu ni sen. Unë kesh qaty kur fole njeri ia nisi me kajt", a po kupton?

Edhe u dekë tipi qashtu t'u ma bo bajat. Ama mu m'ka nxit qajo, m'ka nxit qajo, une po thom e kom kryt ekstrem, ekstrem, s'po du me thanë t'fortë po jom tepër këmbnguls kur du me bo diçka. Edhe masnej qishtu, në Miami shkum pesë ditë s'di me përshkru çfarë ndjenje ish me e marr qat çmim. Po kurgjo ajo kur t'thirr Luani i Artë që është çmimi ma i nalti n'botë edhe ni ditë ma herët ti i ke hargjit krejt paret n'Miami, ke hi n'kredi 5000 euro krejt paret t'shkojnë aty edhe... se ke thanë, okej fitum n'Miami s'ka shanca me fitu diçka tjetër, Luanin e Artë n'Kan a, ja, a din, qikjo argjendi në Miami ke kshtu nafakë qorraz.

Kur unë n'Shqipni n'zyre n'Shqipni po m'thirrin tha, "T'thirrëm me t'kallxu që nesër në 6 e gjysë...", ishte 6 e gjysë mramje e marte tha, "Nesër në ora 18:30 ki me marr çmimin", "Çfarë çmimi?" Tha, "Po, Luanin". Thashë, "A muj me e ditë çfarë Luani e kena fitu?" Na e ditëm që jena hi short list se ni ditë ma herët short lista nominimet dulën po nominime janë nja 150 p'i tyne njo e treta fiton diçka. Thashë, "Çka kena fitu?" Tha, "Ari", (Ofshan), "Okej", unë t'u u sill kishe, "Valla s'di a ka me mujt nesër me ardhë, po e çoj dikond le te mer", a din?

Ata, "Okej, veç kallxona paraprakisht kush vjen që te dijna", a din, "Okej", a din, une kshtu ftoftë t'u u sillë, a din, kishe kurgjo. Kur e nala telefonin, çfarë piskame, 6 e gjysë masdite qysh me shku në Cannes, s'kisha as pare, as kurgjo. E te murrëm vesh, masnej e murrëm vesh krejt rrjeti, se atëherë jena kanë t'lidhun me ni rrjet global të agjensive. T'ia nisën me m'shkru gjinja prej gjithkahit. Une qaty e kuptova çka kom fitu. Ia nisën me ma bo, "Gjithqysh duhesh nesër me kanë në Cannes gjithqysh", po ku leshi me shku në Cannes qysh me mrrri. Dej e gjetëm ni shoqe që e kish ni agjensi turistike e cila e qeli agjensinë për neve, për me na e ble biletën, për me u nisë une nesër n'5 t'mengjesit, me m'rri në Nicë n'ora 20:00, për me mrrri në Cannes në ora 11:00, me u përgatit për ceremoni që ish në ora 18:30, e që me e kuptu unë mas tonë ktyne peripecive po mrrri në Cannes edhe po e shoh që i kom harru kpuocat. U dashke tesha kat me u veshë, unë i kam harru kpuocat.

Hajt gjoj tash ti n'qytet t'vocërr si Cannes tash kpuca numër 48, n'mujsh. Gjysë dite e pata me u knaqë n'qytet, me shetit, me buzëqesh me ksi... gjysë dite m'shkun t'u i shëtiti shitoret me gjetë niparë kpuçë. N'fund i gjeta kpuçtë ma t'shëmtuta n'jetë që i kom ble najhere po ken' t'vetmet n'sheher 48. Edhe hina n'ceremoni. Masnej hina në ceremoni mansnej në veremoni i pashë do t'u dalë, t'u e marr çmimin me kimona të Japonisë ata me kimona ishin veshë, e do tjerë të Brazilit me shorce e patika që nuk ishin mërzi për atë punë. E unë t'u u munu me i njek procedurat (qeshë).

Po nejse, i rash trup po po du me kallzu që diqysh sa u kanë e madhe krejt qajo kur e kena zbulu NEWBORN-in, çmimet janë kanë, personalisht për mu, ni si konfirmim emocional i krejt qitij mundi t'punës që dikush ma n'fund o' t'u ta vlerësu. Se profesioni jonë është qaq i nënvlerësun në shqiptari që është e dhimshme, fizikisht t'dhem kur i sheh njerëzit t'u ta nënqmu punën.

Bile edhe NEWBORN-in, "Aiii çka janë do shkronja qaty?" Po e vërtetë osht', e vërtetë osht' e kom fitu çmimin ma t'naltë n'dizajn a faktikisht çka është NEWBORN-i? E çelë Wordin, e shtyp Caps Look-in, e shkrun NEWBORN, ia ndrron ngjyrën edhe ia ndrron fontin. S'ka dizajn. P'e fiton çmimin ma t'naltë për dizajn n'botë, tash spjegoma, a din? Da Vinci pat' thanë thjeshtësia është ai, art sophistication, ai, thjeshtësia është sofistikimi i fundit kur din me thjeshtësu në qasi mënyrë që me e jep ni porosi e cila emocionalisht ka me dridh sa njerëz.

Diqysh s'duhet ideja me kanë brilante, duhet me kanë momenti me e ditë me e kap edhe mënyra qysh e bon. Edhe qajo kur t'vlerësohet n'krejt botën diqysh osht' e papërshkrushme, edhe sa herë e kujtoj, 10 vjet kanë kalu edhe kur e kujtoj mushen sytë me lot edhe tërqethna edhe hala dëshira me e fitu edhe njo. Se kur e fiton njo masnena e don qat' adrenalinen e tjetrës po është pothuajse, a din ... ton e fitojnë kah ni Oskar po kur e fiton dy-tre janë veç ata që tepër, tepër, a po kupton. E ki ni Thom Hanks, e ki ni De Niro, sa De Niro? A i ka fitu dy tre Oskara nashta, po Pacino menxi njo, a din, Di Caprio menxi

njo, Meryl Streep, a po kupton. Domethanë, ki edhe njerëz që kanë Luaj të Artë unë njoh njerëz që kanë fitu 30-40 Luanë të Artë, a din, po ata janë gjenitë e qisaj fushe.

Kaltrina Krasniqi: Qysh mendutë se doni me u kyç me ni angazhim qaq intenziv politik mas krejt qisaj? Se ajo që m'tregove deri qitash nuk, intuitivisht është e vështirë me besu që mandej ki me u angazhu qaq intenzivisht n'politikë.

Fisnik Ismaili: Qyre, si biznes, si biznes, si agjensi reklama jem... nashta "Karrota" u kanë e vetmja që nuk u involvu në asni parti politike. Tashti në momentin që lidhesh me ni parti politike ti ki me bo favore. Ia bon fushatën, ata e fitojnë naj pushtet t'jepin tendera edhe ti detyrimisht diqysh edhe zhytsh. Edhe unë s'kam dashtë me i hi asaj as me u asocu me asnjënin. Unë jam kanë njeri ma apolitik që njeh najhere. Unë Kuvendit të Kosovës në 2004 ia kom bo website-in edhe e kom bo website-in edhe t'u e punu projektin që ka zgatë njo dy muj kom pa andërr ni natë që jom bo deputet, edhe që ecsha rrugës kah "Pishat", vesht n'kravatë, edhe jom çu prej gjumit i njersit, i shashtrist prej tute. Tmerr u kanë veç me menu që bohna najhere deputet e le mo me vesh krevatë që unë krevat kurrë n'jetën s'kom vnu, tek masi i kom hek 60 killa ia kom nisë se ia nisi vetja poget me m'hi n'qef se kurrë as kravat s'kom qit.

Biznesi jonë si biznes e ka vujt qita, mos involvimin, mbajtjen jashtë politike. Se nuk je i favorizim kërkah edhe ti me ni konkurrencë fer e ki shumë vështirë... se zakonisht çka bojnë agjensitë, lyp dikush fushatë shkojnë katër, pesë agjensi, prezantojnë idetë e tyne, ma i miri fiton. Po ma i miri fiton veç te privatniku i cili e don ma t'mirën për kompaninë e vet. Harro që fiton tendera publik, harro që fiton çkado qoftë tjetër ku mun... ose me organizata t'huja qishtu ku punojnë shqiptartë harro që mun me fitu nëse nuk e ki naj lidhje e që duhesh me jep diçka.

Edhe une jam munu me e majt biznesin tem gjallë pa i bo qato sene që është ekstrem shumë, shumë e vështirë. Edhe veç e shisha që po shkon t'u u vështirësu kjo punë, edhe mas qasaj përvojës shumë t'keqe me Hashimin ku edhe përkundër krejt qasaj m'tha hajn unë e mora diqysh... paknaqësia jeme n'tonë kit situatë *business environment* [ambient pune], n'qit ambientin e biznisit u kanë n'rritje që sa vjet po diqysh qajo e kulmoi, diqysh, tash u bo edhe pak personale kjo punë. Edhe unë ia nisa në Facebook, m'fal n'shpërhje, me honger mut në Facebook ia kom nisë 2008-2009 ma ia nisën njerëzit prej Facebook-ut me m'njoftë, s'di a t'kujtohet ty qajo periudhe, prej Facebook-ut m'njifshin mu, "Fisi që p'i nguc ata p'i nguc kta". Masnena unë shkrujsha në Facebook diçka mu m'vike Administrata Tatimore n'vizitë ktu me ma kujtu, a din, nuk gjojshin kurgjo shkojshin apet kunxhafsha në Facebook ata apet vishin mas dy jave qishtu ata ma bojshin qysh po t'ec Facebook-i.

Kur e panë që unë jom qasi budalle që s'nalna ia nisën me m'lan rahat. Puntë n'2010-ten ia nisëm me ecë goxha mirë po qajo paknaqësia jem ke n'rritje e sipër, se e shisha shumë padrejtësi që u bojshin edhe bizneseve tjera edhe temit, a po kupton. Une... biznesi jem varej veç prej kompaniave private, tash kur ti sun merr pjesë, nejse tash jom person publik po ma heret, tash është konflikt interesi me marr tendera publik, po ma heret s'ke mujt as në gara me marr pjesë, a din, menihere je n'black list ose s'je konë i lidhun, diqysh kur s'ka nifarë korrektsie atëherë pse me majt biznes, pse mu munu me punu. Edhe qishtu arsye të tjera që i shishin njerëzit, posaqërisht kur vendosa me i nguc edhe vendosën me mu hakmarr në mënyra tjera edhe kjo ja nisi me u intensifiku a po kupton.

Unë i ngucsha në FaceBook, ata u munojshin me ma hup naj klient edhe masnej ia nisi kjo veç me eskalu. Në 2010-ten kur niva që Shpendi... po t'thom, qito vendimet e mia, e pe qysh n'91- ten n'Milano n'stacion kena vendosë me jetu n' Londër edhe 12 vjet t'jetës jom vendos qaty. Ose e ejte n'punë, veç jom çu me shku n'luftë ose qysh jom kthy n'Prishtinë krejt qito vendime qashtu. Qysh jena çu n'mledhje me fol palidhje për futboll edhe u dal NEWBORN-i krejt kto vendimet e mia ma t'mdhaja qishtu janë dal.

Edhe ni ditë jom shku i kom thanë Shpendit, "Kom ni që po qel parti", tha "Po", thashë, "Okej..." thashë, "krej çka lypi prej teje drejtësi..." thashë, "nifarë korrektësie..." thashë "në *business environment*..." thashë, "veç hile mos me pasë..." thashë, "kur t'hin n'pushtet a munesh veç qita me ma premtu..." thashë, "jo unë me bo biznes..." thashë, "pa u dashtë me gjetë lidhje, me u detyru, me u ngu pordhat e tuli njerit aty ka m'lyp pare, ryshfeta për me e fitu ni projekt t'cilin e di që muj me fitu me meritë", O tha, "Veç a vina n'pushtet najherë", "Jo..." thashë, "i ki shërbimet kompanisë tonë falas krejt as s'ki nevojë me kthy kurgjo veç po du me t'ndihmu me fitu zgjedhjet", okej.

Edhe qashtu unë hina me men me ja bo fushatën, të cilën ia kom bo edhe u kanë fushatë goxha e mirë tu e marr parasysh që na po n'zgjedhje përfundum me dy përqind, po figurat që i kom rreh unë n'qat' fushatë edhe që i kom ngritë tontë në zgjedhjet e ardhshme ose janë bo si deputet, ose si kryetar komunash ose... domethanë, fushata si fushatë ka pasë goxha sukses. Rezultati i fushatës 2010-tës u kanë rezultat i dallaveve ma shumë se sa çdo gjë tjetër se unë jam i bindur që edhe pragun e kishum kalu qatëherë, po tjetër muhabet ai organizativ nuk u kanë sa i përket përceptimit unë e kom, e kom, nime ia kom bo hyzmetin fushatës t'Shpendit.

Po ku jom ngul une, po thom jom ngul kushtimisht, osht' që Shpendi me ni moment t'caktun kur kishim problem me e mush listen me kandidat, listën zgjedhore me kandidat, 110 vet u tutshin me ardhë me kandidu n'zgjedhje. Shpendi m'tha, "Futu n'listë", thashë, "Unë n'listë lidhje s'kom me deputetetllak, as me politikë, as me kurgjo", tha, "Futu n'listë e keni bo NEWBORN-in, të njohin njerztë edhe prej Facebook-ut tash. Futu n'listë", edhe m'shtini me hi n'listë. Edhe masnej krejt senet ndryshun qaty.

Po i hupëm qatëherë zgjedhjet po kur i hupëm zgjedhjet nime u pa kush u hi n'qat' lojë me nejt edhe kush u hi n'qat' lojë veç për interes, se metëm veç pesë gjashtë veta e qata gjashtë e vazhdum e qata gjashtë meniherë masi u mlodhëm bashkë me Vetëvendosjen krejt qata gjashtë ken' faktikisht katër prej neve zgjedhjet e para Shpendi u bo kryetar komune, Dardan Sejdiu ma i votumi në asamble, unë i dyti ma i votuni, Puhia e treta masnej vishin tjetër diqysh katër njerëz të FER-it po dalin të parët is something there, a din. Edhe e pamë që njerëzit edhe p'e shohim edhe unë pe shoh, "Kadal se po merrsha vesh n'qit' sen ma shumë se do pishpirika që kom kujtu që dijnë diçka", po në anën tjetër qajo dëshira që po ndrron diçka prej mrena po mujke me t'shty goxha gat.

Qajo dëshira që ti p'e ndryshon për mrena t'shtyn goxha gat, edhe ti i jep zor e shpreson në zgjedhjet e ardhshme, hup, apet çohesh, i jep zor apet, fiton diçka, apet qohesh. Po p'e shoh që është ni proces shumë i gatë p'e shoh që osht' ni proces që lyp shumë durim e po lyp shumë përkushtim. Tash në t'njejtën kohë e kom nifarë biznesi që nuk po du me e lanë anash se qiky biznesi po i ndihmon

subjektit, i ndihmon fushatave t'ndryshme, po bon punë t'mirë. Në anën tjetër politika po lyp angazhim, po duhet me i balancu dyjat.

T'drejtën me t'thanë nuk është që, sfida janë kanë zgjedhjet, sfidë o' me kandidu edhe me u zgjedh. Diqysh e ki nifar bejete me veten, me do rival, se tash çdo parti i kanë do rival t'profilin t'ngjajshëm me ty tash edhe ata janë, për shembull, po hijnë nashta për herë t'parë n'zgjedhje, janë moshes pak a shumë si tanës, njihen nashta në Facebook si influencers [ndikues], si njerëz që influencojnë. Diqysh e ki nifarë rivaliteti edhe me ta, masnej edhe me t'familjes qysh i ki do si mu për shembull ton jeta m'ka shku t'u ia dëshmu babës tem që boj diçka. Edhe krejt qito t'shtijnë, a din, t'sfidojnë me e bo ni sen po deri me ni moment t'caktun, s'po di, unë kom thanë rri në politikë derisa e shoh që muj me e bo naj ndryshim. Kohve t'fundit s'po di mo a ka met najsen që kom provu me e bo naj ndryshim, noshta osht' vakti me menu me kqyr a m'u çkyç prej ktij sporti ose me kqyr naj mnyrë tjetër me bo ndryshim.

Nuk po thom që nuk kom bo ndryshime, nëse muj naj meritë me ia jep vetit prej krejt fillimit t'kyçjes tem n'politikë, t'paktën njerezit e di 2010-ta s'kanë guxu me i përmend do, do emra s'kanë guxu n'kafe janë tutë me i fol. T'paktën t'u qenë i zëshëm edhe t'u mos u tutë i kom nxitë shumë njerëz, jo nxitë po ia kom, iu kom kallzu me nifar mënyre qysh është me e gjetë guximin me e çelë gojën. Diqysh nihesh shumë ma i lirë kur guxon me fol edhe ai tjetri që menon që e ka pushtetin ndaj teje edhe nuk t'len me fol kur e sheh që po ki guxim ai shukatet edhe diqysh t'len ma rahat. Nëse diçka ka ndryshu n'qit' shoqni u konë që çai presioni që e kena pasë prej qityne politikanve, pushtetarve t'ciltë janë gërmu, e janë kërcnu e krejt është ma i vogël qitash. Po hala po vjedhin, po hala po bojn tona t'zezat po t'paktën, t'paktën po nihesh ma pak i kërcnun se e ke gjet guximin me i thanë me ngrit zanin.

Kaltrina Krasniqi: A ka qenë i pritshëm ton ky skenar me Vetëvendosjen?

Fisnik Ismaili: Skenari i ndarjes a skenari i bashkimit?

Kaltrina Krasniqi: I ndamjes.

Fisnik Ismaili: Nashta mas shumë vjetev. Dallimet mes neve janë kanë, janë t'qarta. Unë jam për nga bindjet jam goxha ma liberal se sa do që janë aty goxha t'majt edhe dallimet për shembull ideologjike mes meje edhe Liburnit janë diametralisht. Liburni është ekstrem i majt unë jam goxha liberal edhe kur e meno, shembull p'e marr. A kshtu sa rrishim jashtë politike majshe me hyp me naj mal a me u marr me naj sport përderisa s'vike puna.

Po unë e shisha rritjen e Vetëvendosjes! si ni rritje t'ni force e cila e merr shumicën e hapësirës politike masnej qajo kur t'kputet bohet tamon ni e majt edhe ni e djathtë, a po kupton, bohen dy krahë t'mirëfillt të politikbërjes se qita çka osht' osht'... çka u kanë Vetëvendosja! edhe PSD edhe krejt kta që e shohin politikën si biznes po politikbërje të mirëfillt bojshim na. Po na mrena kishim ndasi që u dashtë me nejt bashkë deri te mer copën ma t'madhe t'politikës edhe qatëherë me u nda me u bo dy forca të cilat, yes janë rival politik ama m'u kanë njerëz...

Kaltrina Krasniqi: E kishin bo një ndarje ma të shnohtë

Fisnik Ismaili: Yes, e cila nuk duhet, se në momentin që u ndamë na u flliq mo nuk është i shnosh. . Mënyra qysh ata na goditën, mënyra çka ndodhi u pa që nuk është tu u ndërta asni *environment* qasi i shnosh as qaty mrena në Lëvizje. E qikjo është brenga ma e madhe se na u dashtë me e kriju ni *environment* t’shnosh që edhe kur t’ndahëm bre e kena fol edhe mrena kta s’kena mujt qaq me e çu qishtu, kena fol që kur t’rritum na duhet me u nda edhe me u bo na dyja forcat kryesore, e kena ditë te tonë. A që ndodhi qishtu e që hini personalja n’mes e që hini egot e njerëzve qaty mu qikjo ma ka gërrdit kit’ punë seriozisht.

Është e vërtetë edhe unë kom thanë unë rri, se do ma bojshin kur u futa në politikë do thojshin, “Kosova e hupi ni dizajner t’mirë edhe e fitoi ni politikan tkeq”. Nashta bre, po apet kur e shoh vetën qaty në Kuvend e shoh që muj edhe po boj ma shumë se do që po sillën qaty. Por, në momentin që unë e shoh që s’po muj me kontribu, s’jom i nevojshëm me kontribu për me ndryshu diçka unë eci. Kom shumë punë tjera me bo ma t’mëçme në fund të fundit.

S’po di tash te kqyrim qysh po ecë. Tash janë tu ndodh do sene, gjithë po ndodhin do sene që s’po pret edhe po, a din, po rryma që po qojnë krejt dikah tjetër unë kom qasi jete që bash çdo vjet çfarëdo kohe t’vitet qe tash, për shembull, jena n’tetor me pasë vet vetën n’tetor t’vitet t’kalun, a e di a e kom idenë çka ka me kanë t’u bo sot ni vjet, ku ka me kanë lidhje skom hiç, hiç, hiç kurrë kurrë s’ia kom qëllu.

Vjet na e kem pasë në “Karrotë” ni krizë financiare që na ra tepër kresë. E kena pasë ni fushatë që s’dishim kryt ku e kena edhe unë absolutisht s’më ka shku menja edhe unë kam menu që ka me zgatë kriza deri t’vina n’veti edhe s’kom ditë ma parapa se çka kome ndodh një vit mas saj. Tash një vit jo që jena dal prej krizës po jena tu e mendu me e çel ni biznes tjetër edhe s’jom ma n’partinë që jom kanë, a po kupton, ndryshimet ekstreme që janë kanë prej vitit t’kalun kurdo n’cilin moment t’jetës kur e menoj vjet ma herët hiç jeta jem lidhja s’ka me ni vazhdimsi hiç hiç edhe Nita thotë, “Me ty me rrnu është *rollercoaster*”.

Kaltrina Krasniqi: Që do të thotë, nuk ka ndonjëfarë kuptimi me t’vet çka mendon me bo në të ardhmën.

Fisnik Ismaili: Absolutisht ide s’kom, ide s’kom sa jom ka menoj me e çelë ni biznes një Gym, sa jom ka menoj PhD me e nisë, veç kur te shoh që ja kom nisë PhD me bo ose ia kom nisë me e shkru qat’ libër.

Kaltrina Krasniqi: Fisnik, shumë faleminderit! Ke shumë knaqësi shumë. Faleminderit!

Fisnik Ismaili: Po shpresoj nuk e di as çka kom bo as çka kom fol.

Kaltrina Krasniqi: Shumë mirë ke, shumë faleminderit.

